



**MANIPULIMI  
I DISKURSET PUBLIK  
DEZINFORMATAT  
DHE PROPAGANDA**

[përmbledhje të analizave  
dhe verifikimit të fakteve]

METAMORPHOSIS 



# **Manipulimi i diskursit publik**

– dezinformatat dhe  
propaganda

**[ përmblendhje të analizave  
dhe verifikimit të fakteve ]**

# METAMORPHOSIS

**Titulli original:** „Манипулирање на јавниот дискурс -дезинформации и пропаганда  
[Зборник на анализи и проверки на факти]“

**Botues:** Metamorfozis, Fondacioni për Internet dhe Shoqërisë - Shkup  
Adresa: Rruga “Ruzveltova”, numër 19, 1000 Shkup,  
[metamorphosis.org.mk](http://metamorphosis.org.mk) | [info@metamorphosis.org.mk](mailto:info@metamorphosis.org.mk)

**Për botuesin:** Bardhyl Jashari, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Metamorphosis”

**Redaktorë:** Vlladimir Petreski, Bojan Bllazhevski, Oliver Vojnovska, Teofil Bllazhevski

**Fotografite:** Vërtetmatësi/Meta

**Përkthyer nga maqedonishtja në shqip:** Drilon Saliu dhe Valon Abdiu

**Dizajni:** Brigada Dizajn, Shkup

Shkup 2024.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

316.776.23:316.658(497.7)“2023”(082)  
32.019.5:316.658(497.7)“2023”(082)

MANIPULIMI i diskursit publik [Електронски извор] : dezinformatat dhe propaganda : përmbledhje të analizave dhe verifikimit të fakteve / [redaktorë Vlladimir Petreski ... [др.]; përkthyer nga maqedonishtja në shqip Drilon Saliu dhe Valon Abdiu]. - Shkup : Fondacioni për internet dhe shoqërisë Metamorfozis, 2024

Начин на пристапување (URL):

[https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2024/04/manipuliranje-na-javniot-diskurs\\_fjal\\_alb\\_09\\_web.pdf](https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2024/04/manipuliranje-na-javniot-diskurs_fjal_alb_09_web.pdf)

- Превод на делото: Манипулирање на јавниот дискурс : дезинформации и пропаганда : зборник на анализи и проверка на факти.  
- Текст во ПДФ формат, содржи 106 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 11.04.2024.  
- Фусноти кон текстот. - Други уредници:

Bojan Bllazhevski, Olivera Vojnovska, Teofil Bllazhevski

ISBN 978-608-263-121-9

а) Дезинформации -- Јавно мислење -- Манипулирање -- Македонија -- 2023

-- Зборници б) Пропаганда -- Јавно мислење -- Манипулирање -- Македонија

-- 2023 -- Зборници

COBISS.MK-ID 63444997



Ky publikim është përpunuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave civile, mediave dhe gazetarëve përmes trajnimit, duke u mundësuar t’i përsosin shkathtësitë e tyre për njohje dhe njoftim për ndikimin e huaj negativ përmes mediave në sferat kryesore të shoqërisë”, që zbatohet me mbështetje të IFEKS – rrjeti global për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së të shprehurit (IFEX - The Global Network Promoting and Defending Free Expression), ndërsa implementohet nga Fondacioni për Internet dhe Shoqëri, Metamorfozis, nga Shkupi. Përmbajtjet janë përgjegjësi e autorëve dhe jo gjithmonë i pasqyrojnë qëndrimet e botuesit dhe të IFEKS-it.

## Parathënie

Vëllimi “Manipulimi i diskursit publik: dezinformimi dhe propaganda” është një përmbledhje e rëndësishme për këdo që dëshiron të kuptojë fushën komplekse të dezinformimit, e cila po përhapet me shpejtësi të madhe vitet e fundit. Një sërë tekstesh, artikujsh botohen në një vend, kontrollime faktesh, analiza dhe rishikime, të cilat i referohen vitit 2023. Viti u shënuar nga sfida të rëndësishme globale dhe rajonale, nga ndryshimet gjeopolitike dhe lufta në Ukrainë.

Në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon, dezinformimi shpesh përdoret si mjet për të minuar proceset demokratike. Ky botim mbulon një gamë të gjerë temash që veçanërisht më së shumti përdoren për përhapjen e dezinformatave. Ai gërmon në mënyrën se si narrativat gjeopolitike për luftën në Ukrainë, dezinformatat e lidhura me pandeminë, shtrembërimi i përfaqësimit të vlerave familjare dhe të Bashkimit Evropian, u shfrytëzuan për të manipuluar opinionin publik dhe për të shtrembëruar realitetin.

Përmbajtja e këtij botimi shërben jo vetëm si një dëshmi publike e këtyre ngjarjeve, por edhe si një burim i dobishëm për këdo që është i interesuar të kuptojë se si funksionojnë dezinformimet dhe pasojat e tyre. Ai përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të punës së madhe të bërë nga kolegët në Fondacionin Metamorfozis, dhe veçanërisht në Vërtetmatës.mk të cilët u përkushtuan pa u lodhur në mbrojtjen e së vërtetës. Përpyekjet e tyre për verifikimin e fakteve dhe për analiza kritike janë vendimtare në luftën kundër efekteve të dëmshme të dezinformatave.

Me kalimin e kohës, fushatat e dezinformimit do të vazhdojnë, duke u përshtatur dhe evoluuar në një botë digjitale që po ndryshon me shpejtësi dhe vazhdimisht. Viti 2024 quhet “viti i zgjedhjeve”, sepse këtë vit më shumë se gjysma e popullsisë së botës do të votojë në afërsisht 65 vende, përfshirë Maqedoninë e Veriut. Po rritet me këto zgjedhje rreziku që teknologjia do të përdoret nga aktorë keqdashës për të përmbysur demokracinë, duke përdorur gjithçka, nga dezinformata deri te përmbajtjet e rreme. Megjithatë, në Fondacionin Metamorfozis ne mbetemi të vendosur dhe të palëkundur në përpyekjet tona për të reduktuar ndikimin e tyre. Ne besojmë fuqimisht se në luftën kundër dezinformimit, çdo individ ka një rol për të luajtur përmes të menduarit kritik, përhapjes së dijes dhe së vërtetës dhe përkushtimi për të gjetur të drejtën me fakte, ne mund t'i rezistojmë kolektivisht valës së dezinformatave.

Ky botim është një kontribut modest, por domethënës në këtë drejtim, duke ofruar njohuri dhe të vërteta për tema dhe ngjarje të ndryshme që formësojnë ligjërimin publik. Ky botim i fton lexuesit të përfshihen, të bëjnë pyetje dhe të kontribuojnë në një kuptim më të hapur të gjërave, duke përforcuar rëndësinë e së vërtetës në shoqërinë tonë.

Bardhyl Jashari  
Drejtor ekzekutiv  
Fondacioni Metamorfoz

# Përmbajtja

<b>Parathënie</b>	<b>3</b>
<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>1. Sulme kundër Perëndimit në të gjitha frontet</b>	<b>9</b>
Grupet e djathta me dezinformata i mbrojnë vlerat e familjes	10
Intensifikimi i përplasjeve ideologjike të përforcuara nga vërshimi i dezinformatave	15
Nuk është e saktë se BE-ja lufton për t'ua hequr të drejtat prindërore prindërve hungarezë	22
Është gënjeshtër se nëse je për BE duhet të hash insekte që të mos vdesësh	25
Askund në Evropë nuk lejohet që fëmijët 8 vjeç të bëjnë çfarë të duan me trupin e tyre	28
<b>2. Lufta informative kundër Ukrainës</b>	<b>31</b>
Pesë narrativa manipuluese kundër NATO-s për luftën në Ukrainë	32
Amerika nuk i premtoi Ruisë se NATO nuk do të zgjerohet	38
Narrativa e rreme e Kremlinit se “NATO lufton Rusinë deri në ukrainasin e fundit vazhdon të përhapet”	41
Nuk është e vërtetë që elitat perëndimore e kanë përgatitur luftën në Ukrainë për një kohë të gjatë	43
<b>3. Zelenski doemos duhet të bjerë – si dhe pse sulmohet presidenti i Ukrainës</b>	<b>47</b>
Zelenski - objektivi më i rëndësishëm i dezinformimit të Kremlinit	48
Sulme tendencioze që pretendojnë se Zelenski ndaloi opozitën, shtypi kishën, refuzoi të mbajë zgjedhje	53
Nuk është e vërtetë që mediat ukrainase kanë redaktuar regjistrime të rreme të fjalimit të Zelenskit në OKB	57
Historia nuk përsëritet, sepse Zelenski nuk është Hitleri	59
<b>4. Antivakserë – nga COVID-19 deri te lufta kundër gjithë sistemit shëndetësor</b>	<b>61</b>
Dezinformatat antivaksinale i ringjallin sëmundjet e harruara	62
EMA nuk ka lëshuar paralajmërim se vaksinat kundër Covid-it shkaktojnë abort spontan	68
Qeveria kanadeze nuk ka pranuar se 74 për qind e të vaksinuarve me dozën e tretë kanë „VAIDS“	70
Nanoteknologjia, rrjeti 5G dhe oksid grafeni nuk kanë kurrfarë lidhje me vaksinat	72
<b>5. Eksploatimi i teorive të konspiracionit</b>	<b>75</b>
Si e ushqejnë teoritë konspirative epideminë globale të dezinformatave	76
Nuk ekziston asnjë agjendë e BE-së për ta shkatërruar prodhimin tradicional të ushqimit	81
HAARP-i as është, as që mund të jetë fajtor për ndryshimet klimatike	84
Vijat e bardha të ndërprera pas aeroplanit nuk janë dëshmi e gjurmëve kimike	87
<b>6. Ndikimet dhe propagandat e huaja të dëmshme</b>	<b>89</b>
Rrjetet sociale dhe mediat - një levë për përhapjen e propagandës autoritare	90
Tabelat e komunikacionit në autostradën Miladinovci-Shtip të shkarravitura me simbole propagandistike ruse, përgjegjësi nuk ka	95
Ministri serb i Mbrojtjes me propagandë të rrezikshme ndaj Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi	97
Kundërspin: Partia “Levica” spekulon se Maqedonia është e përfshirë në represionin e serbëve në Kosovë	100
Ambasada ruse në Shkup – “spameri” kryesor diplomatik në internet në Maqedoninë e Veriut	104

## Hyrje

Shpërthimi në zhvillimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) gjatë kapërcyellit nga shekulli 20 në shekullin 21-të, i përforcuar me rritjen e lartë të qarkullimit të lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit, u sollti përfitime të mëdha vendeve në mbarë botën dhe e përmirësoi dukshëm jetën e njerëzve në të gjitha pjesët e planetit. Për shembull, për çdo 10 për qind të popullsisë që fillon të përdorë një celular në një vend, prodhimi bruto vendor (PBV) rritet menjëherë me 0.5-2 për qind (2000-17), dhe ky efekt rritet me 25 për qind shtesë kur bëhet fjalë për përdorimin e internetit me brez të gjerë celular dhe teknologjisë 4G<sup>+</sup>. Rritja e tillë e PBV-së është rezultat i produktivitetit të shtuar si pasojë e përdorimit të telefonisë celulare.

Gjithashtu, numri i njerëzve të cilët nga viti 1990 deri në vitin 2015 kanë dalë nga ferri i varfërisë ekstreme është ulur nga 40 në vetëm 10 për qind në 25 vjet.<sup>2</sup> Për krahasim, u nevojitën 170 vite (1820-1990) që kjo përqindje të bjerë nga 93 në 40 për qind.

Në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2014 trafiku ndërkombëtar i internetit nga 4,7 mijë gigabajt u rrit në 211,3 mijë gigabajt, do të thotë për 45 herë<sup>3</sup>. Dhe ky revolucion teknologjik nëpër të cilën kalojmë në asnjë rast nuk ka përfunduar, por në shumë aspekte përforcohet vazhdimisht, duke u mundësuar, për shembull, një numri të madh njerëzish qasje të shpejtë në internet me vendosjen aktuale të mijëra satelitëve në orbitë të ulët rreth Tokës. Jemi dëshmitarë edhe të shpërthimit të mjeteve të cilët drejtohen nga inteligjenca artificiale, një degë e re revolucionare e TIK, e cila është në fillimet e saj, por përparon me shpejtësi të dritës. Kështu, për shembull, shpenzimet për trajnim të modeleve për inteligjencë artificiale, që janë me rëndësi esenciale për funksionimin e saj, kanë shënuar rënie për 200 herë nga viti 2017-21 – prej nga 1000 dollarë në ndër 5 dollarë<sup>4</sup>.

Të gjithë këto arritje janë mbresëlënëse, kuptohet, do të bëhen ende më mbresëlënëse, por, si edhe çdo teknologji e re, ashtu edhe me teknologjinë TIK-ut, krahas aspekteve pozitive, mund të shfrytëzohet edhe në kuptimin negativ, përkatësisht të ndihmojë që të dalin tërësisht në sipërfaqe cilësitë negative të njeriut, siç janë egoizmi, lakmia, zilia, mashtrimi, dëshira për hakmarrje, shkaktimi i dhunës, gjuha e urrejtjes, por edhe t'i përforcojë politikat jodemokratike dhe autoritare të regjimeve që nuk kanë ardhur në pushtet përmes zgjedhjeve demokratike dhe qëllimi i të cilëve është të qëndrojnë në pushtet sa më gjatë, e jo të kujdesen për të mirën e qytetarëve të tyre.

Një nga mënyrat e keqpërdorimit të internetit dhe më konkretisht rrjeteve sociale është prodhimi i dezinformatave dhe propagandës si nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, ashtu edhe nga individë. Dezinformatat dhe propaganda u përhapën me vrull në publikun botëror rreth vitit 2014, me përleshjet e armatosura në rajonin e Donbasit të Ukrainës Lindore dhe pushtimin dhe më pas aneksimin e Krimesë kur regjimi i Kremlinit nisi dhe zhvilloi fushata gjithëpërfshirëse propagandistike dhe dezinformuese kudo që kishte mundësi. Dhe kjo vetëm për të justifikuar dhunën e separatistëve pro-rusë në Ukrainën Lindore, të kryer me armë ruse, si dhe pushtimin (dhe më pas aneksimin) e Krimesë, të kryer nga forcat e armatosura ruse me

<sup>1</sup> <https://data.gsmaintelligence.com/api-web/v2/research-file-download?id=54165922&file=121120-working-paper.pdf>

<sup>2</sup> <https://www.facebook.com/vladimir.petreski.56/posts/pfbid02xBE4Vg9y7S3GWDq6Q9GpsjY7syGKQy6TXN2kpgv1wn84EdVY-3asBCfQgufoebaDpl>

<sup>3</sup> [https://l.facebook.com/l.php?u=https%3A%2F%2Fwww.mckinsey.com%2F-%2Fmedia%2FMckinsey%2FBusiness%2520Functions%2FMckinsey%2520Digital%2FOur%2520Insights%2FDigital%2520globalization%2520The%2520new%2520era-%2520of%2520global%2520flows%2FGlobalDataFlow5.ashx%3Fmw%3D900%26fbclid%3DlwAR2pStteDJDHIHJ6zIff-9lY46COzOD9v\\_hszMjhHjUSGIwm15orHugW3W98&h=AT2WuY5Kav5ev3DI9QkEZTpXjcfzwoa5TIgekpkDtydHh2nr7QM-3jU3iL-1Pj3pFPa98EfyXOPxGoOoq3eXv-UuC-8Q3l-8aj8hZyWBGucG-12gEKuxEsQzYWC08lfXtoQ&\\_tn\\_=-UK-R&c\[0\]=AT-2G2a2mqpBmnzLWGO9zZntPPUrrwVvplRvfMl81lqFB6zqUt9tGxoobvFdaGraLTSyFBG0Q5txL6GLYsfk-GYTM6U-2SISulcVTX-MGTp-RitP3FMXeEEHqTZok\\_gDou1FsDtpDS2djKEvxp3y0TLKENZYCVuHPHRLtyliSwMU5Awu](https://l.facebook.com/l.php?u=https%3A%2F%2Fwww.mckinsey.com%2F-%2Fmedia%2FMckinsey%2FBusiness%2520Functions%2FMckinsey%2520Digital%2FOur%2520Insights%2FDigital%2520globalization%2520The%2520new%2520era-%2520of%2520global%2520flows%2FGlobalDataFlow5.ashx%3Fmw%3D900%26fbclid%3DlwAR2pStteDJDHIHJ6zIff-9lY46COzOD9v_hszMjhHjUSGIwm15orHugW3W98&h=AT2WuY5Kav5ev3DI9QkEZTpXjcfzwoa5TIgekpkDtydHh2nr7QM-3jU3iL-1Pj3pFPa98EfyXOPxGoOoq3eXv-UuC-8Q3l-8aj8hZyWBGucG-12gEKuxEsQzYWC08lfXtoQ&_tn_=-UK-R&c[0]=AT-2G2a2mqpBmnzLWGO9zZntPPUrrwVvplRvfMl81lqFB6zqUt9tGxoobvFdaGraLTSyFBG0Q5txL6GLYsfk-GYTM6U-2SISulcVTX-MGTp-RitP3FMXeEEHqTZok_gDou1FsDtpDS2djKEvxp3y0TLKENZYCVuHPHRLtyliSwMU5Awu)

<sup>4</sup> [https://www.reddit.com/r/dataisbeautiful/comments/114frna/oc\\_the\\_cost\\_of\\_training\\_ai\\_on\\_imagenet\\_has/](https://www.reddit.com/r/dataisbeautiful/comments/114frna/oc_the_cost_of_training_ai_on_imagenet_has/)

uniforma pa asnjë shenjë. Problemi me dezinformatat u ashpërsua edhe më shumë, gjatë, por edhe pas përfundimit të fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve presidenciale në SHBA në vitin 2016, kur Kremli riaktivizoi armët e tij propagandistike në krye me Agjencinë e Kërkimeve të Internetit (IRA - (IRA – Internet Research Agency), një institucion i drejtuar nga tashmë i ndjeri Gevgenij Prigozhin, lideri i kompanisë famëkeqe private nga sfera e mbrojtjes Vagner, i cili, përveç krimeve të shumta në Afrikë dhe në frontet e Ukrainës, ishte gjithashtu përgjegjës për një sërë fushatash dezinformuese në mbarë botën nga ndërtesa e tyre e pashënuar afariste në Sankt Petersburg. Atje, punonjës të shumtë me njohje të gjuhën angleze ishin të ngarkuar me detyrë për të shpërndarë 120 komente në orë me ndërrime prej 10 orë në ditë, duke e ndotur internetin me dezinformata, kërcënime, vrasje të personazheve, provokime, manipulime dhe çmos kundër çdokujt që u qëndronte përballë në mënyrë për të mbrojtur interesat e regjimit në Kremlin.

Atëherë “u bënë të famshme” edhe faqet e njohura nga Velesi me dezinformatat e tyre në anglisht, të destinuara për tregun parazgjedhor informativ politik në SHBA, për të kuptuar më vonë se pos tyre, i njëjti grup ka ekzistuar edhe në Kumanovë, i themeluar dhe mbështetur edhe nga eprorët në ARM. Gjithashtu “famë ndërkombëtare” fitoi kompania Oksford Analitika, e cila u zbulua se kishte vjedhur të dhëna personale prej mbi 90 milionë votues amerikanë, të cilëve më pas u janë dërguar mesazhe nga fushata e ish-kandidatit republikan për president.

Aktorët e dezinformatave të Velesit e përfunduan “karrierën” e tyre edhe para zgjedhjeve të Kongresit amerikan të vitit 2018. Nga ana tjetër, propaganda e Kremlinit vazhdoi të dezinformonte, duke gjetur gjithnjë e më shumë dezinformata specifike dhe një sërë kanalesh dytësore komunikimi, pasi rrjetet më të mëdha sociale zbulonin profilet dhe faqet e tyre, duke i mënjanuar vazhdimisht si aktorë joautentikë, përkatësisht si pronësi me një identitet të rremë që nuk lejohet sipas standardeve të përcaktuara të komuniteteve të vendosura nga rrjetet sociale. Një garë e tillë “mace-miu” zgjati deri në zgjedhjet e ardhshme, përkatësisht deri më 6 janar 2021, kur mbështetësit e presidentit të mundur Donald Tramp hynë me dhunë në ndërtesën e Kongresit, duke ushtruar dhunë gjatë rrugës edhe ndaj policisë në Uashington. Por një vit më vonë, ndodhi agresioni i paprovokuar i Federatës Ruse kundër Ukrainës dhe prioritetet propagandistike të regjimit në Kremlin ndryshuan, duke u orientuar drejt justifikimit të agresionit, përpjekjeve për ta paraqitur NATO-n si agresor dhe duke e shtyrë tregimin se ukrainasit që luftojnë për mbijetesën e tyre kombëtare, janë kukulla të Perëndimit. Dhe dezinformatat e tilla “vetëpastruese”, që përpiqen ta shesin narrativin e “Kremlinit të pafajshëm” vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Ndërkohë, ne e kaluam pandeminë Covid-19, e cila ishte plot me dezinformata edhe për vetë virusin, por edhe për vaksinat, të cilat synojnë ta ndihmojnë organizmin për të përballuar më lehtë atë. Pandemia ndodhi pikërisht në kohën kur në vendin tonë po merrte hov “lëvizja” kundër vaksinës, ndaj me krijimin e frikës nga e panjohura, mundësoi shpërthimin e teorive konspirative lidhur me pandeminë dhe më pas me vaksinat. Pas pandemisë, dezinformatat e këtij lloji u kthyen edhe më ashpër, të inkurajuara nga vëmendja e pamerituar gjatë pandemisë, duke përhapur dezinformatat e tij “tradicionale” përmes sulmeve ndaj të gjitha vaksinave, por tani në një terren shumë më produktiv, të mundësuar nga pandemia, përkatësisht para një publiku i cili është shumë më i ndërgjegjësuar dhe më i hapur ndaj dezinformatave të tilla për shkak të nivelit të rritur të frikës dhe pasigurisë.

Një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave në vend është e importuar nga jashtë, me propagandën e Kremlinit që luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe inkurajimin e një importi të tillë, që vazhdimisht dhe me këmbëngulësi krijon dezinformata të reja për përdorim ndërkombëtar, dhe gjithashtu vazhdimisht dhe me këmbëngulësi i zgjeron dhe atë në mënyra të ndryshme, sepse shpesh përfundojnë edhe te ne. Ndonjëherë kjo bëhet përmes mediave të afërta në vendin e origjinës, dhe nëse nuk mund të gjendet asnjë media miqësore, atëherë përmes mbështetësve të tyre të mediave sociale, ku mbështetësit e tillë mund të jenë të vetëdijshëm për origjinën e dezinformatave (për t'u besuar narrativëve të Kremlinit dhe të jenë të gatshëm për të përhapur dezinformatat e tyre), të cilët e bëjnë për ndonjë përfitim (politik, material, social, etj.) dhe ata që e bëjnë në mënyrë të pavetëdijshme, përkatësisht duke mos ditur se bëhet fjalë për dezinformata si pjesë e fushatës së huaj dezinformuese (idiotë të dobishëm” sipas terminologjisë së liderit komunist revolucionar sovjetik, Vlladimir Iliç Lenin). Nëse, nga ana tjetër, bëhet fjalë për përmbajtje që duhet të shpërndahet dhe të shumohet shpejt, nuk është e pazakontë që Kremli për përhapje të dezinformatave të tij të



përdorë profilet zyrtare të diplomatëve të lartë dhe/ose përfaqësive diplomatike në vendet që janë objektivi i fushatës.

Gjithë kjo është provuar nga Kremli në një sërë shtetesh nëpër Evropë dhe atë në një periudhë tashmë prej një dekade. Shtetet vijnë në konflikt kur në to ndodh ndonjë krizë e brendshme ose e jashtme që duhet të thellohet, ose kur ato lidhin marrëveshje që nuk i konvenon Kremlinut. Në Maqedoninë e Veriut raste të tilla janë me kontestin bullgar-maqedonas, me ç'rast nuk humbet rasti që atij kontesti t'i hidhet benzinë në atë moment kur fillon të acarohet, e i tillë ishte rasti kur vendi bëhej anëtare e aleancës së NATO-s, me ç'rast bëhet përpjekje që kjo të ndalohet, e pasi nuk pati sukses praktika e tillë, qëllimi i fushatës dezinformuese u transferua mbi përhapjen e frikës nga anëtarësimi dhe theksimi i anëve të trilluara negative nga ai.

Por, në dy vitet e fundit tema më e rëndësishme e përpjekjeve dezinformuese të Kremlinut, si në gjithë botën, ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, ishte edhe ajo e lidhur me agresionin mbi Ukrainën. Përpjekjet propagandiste të Kremlinut, shpesh të lidhura edhe me aksionin e drejtpërdrejtë me çka lufta e informacioneve shndërrohet në luftë hibride përmes keqpërdorimit të marrëdhënieve ekonomike, financave, aktiviteteve kriminale, keqpërdorimit të religjionit, krijimit të përçarjeve dhe konflikteve të brendshme, rajonale dhe ndërkombëtare, me qëllim të përhapjes së pasigurisë dhe frikës, zënë vend të rëndësishëm në përpjekjet e përgjithshme të Kremlinut jashtë fushëbetesës. Se sa është rëndësia e valës së tillë dezinformuese tregon niveli i lartë i dezinformatave, për shkak të të cilit për luftën në Ukrainë në këtë publikim janë përkushtuar dy kapituj, nga të cilat njëri është veçanërisht për përpjekjet e Kremlinut për njollosjen e Presidentit të Ukrainës, Volodimir Zelenski, si dhe kapitujt e veçantë pikërisht për raportimin dhe analizën e luftës së informacioneve të Kremlinut brenda dhe rreth shtetit.

Dhe në fund, assesi nuk guxojnë të tendosen dezinformatat që bazohen në teori konspirative. Pothuajse nuk ka temë politike ose temë e cila ka së paku njëfarë pike të përafërt me politikën, e cila është interesante për këto persona ose rrjete që krijojnë dezinformata, e në mesin e atyre dezinformatave të mos ketë edhe të tillë në prapavijën e të cilave nuk aludohet, ndihet ose nuk flitet haptazi për ekzistimin e ndonjë teorie të konspiracionit, përkatësisht në prapavijën e të cilëve nuk qëndron pretendim ose indikacion për ndonjë grup të njerëzve të fuqishëm që rrinë pas, ndërsa shumica e qytetarëve të thjeshtë cilësohen si kukulla dhe ku kërkohet që "viktimat" të supozuara t'i këpusin këto zinxhirë të supozuar dhe t'i bashkohen atij ose atyre që dezinformojnë. Dezinformatat e tilla kanë një "traditë" të thellë dhe të gjatë. Disa konspiracione në fund dalin si të vërteta, që e vështirëson ballafaqimin me ato që bazohen në dezinformata.

Sidoqoftë, peizazhi dezinformues në diskursin publik maqedonas ka një diapazon të pasur të temave, origjinës dhe shkaqeve për diversitetin e tyre, gjë që e bën jashtëzakonisht të rëndë për kundërshtim. Përmban një spektër të gjerë të "lojtarëve", të cilët shpesh janë të mbuluara dhe që ndërmarrin masa afatgjate dhe të ndërlikuara për ta mbuluar identitetin e tyre që të mund t'i krijojnë dhe shpërndajnë sa më gjatë të pavërtetat e tyre. Por, asgjë nga kjo nuk guxon të na ndalojë për të luftuar kundër tyre dhe atë në kuadër të rregullave të lojës – Kushtetutës dhe ligjeve dhe atë, para së gjithash, garantimi i lirisë së të shprehurit që është i përcaktuar në nenin 16 të Kushtetutës së Maqedonisë dhe për të cilën nuk ka kompromise, as negociata. Por, edhe krahas asaj që fusha për garë anon në anën e atyre që manipulojë ose e injorojnë të vërtetën, gjithmonë ka mënyrë për t'u zbuluar gënjeshttrat. Ky publikim është pikërisht për atë temë – për të cilën dezinformohet më së shumti dhe të hidhet dritë mbi atë se si zhvillohet beteja për të vërtetën.



## 1. Sulme kundër Perëndimit në të gjitha frontet

**N**dikimet e huaja të dëmshme, para së gjithash, propagandat autoritare, tashmë një dekadë janë duke përhapur dezinformata kundër demokracive perëndimore për një dekadë të tërë, duke u përpjekur t'i dëmtojnë themelet mbi të cilat mbështeten: të drejtat dhe liritë individuale, sundimi i ligjit, zgjedhjet e lira demokratike etj. Për këtë qëllim, përdoret çdo mënyrë e mundshme për të theksuar, thelluar dhe forcuar mospajtimet brenda këtyre shoqërive, nëse mund edhe të krijohen të reja. Por kjo lloj propagande nuk është e orientuar vetëm ndaj demokracive perëndimore, por është e domosdoshme t'u tregohet popullatave në vendet e tyre se sa keq janë gjërat në Bashkimin Evropian, si është shkatërruar bujqësia atje, njerëzit janë të detyruar të hanë insekte për të ruajtur mjedisin jetësor, familja sakrifikohet për nevojat e komunitetit LGBT dhe gënjeshtër të tjera të panumërta që u përshtaten pushtetarëve autoritarë dhe klikave të tyre për të qëndruar sa më gjatë në pushtet dhe për t'i shuar valët demokratike në vendet e tyre.

## Grupet e djathta me dezinformata i mbrojnë vlerat e familjes

Ideologjia Demokristiane është duke i lëshuar rrënjët e saj intensivisht në shoqërinë maqedonase postkovid, në kohën kur u krijua terreni pjellor për lëvizje kundër vaksinës dhe mbjellje të dezinformatave për pasojat e vaksinave kundër kovidit. Në valën e dezinformatave kishte teori të ndryshme konspirative, si dhe paralajmërime për “importimin e vlerave të rrezikshme perëndimore” për të shkatërruar vlerat tona tradicionale familjare. Në këtë kuptim, po nxiten tregime se fëmijët janë dëm kolateral në synimin e qeverisë për të legalizuar martesat e gjinisë së njëjtë përmes ndryshimeve ligjore, si dhe se komuniteti LGBTI+, si pakicë, ia imponon shumicës vullnetin e tij. Këto grupe antigjinore, të përfaqësuara përmes disa shoqatave civile, grupeve joformale, nismave dhe partive të djathta politike, nuk janë një lëvizje autentike maqedonase, por pjesë e rrjetit të lëvizjeve konservatore, madje edhe radikale në botë, të cilat përmes dezinformatave, synojnë drejtpërdrejt shkatërrimin e proceseve demokratike në shoqëri

Shkruan: Vesna Kollovska, 27.11.2023



Foto: Gerd Altmann Pixabay

Ndryshimet në dy ligje – [Ligjin për Gjendjen Civile](#) dhe [Ligjin për Barazi Gjimore](#) kanë shkaktuar një ortek të dezinformatave dhe konfuzionit në shoqërinë maqedonase. Rrjetet sociale janë bërë një mjet i përdorur gjerësisht që të porositen pretendime krejtësisht arbitrare se ndryshimet legjislative e “kërcënojnë sigurinë e vajzave, sepse ndryshimi ligjor i gjinisë vetëm me një deklaratë në noter do të mundësojë që burrat me histori kriminale të depërtojnë në hapësirat intime të grave (dhomat e spitalit, shtëpitë e pleqve, banjat, tualetet publike, dhomat e zhveshjes sportive, etj.) dhe do të shkaktojë një rritje drastike të shkallës së sulmeve seksuale”.

Disa shoqata civile, grupe joformale, nisma, organizata fetare dhe parti politike të krahut të djathtë të bashkuara në [Koalicionin për mbrojtjen e fëmijëve](#) përhapin frikë dhe panik, duke bartur tregime nga bota me dëshmi për gjoja ndërrim në mënyrë të dhunshme dhe të pavetëdijshme të gjinisë tek fëmijët dhe të rinjtë. Disa nga këto pretendime janë kontrolluar dhe verifikuar si dezinformata nga verifikuesit vendas dhe të huaj të fakteve.

Teza është se fëmijët dhe familjet kërcënohen duke u dhënë të drejta personave transgjjinorë dhe komunitetit LGBTI+, ndërkohë që futja e edukimit seksual në shkolla nxit idenë se “*ka sekse/gjini të panumërta (jo vetëm meshkuj dhe femra) dhe ato mund të ndryshohen*”.

Ideologjia Demokristiane është duke i lëshuar rrënjët e saj intensivisht në shoqërinë maqedonase postkovid, në kohën kur u krijua terreni pjellor për lëvizje kundër vaksinës, të përforcuara me tregime për pasojat nga vaksinat.

Lëvizja u forcua me bashkimin e figurave publike, priftërinjve, mjekëve dhe politikanëve.

## Çfarë parashikojnë në fakt ndryshimet ligjore?

Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, **Jovanka Trençevska**, tha se këto dy dokumente fatkeqësisht janë të bashkuara si në perceptim ashtu edhe në procedurën ligjore, gjë që e sensibilizon edhe më shumë opinionin.

[Projektligji për ndryshimin e Ligjit për evidencën amë](#) i mundëson çdo qytetari i cili ka mbushur 18 vjeç, i cili nuk është i martuar, të ketë të drejtën e ndryshimit të gjinisë dhe njohjen e saj ligjore. Ai person do të mund ta ndryshojë emërtimin për gjininë në evidencat amë dhe në atë mënyrë shteti do t’ia njohë gjininë e tij të vërtetë, gjë që tani nuk është kështu. Kjo ka prekur dhjetëra persona transgjjinorë. Deri më tani, 14 persona trans kanë përfunduar me sukses procedurat për njohjen ligjore të gjinisë, duke filluar nga viti 2017.

Duke përshkruar rëndësinë e njohjes ligjore të gjinisë, shtatë deputetët (**Maja Moraçanin, Snezhana Kaleska, Sanella Shkrijel, Daniella Nikollova, Monika Zajkova, Maja Kostadinova dhe Latife Shikovska**) të cilët janë propozues të ndryshimeve në Ligjin për evidencën amë, u referohen standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat njohin të drejtën e personit për identitet gjinor. Respektimi i identitetit gjinor, duke përfshirë të drejtën e njohjes ligjore nga shteti, është pjesë e së drejtës së jetës private, e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Personat transgjjinorë kanë identitet gjinor që nuk korrespondon me gjininë e shënuar në evidencën amë gjatë lindjes. Së këndejmi, nevojitet të miratohen dispozita ligjore me të cilat do të përcaktohet qartë procedura përmes së cilës personat trans do të mund të lënë të drejtën e njohjes ligjore të gjinisë. Njohja ligjore e gjinisë është një proces në të cilin një individ mund të ndryshojë emërtimin për gjininë në evidencën amë dhe në këtë mënyrë shteti ta njohë gjininë e tij të vërtetë, shkruan në [Propozim - ndryshimet](#).

Propozuesit thirren në të drejtën e personave trans për të marrë dokumente që pasqyrojnë identitetin e tyre gjinor, gjë që është thelbësore që ata të jenë në gjendje të funksionojnë siç duhet në shoqëri dhe të mbrohen nga një sërë shkeljesh të të drejtave të njeriut. Këto përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, në qasjen në mallra dhe shërbime nga sektori privat ose publik, si dhe mbrojtjen nga sulmet fizike dhe verbale.

Ndryshimet, pasi u tërhoqën fillimisht në qershor 2023, janë rikthyer në procedurë parlamentare.

Në [ndryshimet e propozuara të Ligjit për barazi gjinore](#), ndër të tjera, përcaktohet se **“identiteti gjinor”**:

Ka të bëjë me përjetimin e brendshëm dhe individual të gjinisë së vet që çdo person e ndjen thellë për veten e tij, e që mund ose nuk është e domosdoshme të përkohë me seksin që i është caktuar gjatë lindjes, si dhe përjetimin personale të trupit të vet dhe shprehjen e ndryshme të gjinisë, përfshirë emrin, veshjen, fjalimin, sjelljen etj.

Me ndryshimet e propozuara përcaktohet se edhe **“personi me identitete të ndryshme gjinore”**.

Është çdo person që nuk identifikohet në identitetet binare të femrës apo mashkullit, por i përfshin edhe personat transgjinorë, transeksualët, interseksualët dhe personat gjinorë jobinarë.

Pjesëtarët e lëvizjeve antigjinore dolën me qëndrime në publik se identiteti gjinor është diçka e re, e cila na imponohet, por fakt është se nocioni aplikohet që nga [viti 1995](#), me miratimin e Konventës së Pekinit dhe më vonë e implementuar përmes disa ligjeve dhe dokumenteve. Në vend, e fundit është [Strategjia për barazi gjinore 2022-2027](#), e miratuar në korrik 2022 dhe zbatohet nga niveli lokal deri në atë qendror.

Ndryshimet ligjore për barazinë gjinore janë tërhequr për përpunim plotësues dhe ende nuk kanë hyrë në procedurë parlamentare.

## Homofobia dhe gjuha e urrejtjes ndaj diversitetit

Në realitetin tonë maqedonas, këto dy ndryshime ligjore u bënë ajo që për Serbinë ishte organizimi i “Europajd” - Parada e krenarisë në vitin 2021 në Beograd, kur kryeqyteti serb u zgjodh për të mbajtur paradën më të madhe ndërkombëtare të krenarisë në Evropë.

Ai ishte momenti unifikues i lëvizjeve të djathta dhe krishtere-konservatore dhe i forcoi ato edhe më shumë. Lëvizja e bashkuar nuk arriti ta ndalojë Paradën e Krenarisë në rrugët e Beogradit, por siguroi vota për partitë, pjesë e këtij koalicioni, që mbështetën dhe ndanë pikëpamjet konservatore. [Koalicioni partiak NADA](#), i cili u formua në vitin 2021, arriti të fitojë 15 ulëse në parlamentin serb me 250 deputetë në zgjedhjet parlamentare të vitit të ardhshëm. Me 23 ulëse, ky koalicion i djathtë i euroskeptikëve, i përbërë nga 4 parti politike, është i përfaqësuar në Kuvendin e Vojvodinës dhe kuvendet lokale në Beograd dhe Novi Sad. Ideologjia e tyre është konservatorizmi dhe militarizmi kombëtar, zotohen për futjen e një monarkie. Motoja e tyre është “Të jetojmë në mënyrë normale!”

Veçanërisht ilustrues është narrativi i grupit “[Kundër rendit të ri botëror](#)”, përmes publikimit të historive, lajmeve, teorive konspirative, dëshmime kundër vaksinave, personave transgjinorë, me homofobi dhe gjuhë të theksuar të urrejtjes ndaj grupeve minoritare.

T’i hapim sytë dhe ta kundërshtojmë të keqen, të njihemi me të vërtetën e ashpër dhe t’i harrojmë përgjithmonë gënjeshtret e larme - është motoja e aksionit. ([“Kundër rendit të ri botëror”](#))

Në një nga [postimet](#), autori i postimit ndan një fotografi të pamjes së qytetit që e organizoi këtë pranverë në Serbi me konstatimin:

Me sa duket dikush ka vendosur të marrë rolin e Zotit dhe ka krijuar ehuj në formën e syrit të njeriut. Vallë CERN-i është duke luajtur me njerëzimin?

Njësoj si në Serbi dhe Bullgari, këto grupe janë bashkuar rreth [Marshit për familjen](#), i cili është një eveniment vjetor për “mbrojtje dhe afirmim në shoqërinë e martesës vetëm midis një burri dhe një gruaje dhe të familjes tradicionale bullgare të përbërë nga nëna, babai dhe fëmijët”. Ndër aktivitetet e tjera, [ata iniciuan një peticion](#) “kundër propagandës homoseksuale dhe për të kufizuar fushatat publike reklamuese të organizatave LGBT në Bullgari”.

Ikonë e këtyre lëvizjeve është [Met Uollsh](#), një blogger politik konservator, i cili në vitin 2022 u njoh si transfobi i vitit nga [The New Republic](#). Uollsh e demonizoi [Spitalin e fëmijëve në Boston](#) me pretendime të rreme në lidhje me programin e tij të kujdesit për vërtetimin e gjinisë. Spitali, siç [raportuan](#) mediat, ka marrë [një kërcënim me bombë](#), disa ditë pasi ka [raportuar “vëllim të madh”](#) mesazhesh dhe telefonatash shqetësuese me kërcënime për stafin e tij.

Në bashkëpunim të ngushtë janë disa organizata, lëvizje dhe faqe informative të internetit, si dhe grupe në Facebook. Koalicionet në rajon janë pothuajse identike në përbërje – organizata të regjistruara civile, lëvizje dhe iniciativa civile, grupe dhe parti politike në Facebook, antivakserë dhe grupe të njohura religjioze – të gjitha janë të bashkuara rreth organizatave të njohura botërisht [Family Watch International](#) dhe [Alliance Defending Freedom](#).

Këto janë organizata të krishtera të krahut të djathtë që zotohen për ndalimin e abortit, martesave homoseksuale, të drejtën e personave trans për të ndryshuar gjininë/emërtimin gjinor në dokumente, etj...

## Narrativë nga kuzhina ruse dezinformuese

Duke analizuar këto lëvizje, sociologu dhe profesori universitar serb **Aleksej Kishjuhas** bashkimin e këtyre lëvizjeve civile me grupet ortodokse, e sheh, siç shkruan ai, në “vlerat, përkatësisht në narrativët që janë shpikur kohët e fundit dhe atë në Rusinë e Vlladimir Putinit, përkatësisht në fabrikat e tij për dezinformata dhe lajme të rreme.

Në vitin 2013, Rusia miratoi një ligj me titullin e mëposhtëm: “Ligji për mbrojtjen e fëmijëve nga informacionet që zotohen për mohimin e vlerave tradicionale familjare”, me të cilin kriminalizohen të drejtat e njeriut dhe kultura e personave LGBT. Në këtë drejtim, vetë Putini (në mënyrë të rreme) pretendoi se Perëndimi po heq konceptet e “nënës dhe babait” dhe po i zëvendëson ato me “prindin 1 dhe 2” (a kemi dëgjuar për këtë dezinformata dhe pse?). Ministri i Punëve të Jashtme Sergej Llavrov pretendoi (gjithashtu në mënyrë të rreme) se studentët në Perëndim mësojnë se Jezusi i Nazaretit ka qenë biseksual. Me fjalë të tjera, mbrojtja dhe mbrojtja e detyrueshme e vlerave tradicionale familjare është në fakt vetëm një emër i zgjuar për - një luftë propagandistike kundër Perëndimit dhe lirive perëndimore. Rusia e Putinit në nivel global paraqitet si një bastion i vlerave tradicionale dhe roleve gjinore patriarkale, përkatësisht si një kundërpikë ndaj dekadencës morale të Amerikës dhe Evropës Perëndimore. Dhe kjo është arsyeja pse flamujt rusë ose flamujt me imazhin e Putinit barten në mitingjet e Beogradit, shkroi Kishjuhas në një rubrikë për gazetën « *Danas* ».

Modeli dezinformues është i njëjtë. Perëndimi dhe BE-ja po na shkatërrojnë familjen dhe vlerat tona tradicionale. Në një nga dezinformatat rajonale qarkulluese pretendohet se vendet evropiane lejojnë ndryshimin e gjinisë tek fëmijët deri në 8 vjeç. Verifikimi i fakteve nga [Vërtetmatësi](#) zbuloi se nuk ka asnjë vend në Evropë ku [operacionet e ndryshimit të gjinisë](#) lejohen në moshën 8 vjeçare. Moshë për një operacion të tillë pa nevojën e pëlqimit prindëror është 18 vjeç dhe në dy vende mbi 16 vjeç, por me pëlqimin e prindërve.

Në një tjetër dezinformata thuhet se 16-vjeçarët në Skoci po të duan mund ta ndryshojnë gjininë në çdo tre muaj. [Kjo nuk është e vërtetë](#), kur aplikoni për ndryshim gjinie, jepet një betim se personi ka ndërmend të qëndrojë në gjininë e fituar gjatë gjithë jetës së tij.

Në përpjekje për të treguar se sa i ulët është niveli i vlerave liberale evropiane, në rrjetet sociale është publikuar një foto e një libri me figura të edukimit seksual, ku pretendohet se në Gjermani fëmijëve u mësohet seksi që në moshë të vogël.

Gjatë [demaskimit](#) u konstatua se libri me figura nuk është tekst shkollor që përdoret në kurrikulën zyrtare në Gjermani, por ka karakter edukativ dhe u dedikohet prindërve, kujdestarëve dhe edukatorëve si manual për lëndën e edukimit seksual.

Në serinë e artikujve të bartura nga rajoni edhe te ne, pretendohet në mënyrë të rreme se qytetarët e Evropës [do të hanë insekte](#), madje edhe kundër vullnetit të tyre; se BE-ja ka një agjendë [për të shkatërruar bujqësinë dhe blegtorinë](#) deri në vitin 2030; se Gjermania [largohet](#) nga BE-ja, që është një projekt i dështuar dhe të kthejë markën si monedhë.

Ky narrativ ndiqet në terrenin vendor. Sipas shembullit të disa shteteve demokratike perëndimore, në Shkup u përhap paniku se nxënësve të një shkolle në komunën e Aerodromit u është dhënë detyrë të vishen si gjinia e kundërt dhe se në këtë mënyrë në shkollat në Maqedoni realizohet njëfarë agjende për “ Gender Swap Days” ose „Gender Bender Days “, të prezantuara “me qëllim të cenimit të normave të vjetra tradicionale”. Nga komuna e Aerodromit i demantojnë informacionet e tilla, duke theksuar se [bëhet fjalë](#) për një aktivitet i propozuar nga nxënësit. Mirëpo, ata theksojnë se pas shqyrtimit të propozimeve nga drejtorja e shkollës, dhe pas konsultimit me shërbimet kompetente në komunë, është marrë vendim që aktivitetet e planifikuara të modifikohen dhe të pranohen vetëm ato që janë të përshtatshme për procesin edukativo-arsimor.

Në një tjetër [dezinformatë](#) pretendohet se fëmijët do të mësojnë edukimin seksual që në kopsht. Një informacion i tillë për “Vërtetmatësi” [është mohuar](#) nga MASH-i dhe HERA. Kurrikula e propozuar e Edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGJ) është vetëm për nxënësit e klasës së 9-të, dhe tani për tani është vetëm në katër shkolla fillore.

Frika nga ripërcaktimi gjinor i shoqërisë krijuan aleanca të panatyrshme, terren pjellor për teoritë e konspiracionit dhe përhapjen e frikës. Komunitatet e para ku u ndryshua edhe terminologjia në dokumentet komunale nga “barazia gjinore” në “të drejtat ndërmjet burrave dhe grave” janë Strumica, Novosella dhe Gjevgjelia, ndërsa në fund të korrikut 2023 kësaj liste të komunave i janë bashkuar komuna e Dojranit dhe Vasilevës. Vendim të njëjtë pa diskutim [miratoi](#) edhe Këshilli i Komunës së Ohrit.

Lëvizjet progresive civile paralajmërojnë se këto narrativë, të shoqëruara me një rritje e dezinformatave midis lëvizjeve të krahut të djathtë, çojnë në humbjen e të drejtave tashmë të fituara. Debatet publike për rolin e gruas nxisin ripërcaktim të rolit të saj, të drejtës së saj për abort, për punë dhe pagë, përkatësisht në kundërshtim me gjithçka që përfaqëson patriarkati.

Dezinformatat me gjuhën e paligjshme të urrejtjes krijojnë terren pjellor për dhunë, e cila shihet edhe përmes narrativëve në mediat sociale të cilat janë veçanërisht të dëmshme. Autorët janë grupet e njëjta që i mbështesin normat e ngurtësuara tradicionale.



## Intensifikimi i përplasjeve ideologjike të përforcuara nga vërshimi i dezinformatave

“Luftërat kulturore”, pra përplasje ideologjike mes të majtës dhe të djathtës, është bërë një temë dominuese në diskursin politik në Shtetet e Bashkuara. Të dyja palët përpiqen të paraqesin të vërtetën e tyre dhe pikëpamjen e tyre për botën si të vetmen korrekte, ndërsa “ata, të tjerët” janë forca e keqe që dëshiron të shkatërrojë njerëzimin. Përplasje të tilla ideologjike të importuara me gjithë padurimin ndaj kundërshtarit kanë mbërritur edhe te ne

Shkruan: Naum Lokoski, 01.08.2023



Foto:Meta.mk

**M**e kalimin e kohës, kjo retorikë e nxehtë nga rrjetet sociale dhe kampuset universitare amerikane ka gjetur vendin e saj në politikën kryesore, veçanërisht me hyrjen në politikë të Presidentit të mëparshëm të Shteteve të Bashkuara, **Donald Trump**. Në përpjekje për të tërhequr një grup të ri votuesish që më parë ishin në periferi, Trump filloi të përdorte retorikë përçarëse në fjalimet e tij, e cila vetëm sa e intensifikoi procesin e përhapjes së teorive konspirative nga grupet ekstreme në masat e gjera. Grupi i krahut të djathtë Q-Anon, që nga viti 2017, ka përdorur dezinformata dhe trillime për të portretizuar një lloj komploti kundër Trump nga një grup [satanistësh](#), [kanibalësh](#) të cilët janë të përfshirë në [trafikimin e fëmijëve](#). Të tillë “satanistë” dhe “kanibalë”, “pedofilë” etj, ishin shpesh politikanë të lartë nga kundërshtarë politikë nga radhët demokratike apo biznesmenë të fuqishëm amerikanë të njohur në mbarë botën.

Me këtë retorikë, “luftërat ndërkulturore” nga një betejë ideologjike mes të majtës dhe të djathtës, të djathtët ekstremë i kthyen në një ofensivë dezinformuese në të cilën e vërteta filloi të vuante. Interneti dhe rrjetet sociale ndihmuan që narrativa të tilla të largoheshin nga Shtetet e Bashkuara shumë shpejt, dhe dezinformatat dhe teoritë e konspiracionit të drejtuara kundër politikave të vendeve liberale perëndimore u përhapën në shumë vende, përfshirë Maqedoninë e Veriut. “Ushtarët” e djathtë në këtë “luftë ndërkulturore” sulmojnë rregullisht të drejtat e abortit, të drejtat e komunitetit LGBTI+, përhapin dezinformata kundër **Bill Gates**, Klaus Schwab, Forumit Ekonomik Botëror dhe liderëve perëndimorë, kundër përfitimeve të teknologjisë 5G në telekomunikacion. Por, sigurisht që më së madh e bënë gjatë pandemisë COVID-19, kur ishin edhe kundërshtarët më të zëshëm kundër mbajtjes së maskave dhe vaksinave, duke shkaktuar indirekt vdekjen e mijëra njerëzve. E përbashkëta e të gjithë personazheve të tillë, autorëve dhe përhapësve të dezinformatave dhe teorive konspirative është se ata gjithmonë ofrojnë liderë autoritarë, të cilët sipas tyre luftojnë për disa vlera tradicionale, si alternativë ndaj vlerave liberale perëndimore.



Foto: pixabay.com

## Specifikat e “luftës ndërkulturore”

Narrativa të tilla pothuajse koordinohen në Maqedoni nga një grup përdoruesish të rrjeteve sociale, të cilët përgjithësisht përkthejnë dhe përsërisin të njëjtat dezinformata dhe teori konspirative, duke sulmuar vlerat liberale, në përpjekje për të mbrojtur disi vlerat tradicionale dhe fëmijët.

Ndër narrativat më të përbashkëta janë ato të abortit dhe teorive konspirative se [vaksinat](#) e COVID-19 shkaktuan abort ose se qelizat fetale të abortuara gjenden në ushqimet dhe pijet e disa prej markave më të mëdha perëndimore.

Kritika kundër abortit është në drejtim të mbrojtjes së vlerave tradicionale familjare dhe sipas konspiracionit se “*elita botërore kërkon shpopullimin e vendit*”. Shpesh këto rrëfime flirtojnë me politikën (aborti sundon nga koha e **N. Gruevskit**), dhe në një kontekst të ngjashëm përfshihet ose përfshihet feja, d.m.th. bashkësitë fetare (KOM-OA dhe IVZ). Narrativat kundër abortit në Maqedoni janë përsëritur në dhjetë vitet e fundit, të drejtat e fituara dhe indikacionet mjekësore për abortin janë shtrembëruar dhe barazohet me “[të drejtën e vdekjes](#)” ose vrasjen. Furnizuesit e njohur të teorive të tilla konspirative, duke u përpjekur të krijojnë panik dhe një front kundër abortit, e kanë lidhur këtë proces mjekësor me vaksinat e COVID-19. Përveç pretendimeve të rreme se vaksinat përmbanin alumin dhe merkur, teoricienët e konspiracionit shkuan aq larg sa thanë se vaksinat përmbanin inde nga [fetuset meshkuj të abortuar](#). Teoricienët e konspiracionit kanë shpërndarë video dhe përmbajtje të krijuara nga qarqet e krahut të djathtë në SHBA duke pretenduar se [qelizat e veshkave nga fetuset e abortuara](#) përdoren në produktet e Pepsi, Kraft, Nestle dhe Campbells.

Vërtetmatësi ka shkruar disa herë deri më tani se vaksinat kundër Covid-19 [nuk përmbajnë fetuse të abortuara](#), as veshka majmuni apo embrione pule. Si dhe për faktin që vaksinat kundër Covid-19 nuk [ndryshojnë ADN-në tuaj](#).



Foto: pixabay.com

## Rezistenca ndaj edukimit seksual është rezultat i teorive konspirative

Në të njëjtin drejtim janë edhe sulmet gjithnjë e më të shpeshta kundër Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual dhe pretendimet se ai promovon [pedofilinë](#). Anëtarët e “Q-Anon” u përpoqën të paraqesin ekzistencën e një lloj rrjeti të thellë shtetëror dhe [pedofil që kryen trafik ndërkombëtar të fëmijëve](#). Sipas Q-Anon, i cili ka si mbështetës ashtu edhe “ushtarë” në vend, ish-presidenti Trump është shpëtimtari i fëmijëve, i cili ndaloj këtë lloj trafikimi. Pasi skandali [Pizzagate](#) i vitit 2016 u qetësua dhe çështja e manjatit të akuzuar financiar amerikan **Jeffrey Epstein** përfundoi kur ai kreu vetëvrasje në qelinë e tij të burgut në Nju Jork, Q-Anon mori përsipër narrativën e lidhjes së elitës politike liberale të Amerikës, Hollivudit dhe biznesit me pedofilinë dhe satanizmin dhe Trump paraqitet si [shpëtimtari i madh](#) i fëmijëve nga kthetrat e së keqes.

Teoricienët e tillë të konspiracionit në Maqedoni vënë shenjën e barazisë ndërmjet pedofilisë dhe [edukimit seksual gjithëpërfshirës](#), gjë që është e pavërtetë, shpifëse dhe pjesë e propagandës afatgjatë që qarqe të caktuara, kundërshtarë të edukimit seksual, e promovojnë me muaj të tërë. Qëndrime të tilla plotësohen nga keqinformimi se akademikët në Amerikë besonin se pedofilia ishte një orientim seksual dhe duhej pranuar si e tillë nga shoqëria, si dhe se në vend programi për edukimin gjithëpërfshirës seksual promovonte “pedofilinë pilot”.

Pretendime të tilla [janë mohuar nga HERA](#), por edhe nga dokumentet zyrtare, siç është [programi pilot](#) për edukimin seksual. Pedofilia përmendet shpesh edhe në kontekstin e të drejtave LGBTI+, të cilat teoricienë të tillë përpiqen t’i paraqesin njerëzit LGBTI+ si «apostate» nga normalja, d.m.th. “të sëmurë”, një shpikje perëndimore dhe si një përpjekje për t’i vënë ato në kontekstin e ndonjë axhende që shkatërron [vlerat e tyre](#).

Kjo lloj narrative përdoret shpesh nga [liderë dhe figura politike autoritare](#) në Evropë dhe SHBA, dhe me retorikë nxitëse tentojnë të fitojnë vota dhe shpesh pasqyrohet tek ne duke përhapur [dezinformata](#).

Përkundër gjithë këtyre shembujve debatesh, që pasqyrohen në shoqërinë tonë dhe në diskursin shoqëror, megjithatë, më të spikaturit janë ato me sulme të drejtpërdrejta ndaj personaliteteve dhe politikanëve nga bota perëndimore, të cilët janë liderë të vlerave perëndimore liberale.

## Biden - tradhtar!

Një prej tyre është presidenti amerikan Joe Biden. Pasi Biden erdhi në pushtet, mbështetësit e Trump nisën një fushatë dezinformimi kundër tij, duke u përpjekur ta portretizonin atë si një [tradhtar](#) dhe të papërshtatshëm për të shërbyer si president. Videot dhe deklaratat të [modifikuara](#) dhe të [redaktuara](#) shpërndahen mjaft shpesh për ta paraqitur Bidenin si të keqen dhe kundërshtarin e vlerave tradicionale siç e kanë imagjinuar. Keqinformimi shkon aq larg sa që madje është shpërndarë se Biden u [vra](#) dhe u zëvendësua nga një [aktor](#) apo [klon](#). Janë pikërisht sulmet ndaj Bidenit si lider i SHBA-ve, të cilët konsiderohen si lider i perëndimit liberal, që synojnë të shkatërrojnë vlerat liberale dhe të tentojnë t'i ofrojnë një alternativë autoritare Perëndimit demokratik. Manipulimet që kanë të bëjnë me Biden-in dhe SHBA-në shpesh përshtaten me “tregun e brendshëm” dhe krijohen [dezinformata](#) të natyrës lokale apo rajonale.

Të ashtuquajturat “Luftërat ndërkulturore” të së djathtës në vend kopjohen dhe importohen tërësisht nga jashtë, por me një qëllim identik, për të sulmuar vlerat liberale dhe për të kthyer opinionin publik kundër Perëndimit. Thirrja për respektimin e disa [vlerave tradicionale familjare](#) shoqërohet shpesh me promovimin e liderëve autoritarë si **Putin, Trump, Erdogan, Orban...**



Portreti zyrtar i presidentit Xho Bajden,  
Foto: whitehouse.gov, CC BY 3.0

## Autoritarizmi dhe “Ndjenja Kombëtare Maqedonase”

Glorifikimi i këtyre liderëve, e veçanërisht i presidentit rus, **Vladimir Putin**, shpesh shkon në drejtim të ndërtimit të marrëdhënieve të ngushta ndërmjet Maqedonisë dhe Rosisë, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të [të ndjenjës kombëtare maqedonase](#). Narrativa të tilla pasurohen nga keqinformimi se qytetërimi perëndimor dhe tregu liberal po çojnë në vdekjen dhe shkatërrimin e «popullsisë autoktone evropiane», ndërsa Rusia paraqitet si «bastioni i fundit i vlerave tradicionale» në Evropë.

Ajo që mund të merret si konstante në gjithë këtë “luftë ndërkulturore” të bazuar në dezinformata, lajme të rreme dhe teori konspirative, është se shumë shpesh Rusia ndërhyr në anën e tradicionalistëve dhe mbështet të djathtët radikalë në vendet perëndimore. Transmetuesit rusë të financuar nga shteti si RT dhe Sputnik kanë transmetuar prej kohësh në vendet liberale perëndimore dhe [propaganda](#) e tyre që synon minimin e besimit në sistemet perëndimore shpesh është ndarë nga grupet e krahut të djathtë. Franca [ekspozoi kohët e fundit një fushatë të gjerë ruse](#) që synonte minimin e mbështetjes perëndimore për Ukrainën, raportoi agjencia shtetërore franceze Viginum, e cila synon të luftojë ndërhyrjet dixhitale të huaja. Lufta në Ukrainë ka intensifikuar ndjeshëm [dezinformatat dhe lajmet e rreme](#) që po përhapen në Perëndim dhe veçanërisht në Ballkan, e që burojnë nga “kuzhinat ruse”.



Foto: Nga një video e Kremlin.ru nga Parada e Fitores në Moskë, 05.09.2022



Foto: Qeveria.mk

## Rreziku që “margjinalët” të bëhen “mainstream” nuk është i vogël

Importimi i “luftërave ndërkulturore” të tilla në Maqedoninë e Veriut, i ndjekur nga një sërë dezinformimesh, lajmesh të rreme dhe manipulimesh, paraqet rrezik për demokracinë dhe e thellon më tej hendekun social. Tani për tani, debate të tilla mbeten në margjina pikërisht sepse nuk burojnë nga problemet e shoqërisë, por importohen për interesa të tjerëve. Por fakti që vitin e ardhshëm ka zgjedhje presidenciale dhe parlamentare në vend, fakti që ato lulëzojnë më së shumti në rrjetet sociale, si dhe fakti që një pjesë e madhe e popullatës së re [informohet për ngjarjet politike nga rrjetet sociale](#), rrit rrezikun që “margjinalët” të bëhen një moment i rëndësishëm në fushatën zgjedhore. Mund të çojë në polarizim dhe ndarje të mëtejshme të shoqërisë, një luftë mes partive dhe jo konkurrencë politike.

Sepse në luftën për vota, kur dominon retorika ekstreme si në të majtë, ashtu edhe në të djathtë, partitë shpesh dinë t’i bëjnë ballë grupeve të tilla qytetarësh, ndaj fillojnë të përdorin fjalime më ekstreme dhe të propozojnë politika nga pikat ekstreme në spektrin politik. Këtë praktikë e pamë vitin e kaluar, para, për dhe pas pranimit të të ashtuquajturit [propozimi francez](#) për fillimin e negociatave me BE-në, kur partitë opozitare, të ndihmuara nga mungesa e transparencës së qeverisë, duke përdorur dezinformata dhe spinime, u përpoqën të mobilizonin mbështetje duke përdorur retorikë që ndezin ndjenjat nacionaliste dhe mund të çonin në përplasje ndëretnike.

## Nuk është e saktë se BE-ja lufton për t'ua hequr të drejtat prindërore prindërve hungarezë

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 28.04.2023

Institucionet evropiane nuk janë kundër mbrojtjes së fëmijëve nga pedofilia dhe nga abuzimit seksual, por kundër asaj që me [Ligjin kontrovers për mbrojtjen e fëmijëve](#) në Hungari diskriminohet komuniteti LGBT. BE-ja nuk lufton për t'ua hequr të drejtat e prindërve hungarez dhe nuk e akuzon rrejtshëm qeverinë hungareze për miratimin e ligjeve diskriminuese, homofobike, siç pretendohet në postimin. Se ligji është diskriminues dhe homofobik nuk konsideron vetëm BE-ja, por edhe një numër të madh të [shoqatave](#), ndër të cilat edhe [Amensti International](#). Me ligjin [ndalohet](#) shpërndarja e informacioneve me të mitur me të cilat promovohet homoseksualizmi, ndryshimi i gjinisë dhe kufizohet përfaqësimi i grupeve LGBT në mediat.

[Postimi](#) në [rrjete](#) sociale pretendon se Bashkimi Evropian ka për qëllim heqjen e të drejtave prindërore në Hungari, pasi qeveria e atjeshme miratoi ligj me të cilin ndalohet propaganda lidhur me pedofilinë. Ja se çfarë thuhet saktësisht në postimin:

BE-ja premton se do ta dënojë Hungarinë dhe nënave dhe etërve do t'ua heqë të drejtat prindërore, pasi qeveria hungareze miratoi ligj me të cilin ndalohet që propaganda propedofile të mësohet në shkollat.

Ligji i Hungarisë për mbrojtjen e fëmijëve çoi në procedura juridike kundër vendit, ndërsa shumë vende majtiste të BE-së iu bashkuan protestës kundër miratimit të këtij ligji me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga shteti i cili i seksualizon.

Komisioni i BE-së, trupi drejtues që e filloi procedurën juridike, tha se ligji hungarez e shkel të drejtën e BE-së, të drejtat dhe vlerat themelore të BE-së.

BE-ja lufton për t'ua hequr të drejtat prindërve hungarezë, ndërsa e akuzojnë rrejtshëm qeverinë hungareze për miratimin e ligjeve diskriminuese, homofobike. Ligji i ri futi masa të ndryshme kundër keqpërdorimit të fëmijëve dhe pedofilëve në Hungari, përfshirë edhe ndalimin e institucioneve që e promovojnë marrëdhënien transgjimore dhe homoseksualizmin te fëmijët në moshë nën 18 vjeçare.

A janë ato vlerat e reja të BE-së?

A i duan agjitorët e hyrjes së Maqedonisë në BE ato vlera për fëmijët e tyre ose vetëm për fëmijët tanë?

Dhe si munden?

BE-ja ka alternativë.

[Ligji për mbrojtjen e fëmijëve](#) (Child protection law), për të cilin flitet në postin që e recensojmë, është ligj kontrovers në Hungari, kundër të cilit ishin pesëmbëdhjetë shtete nga Bashkimi Evropian, megjithatë nuk është e saktë ajo që është theksuar në postimin "*BE-ja ka premtuar se nënave dhe etërve do t'ua heqë të drejtat e tyre prindërore*". Kjo është dezinformatë.

Gjithsej 15 shtete të Bashkimit Evropian iu bashkuan padisë kundër këtij ligji, i cili u kritikua gjerësisht se është ligj kundër LGBT-së. Belgjika, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Austria, Irlanda, Danimarka, Malta, Spanja, Suedia, Finlanda, Sllovenia, Franca, Gjermania dhe Greqia, së bashku me Parlamentin Evropian, do të veprojnë si palë të treta në padinë e ngritur vitin e kaluar nga Komisioni Evropian.



**Qëndrojmë fuqishëm në angazhimet tona për një shoqëri inkluzive dhe për barazi për të gjithë, [deklaruan](#) nga Ministria e Punëve të Jashtme e Belgjikës e cila e udhëheq kontestin gjyqësor kundër këtij ligji kontrovers.**

Ligji konkret u miratua në qershor 2021 dhe përmban një dispozitë që ndalon ose kufizon rreptësisht përfaqësimin e homoseksualitetit dhe ndryshimit të gjinisë në media, si dhe në materialet edukative të destinuara për publikun nën moshën 18 vjeç. Kjo shkaktoi rezistencë politike, [disa vende nënshkruan letra të përbashkëta](#) dhe kryeministrat shprehën hapur mospajtimin e tyre me kolegun e tyre **Viktor Orban**.

Ligji zyrtarisht, sipas tekstit ligjor, synon të forcojë mbrojtjen e fëmijëve nga delikuentët seksualë dhe pedofilët. Por, Komisioni Evropian, i cili mbikëqyr nëse ligjet kombëtare janë në përputhje me ligjin e BE-së, kërkoi nga Hungaria të japë sqarim pse ndalimi për përmbajtjet LGBT ishte i nevojshëm për t'i arritur qëllimet kryesore të ligjit kundër pedofilisë. Më pas BE-ja ngriti procedurë kundër Hungarisë, duke vlerësuar se ky ligj cenon të drejtat themelore të njeriut.

**Ky ligj në Hungari është turp. Ky ligj i diskriminon qartë njerëzit në bazë të orientimit seksual dhe shkon kundër vlerave fundamentale të BE-së, e ato janë dinjiteti dhe barazia njerëzore, [deklaroj](#) kryetarja e Komisionit Evropian Ursula von der Lajen në vitin 2021.**

Pasi Hungaria refuzoi ta tërheqë ligjin, [Komisioni në korrik 2022](#) parashtroi padi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, e cila ka fuqinë për ta ndryshuar legjislacionin kombëtar. Por, Budapesti refuzoi të tërhiqet, duke u thirrur në referendumin e vitit 2022 ku nuk kishte kuorumi, përkatësisht nuk kishte numër të mjaftueshëm votash të vlefshme.

Në asnjë pjesë të vërejtjeve të trupave evropiane për përmbajtjen e ligjit, nuk përmendet informacioni i pavërtetë që plasohet përmes postimit që e recenzojmë se “BE-ja lufton për t’ua hequr të drejtat prindërve hungarezë”. Prindërit do të vazhdojnë t’i kenë të gjitha të drejtat mbi fëmijët e tyre, sipas legjislacionit kombëtar të Hungarisë. Por vërejtja e institucioneve evropiane është se mbrojtja e fëmijëve nga pedofilia dhe abuzimi seksual është të lidhet gabimisht me demonizimin e komunitetit LGBTI.

**Mbrojtja e fëmijëve është prioritet absolut për BE-në dhe vendet e saj anëtare. Por, ligji përmban dispozita të cilat nuk janë të arsyetuara në bazë të promovimit të këtyre interesave fundamentale ose janë joproportional që të arrihet qëllimi i dëshiruar, [vlerësojnë](#) nga Komisioni Evropian.**

Nga aty thonë se ligji i shkel këto rregulla të BE-së: [Direktiva për shërbimet mediatike audiovizuale](#), [Direktiva për tregti elektronike](#) (me ligjin ndalohen shërbimet në të cilat janë prezantuar orientime të ndryshme seksuale të të miturve, edhe kur këto shërbime vijnë nga shtete të tjera anëtare), [Marrëveshja](#) për lirinë [e ofrimit](#) të shërbimeve, si dhe direktiva të tjera,

Pra, institucionet evropiane nuk janë kundër mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi seksual, por kundër faktit që ligji kontrovers diskriminon komunitetin LGBT. BE-ja nuk po lufton për t’ua hequr të drejtat prindërve hungarezë dhe nuk e akuzon në mënyrë të rreme qeverinë hungareze për miratimin e ligjeve diskriminuese, homofobike, siç pretendon postimi. Se ligji është diskriminues dhe homofobik konsiderohet jo vetëm nga BE-ja, por edhe nga një numër i madh [shoqatash](#), përfshirë edhe Amnesti Internashënell, siç mund të shihet edhe nga [njoftimi i tyre](#).

Vlerat e BE-së janë [cekur](#) në mënyrë transparente dhe ato janë përfshirja, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe mosdiskriminimi. Pikërisht për ato vlera zotohen anëtarët e BE-së. [KE-ja vlerëson](#) se ligji vendos rregulla restriktive që i referohen shërbimit elektronik tregtar dhe shërbimeve të informacionit, aktiviteteve arsimore, klasifikimit të përmbajtjeve audiovizuale dhe marketingut dhe se bie ndesh me Deklaratën e të drejtave të njeriut. [Ligji ndalon](#) ndarjen e informacioneve me të miturit me të cilat promovohet homoseksualiteti, ndryshimi i gjinisë dhe kufizohet prezantimi i grupeve LGBT në media, në një mënyrë që e ndalon përmbajtjen e medias gjatë ditës në televizion dhe ndalon kompanitë të zhvillojnë fushata solidariteti me komunitetin LGBT.

Për shkak të të gjitha fakteve të lartpërmendura postimin që e recenzojmë, e vlerësojmë si të pavërtetë. Nuk është e vërtetë se BE-ja ka premtuar se nënave dhe etërve do t'ua heqë të drejtat e tyre prindërore.

## Është gënjeshtër se nëse je për BE duhet të hash insekte që të mos vdesësh

Shkruan: Miroslava Simonovska, 21.09.2023

Askush nuk i detyron qytetarët e BE-së të hanë insekte që të mos vdesin, siç vërtetohet kjo në postimin. Në analizën e tij për lajmet e rreme lidhur me insektet e ngrënshme, [Edmo.eu](https://edmo.eu) identifikon tre narrativë dezinformues, ndër të cilat edhe ai se qytetarët e BE-së do të hanë insekte bile edhe kundër vullnetit të tyre. Narrativët për insektet si ushqim i imponuar në Bashkimin Evropian mund të klasifikohen nën narrativët për “rivendosje të madhe” ose “rivendosje të ushqimit”



Po [analizojmë](#) një postim në [Facebook](#) ku pretendohet se në BE për të mos vdekur njerëzit do të duhet të hanë insekte.

■ Nëse je për BE, që të mos vdesësh do të hash insekte, qëndron në [postimin](#) në rrjetet sociale.

Pretendimi i tillë nuk është mbështetur me kurrfarë prapavijë ose sqarim dhe as nuk ofron ndonjë fakt. Postimi shoqërohet me një video të një folësi në Parlamentin Evropian, i cili flet në gjuhën kroate kundër politikës së BE-së për bujqësinë në vende të ndryshme anëtare.

[Vendimi i BE-së](#) në janar 2023 për të aprovuar disa produkte me prejardhje nga insektet për konsum njerëzor shkaktoi një valë dezinformatash në të gjithë BE-në. Në shumë shtete anëtare janë shfaqur lajme të rreme për insektet e fshehura në ushqim ose për insektet që janë të rrezikshme për konsum njerëzor. Në disa vende të Evropës Lindore, propaganda ruse ka përdorur dezinformatat aktuale për të vendosur lidhje me narrativë ekzistues që i ekzagjeron pasojat negative nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet mbi mënyrën evropiane të jetesës.

Në analizën e saj të lajmeve të rreme në lidhje me insektet e ngrënshme, [Edmo.eu](#) identifikon tre narrativë kryesore të dezinformatave, ndër të cilat edhe ai se qytetarët e BE-së do të hanë insekte edhe kundër vullnetit të tyre.

## Kërkesa e kompanisë private është shqyrtuar në BE 4 vite para se të aprovohet

Komisioni Evropian miratoi [rregullativë](#) me të cilën nga 3 janari 2023 në tregun aprovohet përdorimi i pluhurit nga aketa domestik (bulkthi shtëpiak), si ushqim i ri. Sipas dokumentit të publikuar në linkun, më 24 korrik 2019 kompania Kriket One Ko (kërkuesi) ka aplikuar në Komisionin Evropian për autorizimin e këtij pluhuri në tregun e BE-së si një ushqim i ri. Pluhuri është nga bulkthi shtëpiak, i destinuar për t'u përdorur në bukë integrale, krejera dhe simite, në bare drithërash, përzierje të thata për pjekje, biskota, produkte pastash me dhe pa mbushje, salca, produkte të përpunuara patatesh, pica, supa dhe koncentre për supë, pije të ngjashme me birrën, në çokolllatë dhe produkte të tjera të destinuara për popullatën e gjerë.

Më 23 mars 2022, Komisioni Evropian miratoi [mendim](#) shkencor për sigurinë e këtij pluhuri. Në mendimin shkencor thuhet se pluhuri i bulkthit shtëpiak është i sigurt nëse përdoret në kushtet e përcaktuara dhe nëse përdoret në nivelet dhe sasi të që janë të përcaktuara.

Prandaj, mendimi shkencor jep bazë të mjaftueshme që të arrihet në përfundim se pluhuri prej bulkthi shtëpiak kur përdoret në bukë integrale, bare drithërash, përzierje të thata për pjekje, biskota, pasta, salca, produkte të përpunuara patatesh, picë, supë dhe koncentre për supë, pije të ngjashme me birrën, çokolllatë etj., i përmbush kushtet për nxjerrjen e tij në treg në pajtim me rregulloret evropiane, [shkruan në dokumentin](#).

Gjithashtu, në 5 vitet e ardhshme, vetëm një prodhues do të ketë të drejtën ekskluzive për të përdorur këtë pluhur në produktet e tyre dhe askush tjetër. E drejta e tillë ekskluzive është gjithashtu e [cekur](#).

Firma e cila aplikoi për të përdorur pluhurin e bulkthit shtëpiak në tregun evropian në produktet e saj quhet Kriket One, dhe është një [prodhues i proteinave të bulkthit dhe insekteve të ngrënshme me zyrë](#) në Vietnam. Firma është themeluar në vitin 2017.

Megjithëse është e vërtetë që vendosja në treg e produktit të përmendur është aprovuar, assesi nuk bëhet fjalë për detyrim apo domosdoshmëri për blerjen apo konsumimin e tij për qytetarët e Bashkimit Evropian.

Dokumenti për miratimin e këtij produkti është publikuar më 3 janar 2023, në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian, me titullin: [“Leja që në treg të vihet në përdorim pluhuri pjesërisht pa yndyrë nga aketa domestikus \(bulkthi shtëpiak\) si një ushqim i ri”](#).

Në [dokumentin](#) (faqja 5), shkruan se shenja e ushqimit të ri në etiketën duhet të jetë “pluhur pjesërisht pa yndyrë prej bulkthi shtëpiak – aketa domestikus”. Në etiketën e artikujve ushqimorë që përmbajnë pluhur pjesërisht pa yndyrë prej bulkthi shtëpiak duhet të shkruhet në mënyrë eksplicite se kjo përbërje mund të shkaktojë reagim alergjik për konsumatorët që kanë alergji të njohur nga merimangat e pluhurit, gaforreve, butakëve. Informacioni i tillë duhet të paraqitet menjëherë në listën e përbërësve. Si rrjedhojë, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë dhe qasje në informacionin që përmban saktësisht ushqim të cilin e blejnë.

Do të thotë, etiketa do të vendoset menjëherë pranë listës së përbërësve, kështu që konsumatorët do të dinë nëse është shtuar pluhuri prej insekteve.

Zëdhënësi i Komisionit Evropian përmes emailit për Euronjuz ka vërtetuar se ushqimi do të duhet doemos të etiketohet.

**Informacione të detyrueshme për ushqim duhet doemos të jenë të disponueshme në paketimin. Indikacioni për alergji është i detyrueshëm dhe duhet doemos t’u sigurohet konsumentëve, [ka deklaruar](#) ai për Euronjuz.**

Sipas kësaj, qytetarët vetë do të vendosin nëse produktin do ta blejnë ose jo, askush nuk do t’i detyrojë në atë.

## Lajmet e rreme të bazuara pas narrativit “rivendosja e ushqimit”

Narrativët për insektet si një ushqim i imponuar në Bashkimin Evropian mund të klasifikohen nën narrativët e “rivendosjes së madhe ose “rivendosjes së ushqimit”. Kolegët nga portali rumun për verifikimin e fakteve [Veridika](#) e lidhën këtë lloj të dezinformatave për insektet si një ushqim i imponuar me narrativën e “rivendosjes së ushqimit”. Megjithatë produkti i pluhurit të bulkthit shtëpiak pjesërisht pa yndyrë është lëshuar në tregun e Bashkimit Evropian, konsumi i tij nuk u imponohet qytetarëve të Bashkimit Evropian. Përveç gjithë kësaj, produktet që përmbajnë pluhur të bulkthit shtëpiak do të etiketohen qartë.

Përdorimi i insekteve si një burim alternativ i proteinave nuk është i ri, insektet hahen rregullisht në shumë pjesë të botës. Një studim i fundit bëri një sintezë dhe tregoi se rreth 2000 lloje insektesh hahen në më shumë se 100 vende të botës, shkruan Veridika. Insektet e ngrënshme, veçanërisht bulkthi, janë pjesë e dietës tradicionale të disa vendeve të Azisë, si Kina, Japonia, Tajvani, Kamboxhia, Laosi, Mianmari, Vietnami, Tajlanda, por edhe në Afrikën Ekuatoriale e deri në Meksikë. Konsumimi i tyre bëhet në forma dhe raste të ndryshme. Përgatitja e tyre zakonisht përfshin skuqjen ose zierjen në avull për t’u konsumuar si pjatë kryesore ose si meze.

Nga të lartpërmendurat mund të arrijmë në përfundim se aprovimi i pluhurit të bulkthit shtëpiak si shtesë në ushqim nuk është i detyrueshëm për konsum për vendet anëtare të BE-së. Në produktet që përmbajnë pluhur bulkthi do të shënohet qartë dhe qytetarët do të vendosin nëse do ta blejnë atë produkt apo jo. Askush nuk i detyron qytetarët e BE-së të hanë insekte që të mos vdesin, siç pretendohet në postimin.

Në analizën e tij për lajmet e rreme lidhur me insektet e ngrënshme, [Edmo.eu](#) identifikon tre narrativë kryesore të dezinformimit, përfshirë edhe atë se qytetarët e BE-së do të hanë insekte edhe kundër vullnetit të tyre. Përdorimi i insekteve si një burim alternativ i proteinave nuk është i ri, dhe insektet hahen rregullisht në shumë pjesë të botës. Narrativët për insektet si një ushqim i imponuar në Bashkimin Evropian mund të klasifikohen nën narrativët e “rivendosjes së madhe” ose “rivendosjes së ushqimit”. Për shkak të kësaj, postimin të cilin e analizojmë, e vlerësojmë si i pavërtetë.

## Askund në Evropë nuk lejohet që fëmijët 8 vjeç të bëjnë çfarë të duan me trupin e tyre

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 30.09.2023

Nuk ka asnjë vend në Evropë ku **operacionet e ndryshimit të seksit** lejohen në moshën 8 vjeçare. Mosha për një operacion të tillë pa pasur nevojë që prindi të pajtohet është 18 vjeç në Bullgari, Qipro, Greqi, Francë, Hungari, Rumania dhe Sllovakia dhe 15 vjeç në Slloveni. Gjithashtu, në Austri, Çeki, Kroaci, Danimarkë, Finlandë, Itali, Letoni, Lituani, Holandë, Poloni, Portugali, Spanjë dhe Suedi, mosha për një operacion të tillë është 18 vjeç. Në Mbretërinë e Bashkuar është 16 vjeç, në Skoci 17 vjeç, në Angli dhe Uells 18 vjeç. Në Kroaci lejohet kryerja e një operacioni të tillë edhe para moshës 18 vjeç, por vetëm me pëlqimin e prindërve.

Po shqyrtojmë një **postim** në **Facebook** në të cilin thuhet:

Vlerat e BE-së fëmija nga mosha 8 vjeçare ka të drejtë të bëjë çfarë të doje me trupin e tij a looo, a e dini se ku po ju shpijnë këto satanistë.

Komisioni Evropian ka një **strategji** për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por në të nuk rregullohet ajo që shkruan në postimin e mësipërm, përkatësisht që një fëmijë 8 vjeç ka të drejtë të bëjë çfarë të doje me trupin e tij. Strategjia e BE-së për të drejtat e fëmijëve është zhvilluar për fëmijët dhe së bashku me fëmijët. Fëmijët duhet të kenë qasje në informacionet në një mënyrë adekuate të përshtatur për ta, në mënyrë që të mund të dinë qartë se cilat janë të drejtat e tyre dhe çfarë planifikon të bëjë BE-ja për ta. Prandaj, strategjia është paraqitur në një format të veçantë të cilën mund ta kuptojnë fëmijët dhe mund të gjendet në **linkun** e mëposhtëm.



Foto: pixabay.com

Siç mund të shihet nga strategjia, ajo [është e fokusuar](#) në arsimin cilësor inkluziv, mbrojtjen nga dhuna, ndihmën ndaj fëmijëve refugjatë, mundësimin e mbrojtjes shëndetësore për të gjithë fëmijët, mbrojtjen nga dhuna dhe legjislacionin që do t'i përfshijë nevojat e fëmijëve për mbrojtjen e tyre nga varfëria, t'u sigurohet ushqim cilësor dhe strehim adekuat.

Në Evropë, 18.3 për qind të popullsisë e përbëjnë fëmijët. Prej tyre, 22,2 për qind janë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social. Gjysma e fëmijëve në botë janë viktima të dhunës. Në vitin 2020, një e treta e të gjithë azilkërkuesve në vendet anëtare të BE-së janë fëmijë.

Gjithashtu, në BE 33 për qind e vajzave dhe 20 për qind e djemve kanë hasur në përmbajtje shqetësuese në internet në vitin 2020 të paktën një herë në muaj. Bazuar në këto fakte, Komisioni Evropian ka formuar strategjinë e tij me të cilën bëhen përpjekje për t'u përgjigjur problemeve më të rëndësishme në mënyrë që fëmijët të rriten më të lumtur dhe më të sigurt.

Sa u përket [operacioneve për ndryshimin e seksit](#), (i njohur edhe si operacioni i konfirmimit të seksit), i cili është proces i harmonizimit të pamjes fizike dhe organeve gjenitale me identitetin gjinor të dikujt, nuk ekziston vend në Evropë ku kjo lejohet në moshën 8 vjeçare.

[Në 13 nga 28 shtetet anëtare të BE-së](#), zbatohen rregullat e përgjithshme për operacion. Në këtë kontekst, moshë për një operacion të tillë pa pasur nevojë për pëlqimin e prindit është 18 vjeç në Bullgari, Qipro, Greqi, Francë, Hungari, Rumani dhe Sllovakia dhe 15 vjeç në Slloveni.

Mbi të gjitha, dymbëdhjetë vende anëtare lejojnë një operacion të tillë vetëm te personat në moshë madhore. Në Kroaci lejohet kryerja e një operacioni të tillë edhe para moshës 18 vjeçare, [por vetëm me pëlqimin e prindërve](#). Në Mbretërinë e Bashkuar kjo moshë është 16 vjeç, në Skoci 17 vjeç, në Angli dhe Uells 18 vjeç.

[Nuk ekziston vend në BE](#) ku një fëmijë në moshën 8 vjeçare mund të japë pëlqim për komunikim seksual me një të rritur. Në të gjitha vendet trajtohet si vepër penale e pedofilisë dhe dënohet me dënime rigoroze me burg.

[Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#) është një konventë e Kombeve të Bashkuara dhe një marrëveshje e rëndësishme midis vendeve të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në konventë sqarohet se kush janë fëmijët, të drejtat e tyre, si dhe përgjegjësia e qeverive ndaj tyre. Të gjitha të drejtat janë të lidhura, janë po aq të rëndësishme dhe nuk mund t'u hiqen fëmijëve. Një pjesë e të drejtave në Konventë janë që fëmija të regjistrohet në regjistrin e gjendjes civile menjëherë pas lindjes, që fëmija të mos ndahet nga prindërit e tij, përveç nëse nuk është në interesin e tij më të mirë dhe e vendosur nga gjykata, të ketë të drejtë të shprehet lirshëm, të mendojë lirshëm, të ketë të drejtën e fesë, etj. Ka shumë të drejta që janë përfshirë në Konventën për të Drejtat e Fëmijës meqë është një dokument i madh dhe mund ta shikoni [këtu](#).

Në Konventë është theksuar se fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha llojet e eksploatimit, bile edhe nga ajo që nuk përmenden në Konventë. Sipas [Konventës](#), qeveritë duhet doemos të kujdesen që fëmijët të mos rrëmbehen ose të dërgohen në vende të tjera për t'u eksploatuar. Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga puna e cila është e dëmshme ose e rrezikshme për edukimin, shëndetin ose zhvillimin e tyre. Qeveritë duhet t'i mbrojnë fëmijët nga dhuna ose neglizhenca nga ata që kujdesen për ta.

Neni 34 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve thotë se qeveritë duhet t'i mbrojnë fëmijët nga eksploatimi seksual dhe abuzimi seksual, duke përfshirë edhe nga njerëzit që i detyrojnë fëmijët të bëjnë seks për para, ose i fotografojnë ata në mënyrë të papërshtatshme ose i incizojnë. Kjo është arsyeja pse pornografia e fëmijëve është e dënueshme dhe një vepër penale në të gjithë Evropën.

Kur shikon Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe [pikat](#) e saj, përkatësisht aspektet më të rëndësishme në të cilat fokusohen direktivat dhe ligjet evropiane, është e dukshme se gjithçka në dokument është në interesin më të mirë të fëmijëve, zhvillimit të tyre gjithëpërfshirës dhe janë marrë parasysh aspekte të ndryshme edhe për fëmijët më vulnerabilë edhe për ata që kanë familje funksionale. Sipas Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve, fëmijë është çdo individ nën moshën 18 vjeç. Fokusi është kujdesi shëndetësor, e drejta për arsimim, mbrojtje nga dhuna, e drejta për shtëpi, mbrojtje nga çdo lloj eksploatimi etj.

Legjislacioni vendor, si dhe legjislacioni i vendeve anëtare të BE-së i mbron të drejtat e fëmijëve, përkatësisht sigurinë e tyre, të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, mbrojtje nga dhuna, të drejtën për një shtëpi të sigurt, etj. Për të gjitha faktet e mësipërme, konsiderojmë se *nuk është e vërtetë* që fëmijët 8 vjeç kanë të drejtë të bëjnë çfarë të duan me trupin e tyre dhe se këto janë vlera evropiane.



## 2. Lufta informative kundër Ukrainës

**A**gresioni ushtarak kundër Ukrainës i shkaktuar nga asgjë nuk duhet të justifikohet disi. Prandaj, është e nevojshme të aktivizohet segmenti i dytë i një pushtimi të tillë - lufta informative. Prandaj Kremli vendosi t'i përtërijë narrativët ekzistues dhe të krijojë narrativë të rinj edhe kundër Ukrainës edhe kundër aleatëve të saj dhe të fillojë ofensivë të re dezinformuese, diçka që nuk është e panjohur për ish-pushtetarët. Ofensiva të tilla kanë praktikuar kundër Ukrainës që nga viti 2014, kur ishte e domosdoshme të arsyetohet dhuna separatiste dhe marrja e kontrollit mbi Donbasin, pjesa lindore e Ukrainës që kufizohet me Rusinë, si dhe okupimi, e pastaj edhe aneksimi i Krimesë.

Me fillimin e pushtimit të plotë, nevoja për dezinformim në nivel global u intensifikua edhe më shumë, me ç'rast qëllimi kryesor ishte që të arsyetohet agresioni dhe faji për të t'i hidhet dikujt tjetër. Dhe kështu filluan dezinformatat për biolaboratorët e supozuar për prodhimin e armëve kimike në Ukrainë, pretendimet se ShBA-ja lufton në Ukrainë deri tek ukrainasi i fundit dhe trillimet për një sulm të supozuar nga Ukraina ndaj rajoneve separatiste që u parandalua me pushtimin. Dhe kështu Ukraina filloi të përjetonte edhe një pushtim me dezinformata, krahas pushtimit të kryer me armë.

## Pesë narrativa manipuluese kundër NATO-s për luftën në Ukrainë

Në internet qarkullojnë disa narrativë kundër NATO-s, të cilat janë bërë veçanërisht të zakonshme pas agresionit ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, dhe që synojnë të krijojnë një justifikim për të njëjtin agresion në një mënyrë që akuzojnë Aleancën për veprime ushtarake.

Shkruan: **Miroslava Simonovska**, 07.03.2023



Foto: nato.int

## 1. Narrativa dezinformuese:

### NATO është një kërcënim për paqen në botë

NATO është një aleancë mbrojtëse, qëllimi i së cilës është të mbrojë vendet anëtare. Çdo vend që i bashkohet NATO-s pajtohet me politikat dhe parimet e saj. Kjo përfshin angazhimin se NATO nuk kërkon konfrontim dhe nuk përbën kërcënim për Rusinë, siç u [riafirmua](#) në Samitin e Brukselit.

Zgjerimi i NATO-s nuk është i drejtuar kundër Ruisë. Çdo komb sovran ka të drejtë të zgjedhë konstelacionet e veta të sigurisë. Ky është një parim themelor i sigurisë evropiane, që edhe Rusia i është bashkuar zyrtarisht dhe duhet ta respektojë. Në fakt, pas Luftës së Ftohtë, Rusia pranoi të ndërtonte një arkitekturë gjithëpërfshirëse të sigurisë evropiane, nëpërmjet krijimit të OSBE-së, krijimit të Këshillit Euro-Atlantik, etj.

Siç [thuhet](#) në faqen e NATO-s, NATO nuk sulmoi Gjeorgjinë dhe NATO nuk sulmoi Ukrainën. Rusia e bëri atë.

NATO ka kontaktuar vazhdimisht Rusinë gjatë 30 viteve të fundit. Ne kemi punuar së bashku në tema që kanë të bëjnë me parandalimin e krimit narkotik, kundër terrorizmit, shpëtimit në nëndetëse edhe në periudha kur NATO zgjerohej. Por në vitin 2014, në përgjigje të veprimeve agresive të Ruisë kundër Ukrainës, NATO pezulloi bashkëpunimin praktik me Rusinë. Ne nuk kërkojmë një konfrontim, por nuk mund të anashkalojmë faktin se Rusia po shkel rregullat ndërkombëtare, duke minuar stabilitetin dhe sigurinë tonë, [thënë nga NATO](#).

Në përgjigje të përdorimit të forcës ushtarake nga Rusia kundër Ukrainës, NATO dërgoi katër grupe në shtetet baltike dhe Poloni në vitin 2016.

Përpara se Rusia të aneksonte ilegalisht Krimenë, nuk kishte trupa të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës. Në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022, NATO ka forcuar ndjeshëm pozicionet e saj mbrojtëse, duke përfshirë katër grupe të reja në pjesën lindore të Aleancës. Në samitin e NATO-s në Madrid, aleatët ranë dakord se Rusia është kërcënim më i rëndësishëm dhe më i drejtpërdrejtë për sigurinë e tyre dhe për paqen dhe stabilitetin e zonës euro-atlantike. Aleatët ranë dakord të forcojnë pozicionet e NATO-s edhe në të ardhmen. Megjithatë, aleatët mbeten ende të hapur për të pasur kanale të hapura komunikimi me Moskën për të shmangur rreziqet, për të parandaluar përshkallëzimin dhe për të rritur transparencën, [shkruan në faqen e Aleancës](#), e cila rendit faktet për marrëdhëniet NATO-Rusi.

NATO ekziston që nga viti 1949, e themeluar menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi i formimit është të sigurojë paqen në Evropë dhe të promovojë bashkëpunimin midis anëtarëve si dhe të mbrojë lirinë e tyre, të gjitha në kuadër të përballjes së kërcënimit të asaj kohe nga Bashkimi Sovjetik. Dokumenti themelues për formimin e NATO-s i angazhon aleatët për demokracinë, lirinë individuale dhe sundimin e ligjit, si dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Ai gjithashtu hedh themelet për idenë e mbrojtjes kolektive, që do të thotë se një sulm kundër një aleati është një sulm kundër të gjithë aleatëve. Që nga fillimi i ekzistencës së NATO-s e deri më sot, paqja botërore nuk ka qenë kurrë nën kërcënim siç ishte pasi Rusia pushtoi Ukrainën.



Foto: en.wikipedia.org

## 2. Narrativa dezinformuese: NATO-ja bombardoi pa mëshirë Serbinë dhe Sirinë

Më 14 prill 2018, Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar [njoftuan aleatët](#) për veprimin e tyre të përbashkët ushtarak të 14 prillit. Ata informuan se një sasi e konsiderueshme informacioni tregonte se regjimi sirian ishte përgjegjës për sulmin ndaj civilëve në qytetin sirian të Douma më 7 prill të po këtij viti dhe se veprimi i tyre ushtarak ishte i kufizuar vetëm në regjimin sirian, gjegjësisht objektet e saj përmes të cilave prodhoheshin armët kimike. Të tre vendet aleate [theksuan](#) se praktikisht nuk kishte alternativë përveç përdorimit të forcës.

Aleatët kanë shprehur mbështetjen e tyre të plotë për një veprim të tillë, i cili synon të dobësojë regjimin sirian, aftësitë e tij për të përdorur armë kimike dhe parandalimin e përdorimit të mëtejshëm të armëve kimike kundër njerëzve në Siri. Përdorimi i armëve kimike nuk mund të mbetet pa u ndëshkuar dhe as të normalizohet, pasi është një rrezik për popullin sirian dhe sigurinë kolektive të NATO-s.

Aleatët dënojnë me forcë përdorimin e përsëritur të armëve kimike nga regjimi sirian dhe bëjnë thirrje për përgjegjësi. Aleatët po i bëjnë gjithashtu thirrje regjimit sirian që të lejojë qasje të shpejtë, të qëndrueshëm dhe të papenguar në ndihma humanitare. Pavarësisht përpjekjeve diplomatike për ta parandaluar atë, regjimi sirian ka përdorur vazhdimisht armë kimike kundër civilëve, duke kontribuar në vuajtje të paprecedentë që nga fillimi i konfliktit në vitin 2011. Përdorimi i armëve të tilla është një shkelje flagrante e standardeve dhe normave ndërkombëtare, disa rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe konventës së armëve kimike që Siria ratifikoi në vitin 2013. NATO konsideron se përdorimi i armëve kimike në Siri nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë është një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, [tregohet në deklaratën e atëhershme të Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi veprimet e ndërmarra kundër përdorimit të armëve kimike në Siri.](#)

Nga ana tjetër, ish-Jugosllavia nuk u shpërbë për shkak të NATO-s. Aleanca nuk përdori forcën ushtarake për të ndryshuar kufijtë e ish-Jugosllavisë. Nga viti 1992 deri në vitin 1995, NATO kreu disa operacione ushtarake në Bosnje, aktivitete që ishin nën mandatin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pjesë e të cilit ishte edhe Rusia.

Rusia nuk e kundërshtoi operacionin e NATO-s në Libi në vitin 2011. Operacioni i NATO-s në Kosovë në vitin 1999 pasoi një përpjekje diplomatike njëvjeçare të OKB-së dhe grupit të kontaktit, pjesë e të cilit ishte Rusia, për t'i dhënë fund konfliktit. Këshilli i Sigurimit i OKB-së e vlerësoi spastrimin etnik në Kosovë dhe rritjen e numrit të refugjatëve e vlerësoi si kërcënim për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare. Misioni i NATO-s ndihmoi t'i jepet fund keqpërdorimeve të mëdha të të drejtave të njeriut dhe vrasjeve të civilëve, *thuhet në uebsajtin e NATO-s.*

Qeveria serbe [vlerëson](#) se 2,500 njerëz vdiqën dhe 12,500 u plagosën në bombardimet e NATO-s të vitit 1999, megjithëse numri i saktë i viktimave mbetet i panjohur. Sipas informacioneve të publikuara nga [Fondi për të Drejtën Humanitare](#), ka pasur 756 të vdekur gjatë bombardimeve. Në Ukrainë, 8,101 civilë [u konfirmuan](#) të vdekur nga fillimi i pushtimit rus deri më 26 shkurt 2023. Prej tyre 488 janë fëmijë. 13,479 persona u plagosën. Shifrat aktuale mund të jenë më të larta. Nuk ka aq shumë viktime në aksionet e NATO-s sa [në bombardimet që Rusia po kryen në Ukrainë.](#)

### 3. Narrativa dezinformuese: NATO-ja është një organizatë agresore

NATO nuk ka aneksuar kurrë territorin e askujt, ndryshe nga Rusia, e cila që nga viti 1993 ka pushtuar pjesë të territoreve të Gjeorgjisë, Moldavisë dhe [Ukrainës.](#)

NATO është një aleancë mbrojtëse. Vendimi i Ukrainës për t'u anëtarësuar në NATO është një vendim individual. Rusia nuk mund të parandalojë apo të ndikojë në këtë proces sovran. Qëllimi i Ruisë është [të ngatërrojë ose të tjetërsojë](#) publikun, në mënyrë që ata të mos dallojnë faktin nga trillimi. Fushata ruse synon të rrisë tensionet gjeopolitike midis Moskës dhe Perëndimit dhe ta portretizojë NATO-n si një armik.

Vetë Ukraina është [vendimtare](#) se agresioni ushtarak është vetëm një nga elementët e luftës hibride ruse kundër Ukrainës. Elementët e tjerë janë propaganda të bazuara në gënjeshtër dhe falsifikime, presionet ekonomike, bllokada energjetike, frikësimi i popullit ukrainas, sulmet kibernetike, mohimi i fortë i luftës kundër Ukrainës, pavarësisht provave dërrmuese dhe akuzave të palës tjetër për krimet e veta.

Në vitin 2019, [në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Ukrainës](#) u njoftua se agresioni rus çoi në fatkeqësi të mëdha humanitare, 9,940 të vdekur, 23,455 të plagosur. Kjo shifër përfshin 80 fëmijë të vrarë në një sulm terrorist më 17 korrik 2014. Rreth 1,584,000 njerëz nga Donbass dhe Krimea janë zhvendosur brenda vendit pasi janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre.

[NATO dënon fuqishëm](#) sulmet brutale dhe të paprovokuara të Ruisë ndaj Ukrainës, e cila si një vend i pavarur, paqësor dhe demokratik është një partner i ngushtë i NATO-s. NATO dhe aleatët vazhdojnë të mbështesin Ukrainën në përpjekjet e saj për të ruajtur të drejtën e saj themelore për vetëmbrojtje.

Që kur Rusia aneksoi ilegalisht Krimenë dhe destabilizoi Ukrainën lindore në vitin 2014, NATO ka miratuar një qëndrim të fortë në mbështetje të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Aleatët dënojnë dhe nuk do ta njohin kurrë Krimenë e aneksuar ilegalisht dhe në mënyrë të paligjshme, [shkruan në faqen e NATO-s](#).

NATO gjithashtu dënon përpjekjet e paligjshme të Rusisë për të aneksuar katër rajone nga Ukraina - Donetsk, Luhansk, Zaporizhia dhe Kharkiv në shtator 2022, që është përpjekja më e madhe për aneksimin me forcë të territorit evropian që nga Lufta e Dytë Botërore.

Referendumi i rremë në këto rajone u projektua nga Moska dhe u imponua me forcë Ukrainës. Ata nuk kanë legjitimitet dhe NATO nuk do t'i njohë. Këto territore janë Ukraina dhe do të jenë gjithmonë Ukrainë. Numri i madh i votave në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së që dënon përpjekjen ruse për të përvetësuar territoret dërgoi një mesazh të qartë dhe të fortë se Rusia është e izoluar dhe se bota është në anën e Ukrainës, [thuan nga NATO](#).

#### 4. Narrativa dezinformuese:

##### Perëndimi përmes NATO-s dëshiron ta kthejë të gjithë botën në skllav të interesave dhe ekonomisë së tyre

Politika ekonomike e Perëndimit në lidhje me globalizimin ka çuar në përparim të jashtëzakonshëm dhe rritje ekonomike në mbarë botën. Numri i njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme ka rënë në mënyrë dramatike. Është një tregues se nuk bëhet fjalë për skllavërim. Nëse doni të robëroni dikë ekonomikisht, atëherë ai nuk do të lejohet as të zhvillohet ekonomikisht.

Agresioni rus në Ukrainë [çoi në trazira masive në ekonominë globale](#), veçanërisht në tregjet e energjisë dhe ushqimit, dhe çmimet filluan të rriten. Krahasuar me rajonet e tjera ekonomike, rajoni evropian ndjen pasojat e agresionit rus kundër Ukrainës. Sidomos sepse rajoni evropian kishte importe energjie nga Rusia, ndërsa Rusia dhe Ukraina së bashku luanin një rol të rëndësishëm në eksportet e ushqimit përpara fillimit të pushtimit rus.

Organizata Botërore e Tregtisë paralajmëroi që në prillin e kaluar (2022) se [pushtimi](#) i Ukrainës, përveçse shkaktoi vuajtje të mëdha njerëzore, [dëmtoi tregtinë globale](#), e cila do të prekte më shumë vendet më të varfra.

## 5. Narrativa dezinformuese:

### Lufta në Ukrainë është një rezistencë kundër fushatës ushtarake të NATO-s

Nuk ka asnjë fushatë ushtarake të NATO-s, dhe veçanërisht jo në Ukrainë dhe rreth saj. NATO nuk është në luftë me Rusinë dhe nuk kërkon konfrontim me Rusinë. Ajo që NATO po bën është të mbështesë Ukrainën në të drejtën e saj për vetëmbrojtje, siç përcaktohet në Kartën e OKB-së. NATO po merr vetëm masa rreptësisht mbrojtëse për të forcuar praninë e saj në pjesën lindore të Aleancës.

Kjo siguron se nuk ka vend për keqkuptime në Moskë për gatishmërinë tonë për të mbrojtur aleatët tanë. Detyra jonë kryesore është t'i mbajmë kombet të sigurta. Ne kemi përgjegjësinë të sigurojmë që konflikti të mos përshkallëzohet jashtë Ukrainës, sepse kjo do të ishte edhe më e rrezikshme...

Stërvitjet tona nuk kanë për qëllim Rusinë apo ndonjë vend tjetër, [thuhet në faqen e NATO-s](#).

Ky mit gjithashtu injoron gjeografinë. Vetëm 6 për qind e kufijve të territorit rus prekin vendet e NATO-s. Rusia ka kufij tokësorë që kufizohen me 14 vende. Vetëm pesë prej tyre janë anëtarë të NATO-s. Jashtë territorit të NATO-s, Aleanca ka një prani ushtarake vetëm në Kosovë dhe Irak. Në Irak, misioni i NATO-s kontribuon në luftën kundër terrorizmit dhe është me kërkesë të qeverisë irakiane me respekt të plotë për sovranitetin e Irakut. Në të kundërt, Rusia ka baza dhe trupa ushtarake në Gjeorgji, Moldavi dhe Ukrainë pa pëlqimin e qeverive të këtyre vendeve. Përveç kësaj, [lufta e Ruisë kundër Ukrainës](#) ka prishur paqen, stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare.

## Amerika nuk i premtoi Rosisë se NATO nuk do të zgjerohet

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 05.10.2023



Bush-Gorbashov, Helsinki 1990.

Foto: Susan Biddle, Public domain, via Wikimedia Commons

Nuk ka asnjë marrëveshje të nënshkruar nga SHBA, Evropa dhe Rusia që NATO nuk do të zgjerohet. Ideja e zgjerimit të NATO-s përtej Gjermanisë nuk ishte në rendin e ditës në vitin 1989, sepse Traktati i Varshavës ekzistonte. Kjo u konfirmua nga Mikhail Gorbachev në një intervistë në [vitin 2014](#).



Po shqyrtojmë një [postim](#) në rrjetin social [Facebook](#) ku thuhet:

Jeffrey Sachs për krizën në Ukrainë. SHBA hodhi bazat për një operacion special shumë kohë përpara se Putini të zgjidhej.

“Presidenti amerikan i premtoi Mikhail Gorbachev 30 vjet më parë se NATO nuk do të lëvizte as pak në lindje... Fatkeqësisht, tashmë në fillim të viteve 90 filluan të planifikonin zgjerimin e NATO-s në vetë Ukrainën. Sipas mendimit tim, ky është gabimi më i madh që kanë bërë Shtetet e Bashkuara”, tha ekonomisti amerikan dhe profesori i Universitetit të Kolumbisë, Jeffrey Sachs në kanalën e tij në YouTube. Sachs pranoi se ky veprim minoi besimin midis Uashingtonit dhe Moskës dhe se ishte shkaku i konfliktit në Ukrainë. “E gjithë kjo filloi shumë përpara presidencës së Putinit. Baza ishte besimi i Amerikës në konceptin e një bote unipolare. Ky besim ishte i gabuar, i rrezikshëm dhe provokues”.

Pretendimi se të drejtat gjuhësore të rusëve në Ukrainë janë shkelur është i pavërtetë. Më 25 prill 2019, Verkhovna Rada miratoi ligjin që do të sigurojë që gjuha ukrainase të jetë gjuhë shtetërore. Rosishtja, si gjuhët e tjera, mund të përdoret në komunikim privat, në ceremoni fetare, në shtyp, botim librash, etj. Ligji lejon edhe përdorimin e gjuhëve të tjera në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Sipas **EuVsDisinfo**, 27 për qind e qytetarëve ukrainas përdorin gjuhën ruse në komunikimin e tyre të përditshëm dhe gjuhën ukrainase e preferojnë 51 për qind e ukrainasve, ndërsa 21 për qind e tyre flasin të dy gjuhët.

Sa i përket pretendimit në postim se Zelenski ka refuzuar të mbajë zgjedhje, ky është dezinformim sepse **Kushtetuta e Ukrainës** nuk lejon mbajtjen e zgjedhjeve përderisa shpallet gjendja ushtarake!

Gjendja ushtarake është shpallur që nga shkurti i vitit 2022 për shkak të pushtimit të Rusisë në Ukrainë. Pra, jo Zelenski, por **Kushtetuta e Ukrainës** nuk lejon mbajtjen e zgjedhjeve gjatë një gjendje të shpallur ushtarake.

Lidhur me pjesën e postimit ku thuhet se NATO po falimenton Europën për këtë liri, është ironike, por NATO nuk është në konflikt të drejtpërdrejtë ushtarak me Rusinë, **por po mbron të drejtën e Ukrainës për t'u mbrojtur nga agresioni ushtarak**. Kështu, veprimet e NATO-s janë mbrojtëse, të dizajnuara jo për të provokuar konflikt, por për ta parandaluar atë. Aleanca ka përgjegjësinë të sigurojë që lufta të mos përshkallëzohet jashtë Ukrainës, gjë që do të ishte edhe më katastrofike dhe e rrezikshme.

Për të gjitha faktet e mësipërme, ne e vlerësojmë postimin që po shqyrtojmë si të pavërtetë.



Volodimir Zelenski duke iu drejtuar „Radës së Lartë“  
me rastin e Ditës së Kushtetutës së Ukrainës - 28 qershor 2023  
**Burimi:** Zyra e Presidentit të Ukrainës, ([president.gov.ua](http://president.gov.ua)), CC-BY4.0, domeni publik

## Nuk është e vërtetë që mediat ukrainase kanë redaktuar regjistrime të rreme të fjalimit të Zelenskit në OKB

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 04.10.2023

Publikimi që pretendon se mediat ukrainase donin të tregonin se gjatë fjalimit të Zelenskit në OKB kishte më shumë dëgjues në audiencë se sa kishte realisht, është i pavërtetë. Bëhet fjalë për montimin e videos origjinale nga mediat ukrainase nga një propagandist i famshëm rus

Ne po shqyrtojmë një [postim](#) në rrjetin social [Facebook](#) ku shpërndahet një video e fjalimit të presidentit ukrainas Volodimir Zelenski në OKB dhe thotë:

**21.09.2023** Mediat ukrainase redaktuan fjalimin e Zelenskit në OKB për ta bërë të duket sikur ai kishte një audiencë më të madhe. Ata harruan të redaktonin vetë Zelenskin, i cili ishte ulur në audiencë. Shihni në 0:14.

Kur e shikoni videon, shfaqet Zelenski duke folur, por në sekondën e 14-të në kornizën e shfaqur si insert, derisa ai flet, shihet se edhe ai është ulur në audiencë.

Dezinformimi është se mediat ukrainase kanë dashur të paraqesin me redaktim se gjatë fjalimit të Zelenskit në OKB ka pasur më shumë dëgjues në audiencë se sa kishte dhe se ata janë «kapur» në të në atë mënyrë që kanë vendosur një insert të vetë Zelenskit, ulur në audiencë gjatë fjalimit të tij. Ka mohim zyrtar të kësaj nga mediat ukrainase, si dhe një histori e plotë se si u shfaq dhe u përhap dezinformimi si pjesë e propagandës ruse.

Përkatësisht, një nga mediat ukrainase, logoja e së cilës përdoret edhe në videon e postimit që po rishikojmë, ka publikuar një [përgënjeshttrim me titullin](#) “Njoftim nga Edini Novy, për maratonën në lidhje me informacionin e rremë se ka pasur ndryshime në transmetimin e drejtpërdrejtë i fjalimit të Presidentit të Ukrainës në OKB”.



Presidenti i Ukrainës gjatë fjalimit të tij në seancën e 78-të të Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 19 shtator 2023

**Burimi:** OKB Foto/Mark Garten (UN Photo/Mark Garten)

## Manipulim i propaganduesit pro-rus Anatoli Shariy

Aty thuhet se më 21 shtator, burime pro-ruse filluan të përhapin informacione të rreme në lidhje me ndryshimet e supozuara në fjalimin e Volodimir Zelenski në OKB.

Ekipi i Edini Novy informon se ky informacion është i pasaktë dhe u bën thirrje shoqatave të gazetarëve dhe autorëve të përmbajtjeve digjitale që të kundërshtojnë këtë tregim të rremë rus. Burimi i videos së rreme është propagandisti pro-rus Anatoli Shariy, i cili e postoi videon e redaktuar në kanalën e tij Telegram. Faqet ruse NTV, Reporter, Channel 1, Federal Press dhe burime të tjera të ngjashme publikuan të njëjtën video, duke shtrembëruar realitetin në stilin e tyre karakteristik. Fatkeqësisht, përhapja e këtij dezinformimi u mbështet nga disa burime ukrainase dhe evropiane. Midis tyre janë agjenci lajmesh, kanale Telegram dhe individë. Të gjitha palët e interesuara mund të sigurohen që informacioni dhe vetë videoja janë të rreme. Një tjetër konfirmim se bëhet fjalë për një video të rreme është mospërputhja e shënuesve vizualë. Kanalet e maratonës përdorin grafika shtesë, si p.sh. një gjeo-header, që nuk ekzistojnë në videon e rreme. Gjithashtu, gjatë transmetimit, fjalimi i presidentit është përkthyer njëkohësisht nga një prezantues tjetër, diçka që mund të verifikohet lehtësisht”, [thotë Media 1 plus 1](#).

Videoja e rreme e përdorur në fragmentin e fjalimit të Zelenskit u postua në kanalën YouTube të [TSN-së](#), por fragmenti specifik i videos nuk përmban pamje nga salla përveç fjalimit të presidentit nga podiumi.

Ju lutemi vini re se videoja origjinale nuk ka logon grafike 1+1 Marathon, e cila është shtuar nga krijuesit e videos së rreme në këndin e sipërm djathtas, thuhet në mohim. Kjo nuk është hera e parë që burime ruse apo pro-ruse përdorin markën e kanaleve televizive të njohura ukrainase për të manipuluar publikun. Redaktorët e Edini Novinni bëjnë thirrje për një hetim mbi arsyet e përhapjes së lajmeve të rreme në fushën e informacionit ukrainas dhe tërheqin vëmendjen për mungesën e kontrollit të fakteve në disa media, kanale Telegram dhe individë ukrainas. Është e rëndësishme që autorët e postimeve të tilla të deklarojnë publikisht se kanë dështuar dhe të informojnë lexuesit e tyre se informacioni i publikuar është i rremë, [thuhet në njoftimin e Media 1 plus 1](#).

Instituti i Komunikimeve Masive raportoi se propagandistët po pretendojnë në mënyrë të rreme se video e fjalimit të Zelenski është redaktuar në transmetimin e drejtpërdrejtë në mediat ukrainase. Për të gjitha faktet e mësipërme, ne e vlerësojmë postimin që po shqyrtojmë si të pavërtetë.



Volodimir Zelenski gjatë vizitës së tij në rajonet Kherson dhe Mykolaiv, 20 tetor 2023.

**Burimi:** Faqja e internetit e Kabinetit Presidencial të Ukrainës ([president.gov.ua](https://www.president.gov.ua)), CC BY 4.0, Domen Publik



Volodimir Zelenski gjatë vizitës së tij në Vatikan dhe Itali  
takoi Papa Françeskun, më 13 maj 2023

Burimi: Zyra e Presidentit të Ukrainës, ([president.gov.ua](https://www.president.gov.ua)), CC.BY.4.0, Domen Publik

## Historia nuk përsëritet, sepse Zelenski nuk është Hitleri

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 22.05.2023

Nuk është hera e parë që në rrjetet sociale shpërndahen narrativë se Ukraina është naziste dhe fashiste, se atje lavdërohet nazizmi (neo-nazizmi) dhe se Zelenski është nazist. E gjithë kjo është bërë për të justifikuar agresionin rus kundër këtij vendi sovran që ka më shumë se një vit.

Po shqyrtojmë një [postim](#) në [Facebook](#) që krahason liderin nazist të Gjermanisë Adolf Hitler me Presidentin e Ukrainës Volodimir Zelenski, duke theksuar se “historia përsëritet”.

Postimi shpërndan dy fotografi. Njëra [daton](#) nga viti 1933 dhe tregon Adolf Hitlerin duke përshëndetur Alberto Vassallo di Torregrossa, Nunc Apostolik në Bavari me rastin e Ditës së Artit Gjerman në Mynih.

Fotoja e dytë është nga takimi i fundit i Zelenskit me Papa Françeskun.

Të pretendosh se historia përsëritet dhe të bësh një paralele mes Zelenskit dhe Hitlerit është një spin klasik dhe është në frymën e propagandës ruse.

Teoricienët e konspiracionit dhe propagandistët rusë përpiqen vazhdimisht ta portretizojnë presidentin e Ukrainës si një simpatizant neonazistë ose nazist, edhe pse Zelenski është hebre dhe tre familjarë të tij vdiqën në [Holokaust](#).

Duke komentuar këto akuza, Zelenski dikur [tha](#) se Moska “*ndjek të njëjtin koncept të Goebbels dhe ata përdorin të njëjtën metodologji*” në përpjekjen për të justifikuar luftën kundër Ukrainës.

Nuk është hera e parë që në rrjetet sociale shpërndahen narrativa se Ukraina është naziste dhe fashiste, se atje lavdërohet nazizmi (neo-nazizmi) dhe se Zelenski është nazist. E gjithë kjo është bërë për të justifikuar agresionin rus kundër këtij vendi sovran që ka më shumë se një vit.

Vërtetmatësi ka shkruar për këtë temë, kur Zelenski është krahasuar në mënyrë manipulative dhe të pabazë me [Hitlerin](#) dhe ka qarkulluar edhe një [foto](#) në të cilën ai kinse mban një këmishë me një svastikë në të. Kontrolluesit e fakteve të AFP [treguan](#) se fotografia e shpërndarë ishte ndryshuar në mënyrë digjitale dhe se fotografia ishte manipuluar.

U shpërnda edhe një [fotografi](#) pas një dasme, ku të sapomartuarit duket se po rikrijojnë një përsëritje naziste me flamurin ukrainas në sfond. Megjithatë, verifikimi i fakteve zbuloi se fotografia e të ftuarve të dasmës që imiton një përsëritje naziste nuk ishte bërë në Ukrainë, por në Rusi.

Narrativa neo-naziste filloi në fund të [shkurtit 2022](#) nga presidenti rus Vladimir Putin, i cili tha se udhëheqja e Ukrainës përfshinë neo-nazistë. Putin, duke nisur “operacionin e tij special” në Ukrainë, e justifikoi ndër të tjera me “denazifikimin” e këtij vendi.

Përdorimi i termit “denazifikim” në konotacion me Ukrainën është krejtësisht i gabuar, [vlerëson](#) politologu Andreas Umland nga Qendra e Stokholmit për Studimet e Evropës Lindore (SCEEUS). Ai thekson se presidenti aktual i Ukrainës është një hebre që mundi një kandidat jo-hebre në zgjedhjet e fundit.

Umland vëren se ka forca ekstremiste të krahut të djathtë në Ukrainë, të cilat, megjithatë janë ende të dobëta në krahasim me vendet e tjera evropiane.

## 4. Anti-vakserët - nga KOVID-19 deri te lufta kundër gjithë sistemit shëndetësor

**P**andemia e KOVID-19 u shfaq në kohën e duhur për të mbështetur “kauzën” kundër vaksinave. Fatkeqësisht, antivakserët para fillimit të pandemisë nuk ishin thjesht një grup apo individë që ishin në fillesat e tyre, por tashmë kishin filluar të ndërtonin imazhin e tyre në rrjetet sociale, megjithëse ende në margjinat e rrjeteve sociale dhe aq më tepër në margjinat e shoqërisë. Por, të nxitur nga antivakserë të huaj, literatura tashmë ekzistuese pseudoshkencore, dhe të ndikuar nga teori të ndryshme konspirative rreth pasurimit të supozuar të pamerituar të kompanive farmaceutike nga vaksinat, u ndodhën në vendin e duhur në kohën e duhur. Që para pandemisë, drejtorëve dhe mësuesve të shkollave anembanë vendit u dorëzuan letra me përmbajtje pseudo juridike që përmbanin kërcënime për padi nëse fëmijët dërgohen në mënyrë të organizuar për vaksinim, duke përmbajtur lista të gjata të pasojave juridike për të trembur stafin arsimor që të mos ndërmarrë asgjë në atë drejtim.

Pandemia, nga ana tjetër, ende më shumë e përforcoi “lëvizjen”, e nxitur nga grupe të mbyllura anti vaksinave në rrjetet sociale, ku njerëz të mendimit të njëjtë i përforcuan ndërmjet tyre pikëpamjet e tyre kundër vaksinës, në mënyrë që qëndrimet e “krijuara” më pas të dalin në shesh, përkatësisht para të gjithë atyre përdoruesve që donin të dëgjonin qëndrime të tilla. Por tani ajo ishte në një atmosferë frike nga e panjohura dhe pasi në internet u përhapën çfarëdo teori konspirative, duke frikësuar publikun se vaksinat u shpikën për të bërë miliarda dhe për të zhdukur pjesën më të madhe të njerëzimit. E gjithë kjo kontribuoi në valën e dezinformatave kundër vaksinave, por edhe në acarimin e betejës kundër tyre.

## Dezinformatat antivaksinale i ringjallin sëmundjet e harruara

Shkruan: Miroslava Simonovska, 13.12.2023

Dezinformatat kundër vaksinave kanë dëmtuar imunizimin dhe kanë shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin publik. Të dhënat për vaksinimin e fëmijëve janë shqetësuese, mbulimi i rekomanduar mbi 95 për qind nuk është arritur për asnjë vaksinë në vend. Rrëfimet dezinformuese vazhdojnë të luajnë me shëndetin e qytetarëve, është shpikur që vaksinat shkaktojnë “turbokarcinoma” edhe te personat që nuk janë fare të vaksinuar. Vërtetmatësi vëren një tendencë për të demonizuar të vaksinuarit, të gjitha me qëllim të frikësimit të të pa vaksinuarve dhe dekurajimin të tyre nga synimi për të mbrojtur shëndetin e tyre përmes imunizimit.



Foto: Myriams-Fotos Pixabay



**P**erioda e vjeshtës çdo vit është një simbol i rritjes së numrit të infeksioneve të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes. Ftohja, gripi dhe Covid po mbushin ambulancat e mjekëve të familjes. Ministria e Shëndetësisë filloi t'u bëjë **thirrje** grupeve të rrezikuara të qytetarëve që të vaksinohen kundër gripit sezonal dhe ka siguruar një numër të mjaftueshëm dozash - **60 mijë**, të cilat janë të destinuara për grupet e rrezikuara të qytetarëve: personat mbi 65 vjeç, qytetarët me sëmundjet kronike, punonjësit e shëndetësisë, gratë shtatzëna, si dhe për fëmijët nga 6 muaj deri në 5 vjeç.

**Gjatë vitit 2022, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është regjistruar asnjë vdekje e vetme nga vaksinimi, as ndonjë gjendje më serioze e rrezikshme për jetën lidhur me aplikimin e vaksinës, njoftojnë** nga Instituti i Shëndetit Publik.

Të gjitha raportet e efekteve anësore të lidhura me vaksinat nga kalendari i rregullt i vaksinave ishin të lidhura me efektet anësore që kishin parashikuar prodhuesit e vaksinave, është një numër jashtëzakonisht i vogël i rasteve dhe të gjitha përfunduan me një rezultat të mirë.

Në vitin 2022, sipas informacioneve që Vërtetmatësi ka marrë nga Instituti i Shëndetit Publik, ka pasur 17 raportime për një ndërlikim pas vaksinimit për vaksinat BSH, HEP, rotavirus dhe vaksinat MRP. Në shtatë raste, për të cilat është marrë informacion për rezultatin, rezultati i trajtimit është shërues dhe pa pasoja të reaksioneve të padëshiruara.

### ***Tabela 1.***

*Numri i rasteve të raportuara të komplikimeve post vakcinale sipas tipit të vaksinës (n=12) për vitin 2022 (Në formularin numër 3)*

<b>Vaksinimi</b>	<b>Numri i rasteve</b>	<b>Rivaksinim</b>	<b>Numri i rasteve</b>
BGC	1	DTaP-IPV (Tetraxim)	3
Hep/HiB/DTP/IPV (Hexaxim)	1	/	
Rota virus (Rotateq)	3	/	
MMR Vaxpro	4	/	

*Numri i rasteve të raportuara për efekte të padëshiruara nga vaksinat (n=5) nëpërmjet Qendrës së formakovigjilencës në MALLMED*

<b>Vaksinimi</b>	<b>Numri i rasteve</b>	<b>Rivaksinim</b>	<b>Numri i rasteve</b>
Hep/HiB/DTP/IPV (Hexaxim)	2	/	
Rota virus (Rotateq)	1	/	
MMR Vaxpro	2	/	

Nga Shtëpia e Shëndetit Shkup thanë për Vërtetmatësin se kanë në dispozicion vakcina kundër Covid-it në pikën e vaksinimit në poliklinikën Bit Pazar, përkundër interesimit të ulët që qytetarët tregojnë për vaksinimin kundër Covid-it gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë që interesi për vaksinimin kundër Covid në vend është në rënie, keqinformimet për këto vakcina vazhdojnë të shpërndahen në internet me intensitet të pashuar.

## Gënjeshtër për sëmundjet e vaksinës Covid

Fakti që në vend një pjesë e mirë e qytetarëve nuk iu nënshtruan këtij dezinformimi dhe u vaksinuan me një, dy ose tre doza, u dha një ide të re qarqeve antivaksinuese: filluan të shpiknin sëmundje nga të cilat gjoja filluan të vuanin të vaksinuarit. Ky ka qenë fokusi i dezinformimit kundër vaksinave në vend gjatë gjashtë muajve të fundit. Parakushtet për këtë dezinformim u krijuan nga fakti se tashmë kishte qytetarë që kishin marrë vaksinën kundër Covid.

Për të demotivuar qytetarët e tjerë që të ndjekin shembullin dhe të mbrohen, u përhap frika dhe paniku i bazuar në palogjikshmëri dhe pretendime të pabazuara. Të tilla ishin pohimet se një numër i madh qytetarësh në botë morën të ashtuquajturën “turbokarcinoma” nga vakcina kundër Covid. Ky term nuk ekziston në mjekësi, por në narrativat e dezinformatave është përdorur për të përshkruar simptomat e kancerit që përparon me shpejtësi.

Në [një nga shembujt](#) e dezinformatave të postuara për këtë temë, pretendohet se edhe kanceri i zhvilluar te një familjar i pa vaksinuar kundër Covid-19 ishte pasojë e vaksinimit të pjesës tjetër të familjes. Me deklarata të tilla të kota është tentuar të futet frika dhe paniku tek një pjesë e madhe e qytetarëve të vaksinuar në vend. Të luash me ndjenjat e familjeve me të sëmurë me kancer, bazuar në manipulime jo mjekësore, është një praktikë joetike dhe e rrezikshme për shëndetin publik.

Dihet në mbarë botën se pandemia e Covid-19 la shumicën e departamenteve dhe klinikave onkologjike pa takime diagnostikuese, gjë që kontribuoi në rritjen e numrit të kancereve në vitet në vijim, pas përfundimit të pandemisë. Gjithashtu, të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë [tregojnë](#) se në dekadat e ardhshme pritet të rritet numri i të sëmurëve nga kanceri

Studimet e [mëdha kanë treguar](#) se pacientët me kancer [janë në rrezik të lartë](#) për komplikacione nga Covid-19, prandaj u rekomandua vaksinimi kundër Covid-19.

Vërtetmatësi vuri në dukje se në gjashtë muajt e fundit objektiv i dezinformatave janë pikërisht qytetarët e vaksinuar në vend. Ato përdoren si objektiv, për të dekurajuar të pa vaksinuarit nga imunizimi. Si? Duke shpërndarë të pavërteta se vakcina kundër Covid e marrë nga të vaksinuarit ka dëmton shëndetin e tyre.

Dezinformata bazë ishte se vakcina kundër Covid shkaktoi SIDA tek ata që e morën atë. Për të shtyrë këto falsifikime, u keqpërdorën institucionet zyrtare shtetërore përmes interpretimit dashakeq të analizave dhe statistikave të tyre. Për [shembull](#), u shpërnda informacioni se “qeveria kanadeze njoftoi se 74 për qind e kanadezëve të vaksinuar me tre doza të Covid 19 tani kanë SIDA të shkaktuar nga vakcina”. Për të nxitur këtë fabrikim dashakeq, qarqet kundër vaksinave në vend shpikën kushte mjekësore jokzistente për «këtë SIDA», të cilën e quajtën «AIDS». Duke keqinterpretuar plotësisht se si funksionojnë vaksinat dhe sistemi imunitar, u përhap paniku që të vaksinuarit sëmurën nga SIDA dhe kanceri, dhe siç shihet nga shembulli i mëposhtëm, shkoi një hap më tej dhe u shpërndanë [palogjikshmëri](#) jashtëzakonisht keqdashëse, se edhe anëtarët e familjes së tyre të pavaksinuar sëmurën nga kanceri për shkak të të vaksinuarve.

Në një [analizë](#) të vitit 2021, kur Vërtetmatësi gjurmoi dezinformatat e vaksinave, ishte evidente se pikërisht ato të rreme që pretendonin se vaksinat shkaktojnë të gjitha llojet e sëmundjeve dhe vdekjeve ishin shpërndarë gjerësisht. Dhe aty, mes serisë së sëmundjeve që i atribuoheshin gabimisht vaksinës, u gjet edhe kanceri. Ministria e Shëndetësisë deklaroi në faqen e saj të fakteve dhe miteve të vaksinave se vaksinat kundër Covid [nuk mund](#) të shkaktojnë kancer.

## Dezinformim se vaksinat shkaktojnë abort

Gjashtë muajt e fundit janë parë dezinformata që synojnë gratë dhe të drejtat e tyre riprodhuese. Pra, Agjencia Evropiane e Barnave EMA u abuzua për [të pretenduar në mënyrë të rreme](#) se kishte lëshuar një paralajmërim se vaksinat kundër Covid shkaktojnë abort. Kjo është diametralisht e kundërt me të vërtetën. [EMA po inkurajon](#) gratë shtatzëna që të vaksinohen kundër Covid-19 dhe nuk ka thënë se vaksinat shkaktojnë infertilitet femëror.

Qendrat Amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve [pretendojnë](#) se shkencëtarët nuk gjetën një rrezik të shtuar të abortit tek gratë që morën vaksinën mRNA në shtatzëninë e hershme ose para se të mbeten shtatzënë. Një analizë e gushtit 2021 nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve shqyrtoi 2,500 gra shtatzëna që morën një vaksinë mRNA përpara javës së njëzetë të shtatzënisë. Studiuesit gjetën një shkallë të abortit prej 13 përqind, e cila është e ngjashme me [shkallën e pritshme](#) të abortit në popullatën e përgjithshme.

Është interesante të theksohet se edhe para fillimit të vaksinimit kundër Covid-19 në Maqedoninë e Veriut, qarqet kundër vaksinimit përhapin dezinformata se vaksinat shkaktojnë infertilitet. Madje, edhe në momentet kur nuk ka pasur studime klinike për këtë temë, ky dezinformim u është servitur përdoruesve në rrjetet sociale. Tani, ndryshe nga atëherë, ka studime klinike që tregojnë se vaksinat nuk shkaktojnë infertilitet apo probleme me fetusin.

Në Shtetet e Bashkuara, deri në maj 2021, 90,000 gra ishin vaksinuar me vaksinat Pfizer dhe Moderna dhe nuk ishte identifikuar asnjë problem shëndetësor, në kundërshtim me atë që dihet tashmë, që gratë shtatzëna të infektuara me Covid-19 kanë një rrezik më të madh për të përfunduar në kujdesin intensiv, si dhe për të lindur më herët foshnjat e tyre, sesa gratë që nuk kanë Covid-19.

Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara [thonë](#) se ato që duan të mbeten shtatzënë në të ardhmen mund të vaksinohen, sepse vaksinat nuk shkaktojnë infertilitet. Ato nuk përmbajnë një virus të gjallë dhe nuk mund të infektojnë as nënën dhe as foshnjën me Covid.

Dhe Qeveria e Australisë [pretendon zyrtarisht](#) se vaksinat kundër Covid-19 nuk shkaktojnë sterilitet.

## Dezinformime për fëmijët dhe kalendarin e rregullt të vaksinimit

Dy lëvizje “luftojnë” vazhdimisht kundër njëra-tjetrës në lidhje me vaksinimin e fëmijëve, pra kalendarin e rregullt të imunizimit. Nga njëra anë janë profesionistët e mjekësisë dhe shkencat dhe kundër tyre qarqet kundër vaksinave që keqpërdorin studime të keqinterpretuara ose të tërhequra dhe të pashqyrtuara nga komuniteti mjekësor për të pretenduar se fëmijët e pavaksinuar janë më të shëndetshëm se fëmijët e vaksinuar. Kjo mund të ndikojë negativisht në tendencat e imunizimit në vend, duke qenë se është prindi ai që vendos ta çojë fëmijën për vaksinim. Pra, nëse prindi bie nën ndikimin e të pavërtetave dhe gjysmëinformacioneve, atëherë rrezikohet imuniteti kolektiv në vend dhe ai për sëmundjet që konsideroheshin të zhdukura dhe nën kontroll, falë vaksinave. Në gjashtë muajt e fundit është vënë re [rrëfimi](#) se fëmijët e vaksinuar sëmuren dhe kanë komplikime, ndryshe nga të pavaksinuarit. Një dezinformim i tillë vjen në vend në një periudhë të ndjeshme kur nuk është arritur mbulimi i [rekomanduar mbi 95 për qind](#) për asnjë vaksinë, gjë që krijon rrezikun e shfaqjes së sëmundjeve tashmë të harruara. Faktet thonë se në vendet me mbulim të lartë vaksinimi, shumë sëmundje mbahen nën kontroll.

Dezinformimi për vaksinat tek fëmijët dhe dëmet e supozuara të tyre bazohet në një studim fatkeq, të mbështetur nga organizata kundër vaksinave, i cili ka dobësi metodologjike, një kampion jo përfaqësues, një studim i bazuar në perceptime subjektive, jo në metoda matematikore dhe statistikisht të sakta. Gjatë shpërndarjes së dezinformatave për vaksinat e fëmijëve u shpërnda edhe [gënjeshtra](#) se fëmijët e vaksinuar kanë 4.2 herë më shumë mundësi

për të zhvilluar autizëm. Ndryshe nga pretendimet e tilla, studimet me një kampion [përfaqësues prej 650,000 fëmijëve](#) nuk tregojnë një lidhje midis vaksinës dhe autizmit.

Profesor **Dr. Alexandra Grozdanova**, koordinatorë kombëtare për imunizimin, deklaroi së fundmi se kur në vend ndodhi një epidemi fruthi në vitin 2019, për shkak të mbulimit të pamjaftueshëm të fëmijëve të vaksinuar, dhe rrjedhimisht për shkak të rënies së imunitetit kolektiv, shteti duhej të merrte një sërë të aktiviteteve dhe hapave . Ndër këto hapa ishte vaksinimi i 42,000 fëmijëve [nën moshën 14 vjeç me vaksinën MMR](#). Asnjëri prej tyre nuk u shfaq me autizëm.

**Në momentin kur mbulimi zvogëlohet, rreziku i shpërthimit të fruthit është jashtëzakonisht i lartë, *tha* profesor Dr. Grozdanova.**

Falë vaksinimit, gjatë kësaj periudhe nuk u shfaq asnjë epidemi e re e fruthit.

**Është jashtëzakonisht e rëndësishme t'u sqarohet prindërve se kjo vaksinë është bërë dekada më parë, [nënvizoi ajo](#), duke theksuar se vaksina është vendimi i duhur për të mbrojtur fëmijët nga sëmundja.**

Akademia Amerikane e Pediatriës ka përfunduar një listë të studimeve të rëndësishme për sigurinë e vaksinave që mund të shihen [këtu](#).

## Gënjeshtër që demonizojnë profesionistët mjekësorë që promovojnë vaksinimin

Nuk mund të shmanget fakti se që nga fillimi i pandemisë Covid ka një kamp në rrjetet sociale që bie kundër mjekësisë së bazuar në prova, mjekëve, infermierëve, anëtarëve të agjencive zyrtare mjekësore etj. Gjatë gjashtë muajve të fundit, për të larguar qytetarët nga vaksinat, u tha gjithashtu se ata profesionistë mjekësorë që promovuan vaksinat [do të gjykoreshin për krime kundër njerëzimit](#). Është një trillim i pastër. Askush nuk do të gjykohet për krime kundër njerëzimit, as për vaksinën Covid-19 apo ndonjë vaksinë tjetër. Vaksina merret me pëlqim të nënshkruar nga pacienti përpara vaksinimit, ku tregohen efektet anësore të mundshme, të cilat kryesisht janë të lehta dhe kalojnë shpejt.

Demonizimi i shkencës mjekësore i mishëruar te profesionistët mjekësorë është një taktikë për të mashtruar masat se ata po punojnë në dëm të njerëzimit. Kjo krijon rrezikun e besimit konfuz dhe të tronditur te autoritetet shëndetësore, te mjekët dhe rezulton në refuzimin e rekomandimeve të tyre, gjë që mund të kushtojë jetë.

Është e rëndësishme të theksohet se Maqedonia e Veriut ndjek rekomandimet e OBSH-së, FDA-së dhe EMA-s, dhe vaksinat që janë miratuar nga organizatat përkatëse mjekësore në botë janë pranuar.

Vendimi i çdo personi nëse do të vaksinohet kundër Covid është një vendim individual. Megjithatë, për vaksinat e fëmijëve ekziston një kalendar i detyrueshëm i imunizimit që rregullohet me Ligjin për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet infektive. Synimi i prindërve të fëmijëve me dezinformata rreth vaksinave dhe në këtë mënyrë reduktimi i mbulimit me vaksinim është një rrezik serioz për shëndetin publik të të gjithë popullatës.

Të dhënat e OBSH-së thonë se 2 deri në 3 milionë jetë fëmijësh shpëtohen çdo vit në mbarë botën nga vaksinimi. Falë imunizimit, shumë sëmundje infektive që në të kaluarën përbënin një problem të konsiderueshëm shëndetësor sepse shkaktonin vdekshmëri të lartë tek fëmijët dhe të rriturit ose shkaktonin komplikime dhe paaftësi, sot janë eliminuar ose vënë nën kontroll, duke u reduktuar në raste individuale.

Nuk ka dyshim se vaksinimi është një nga arritjet më të mëdha në historinë e mjekësisë dhe masa parandaluese më e sigurt, më efikase dhe e justifikuar ekonomikisht, e cila kontribuon drejtpërdrejt në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga sëmundjet infektive.

Prandaj, kur marrin vendime për vaksinimin e fëmijëve, prindërit duhet të ekspozohen ndaj [mjekësisë së bazuar në fakte](#), në vend që të jenë në shënjestër të gjysmëinformacioneve dhe dezinformatave që janë armiku i shëndetit publik. Natyrisht, në atë luftë për informim të saktë, barriera dhe mburoja kryesore kundër dezinformatave janë mediat, të cilat më së shumti janë të prirura drejt mjekësisë së bazuar në fakte.

## EMA nuk ka lëshuar paralajmërim se vaksinat kundër Kovid-it shkaktojnë abort spontan

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 09.06.2023

EMA tha se ka zbuluar prova që tregojnë se gjakderdhje e rëndë menstruale mund të ndodhë pas vaksinimit kundër Kovid, duke arritur në përfundimin se ekziston një “mundësi e arsyeshme” që vaksinat mund ta shkaktojnë atë, por kurrë nuk ka rekomanduar që vaksinat mRNA të ishin të lidhura me komplikimet e shtatzënisë, përkatësisht me fertilitetin ose abortin

**D**ezinformatat se vaksinat kundër koronavirusit ndikojnë negativisht mbi fertilitetin dhe shkaktojnë abort, që u përhapën gjatë pandemisë kovid, ende qarkullojnë në rrjetet sociale. I tillë është edhe [postimi](#) në [Facebook](#) në të cilin ku u vërtetua se Bashkimi Evropian ka lëshuar paralajmërim se vaksinat kundër kovid 19 janë të dëmshme për gratë shtatzëna dhe frytet e tyre. Kjo nuk është e saktë.

Të gjithë gratë që janë vaksinuar me vaksinën MRNA, dhe keni problem me fertilitetin, aborte spontane... të shkoni te I çmenduri, Filipçe, Petliçkovski, Mehmedoviq, Karaxhovski, gazetarët... dhe të gjithë ato që ju kanë bindur të vaksinoheni, t'u parashtroni ndonjë pyetje!!!, qëndron në [postimin të cilin e analizojmë](#).

Postimi ndan edhe [shkrimi](#) cili thirret në tekstin e publikuar nga portali “[Ekspoze](#)” e cila gjatë gjithë pandemisë me kovid 19 përhapte narrativë [dezinformues](#).

Në shkrimin mes tjerash theksohet:

Siç publikoi [expose-news.com](#), më 28 tetor 2022, EMA publikoi udhëzim të ri në të cilin thuhet se “gjakderdhja e madhe menstruale duhet të shtohet në informacionet e efektit anësor të produktit me shpeshti të panjohur për vaksinat mRNA kundër COVID-19 Comirnaty (Pfizer) dhe Spikevax (Moderna). EMA thotë se gjakderdhja e madhe menstruale mund të përkufizohet si “gjakderdhje e cila karakterizohet me vëllim të rritur dhe/ose kohëzgjatje të rritur që përzihet me cilësinë fizike, sociale, emocionale dhe materiale të jetës së një personaliteti, qëndron në këtë [shkrim](#).”



Foto: Cindy Parks Pixabay

Ndryshe nga ky postim ku pretendohet se EMA “ka pranuar” se vaksina ndikon negativisht në fertilitetin e femrave, Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) inkurajon gratë shtatzëna të vaksinohen kundër Kovid-19 dhe nuk ka thënë se vaksinat shkaktojnë infertilitet femëror.

Pretendimi i bërë në postimin dhe në shkrimin që e ndan, bazohet në [udhëzimet](#) nga komiteti i sigurisë së EMA-s (PRAC), të lëshuara në tetor 2022, [rekomandojnë](#) përditësimin e efekteve anësore të mundshme të shënuara në informacionet për produktin për vaksinat kundër Kovid të Moderna dhe Pfizer-BioNTech bazuar në raportet për periode të rënda menstruale gjatë ekzaminimeve klinike, në botën reale dhe në literaturën mjekësore.

EMA atëkohë raportoi se ka [zbuluar](#) prova që tregojnë se gjakderdhja e rëndë menstruale mund të ndodhë pas një vaksinimi kundër Kovid, duke arritur në përfundimin se ekziston një “mundësi e arsyeshme” që vaksinat mund ta shkaktojnë atë.

Megjithatë, zëdhënësi i EMA-s tha se pretendimi se EMA këshillon gratë shtatzëna të mos marrin vaksina kundër Kovid-19 sepse ato do të shkaktojnë infertilitet janë të rreme dhe një keqinterpretim i vendimit të komitetit, raporton [Rojters](#).

Nga takimi në tetor 2022 ku u soll vendim i komitetit të vlerësimit të rreziqeve të EMA-s, PRAC, u arrit përfundimi se “nuk ka asnjë provë që sugjeron se çrregullimet menstruale që i përjetojnë disa njerëz kanë ndonjë ndikim mbi riprodhimin dhe fertilitetin”.

EMA në fakt i inkurajon gratë shtatzëna që të [vaksinohen](#).

**Viktoria Mejll**, specialist për imunologji dhe shtatzëni dhe ligjëruese e lartë në Imperiall Kollexh London, [tha](#) se periudhat e rënda pas vaksinimit nuk janë të lidhura me fertilitetin e zvogëluar dhe provat tregojnë se këto ndryshime menstruale ishin të përkohshme.

Një [studim](#) në të cilin thirret Mejll, i publikuar në internet në prill 2023, krahason rrjedhën menstruale te individët e vaksinuar dhe të pavaksinuar, duke treguar se afërsisht 4 për qind e njerëzve përjetojnë një periudhë më të rëndë se e zakonshme menjëherë pas vaksinimit, me menstruacion që kthehet në normalitet në muajin në vijim.

Kolegjiumi profesional i Klinikës Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë Shkup (GJOK), Komiteti për Amësi të Sigurt të RMV-së dhe Shoqata e Perinatologëve të RMV-së lëshoi rekomandime lidhur me vaksinimin kundër Kovid-19 gjatë shtatzënisë. Këto rekomandime [që i ka publikuar Vërtetmatësi](#) bazohen në studime nga institutet mjekësore përkatëse botërore që bazohen në hulumtime që përfshijnë një numër serioz të të anketuarve nga kjo kategori e popullatës femërore.

Sipas këtyre rekomandimeve, vaksinimi kundër Kovid-19 rekomandohet në shtatzëni, njëjtë si edhe te pjesa tjetër e popullsisë. Vaksinimi është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga efektet e dëmshme të Kovid-19 në shtatzëni, si për nënën ashtu edhe për fëmijën e saj, përfshirë lindjen e parakohshme dhe qëndrimin e të porsalindurit në repartin e kujdesit intensiv.

Edhe Komisioni për Mbrojtjen e Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse [rekomandoi](#) që gratë shtatzëna të vaksinohen dhe të kthehen në punë. Gjithashtu, Instituti i Shëndetit Publik në faqen e tij ka [rekomanduar zyrtarisht](#) që gratë shtatzëna të vaksinohen.

[Vërtetmatësi](#) edhe më parë ka demaskuar lajmet që kanë pretenduar se vaksina kundër Kovid është e dëmshme për gratë shtatzëna.

Nga e lartpërmendura mund të konkludojmë se EMA nuk ka lëshuar paralajmërim se vaksinat kundër Kovid janë të dëmshme për gratë shtatzëna dhe se ato shkaktojnë abort spontan. EMA në fakt i inkurajon gratë shtatzëna që të vaksinohen.

Sipas kësaj, postimin e vlerësojmë si *të pavërtetë*.

## Qeveria kanadeze nuk ka pranuar se 74 për qind e të vaksinuarve me dozën e tretë kanë „VAIDS“

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 09.11.2023

Disa njerëz në mënyrë të pabazë pretendojnë se VAIDS është dobësimi i funksionit të imunitetit për shkak të vaksinave kundër Kovid-19, ngjashëm sikur njerëzit me HIV ose SIDA të patrajtuar kanë sistem të komprometuar të imunitetit. Të dhënat zyrtare kanadeze aspak nuk e lidhin sëmundjen me vaksinimin, as që e matin nivelin e imunitetit që e sigurojnë vaksinat. Argumenti i cili citohet në postimin në Facebook, gjoja të bazuar në të dhënat e qeverisë kanadeze, del nga portali anti-vaksinave “The Exposé”, i cili mbështetet në interpretimin e të dhënave që është jashtëzakonisht i pasaktë. Disa verifikues botërorë të fakteve tashmë kanë shkruar se VAIDS, përkatësisht sindroma e imundeficienës të fituar me vaksinën kundër Kovid nuk është sindromi i vërtetë.

Përmes dezinformatave në rrjetet sociale po përhapet paniku se si pasojë e vaksinave kundër Kovid, imuniteti është në rënie drastike dhe se një numër i madh i atyre që janë vaksinuar manifestojnë gjendje si SIDA. Në këtë kuptim, një [postim](#) në [Facebook](#) pretendon se të dhënat nga qeveria kanadeze tregojnë se te 74 për qind e njerëzve të vaksinuar me dozë të tretë kundër Kovid-19 është paraqitur SIDA. Kjo nuk është e vërtetë. Në asnjë moment këto dokumente nuk e lidhin sëmundjen me vaksinimin dhe as nuk matin nivelin e imunitetit që sigurohet nga vaksinat.

**I** Të dhënat zyrtare të publikuara nga qeveria kanadeze tregojnë se 74% e kanadezëve të vaksinuar me dozë të tretë tani kanë sindromin e deficitit të imunitetit me vaksinën (VAIDS). Po, kjo është SIDA e shkaktuar nga vakcina, *shkruan në postimin*.

Nuk është e saktë që raportet nga qeveria kanadeze tregojnë se 74 për qind e njerëzve që kanë marrë tre doza të vaksinës Kovid-19 kanë humbur imunitetin dhe kanë zhvilluar VAIDS, domethënë tani kanë sëmundjen e SIDA-s, siç është postuar në rrjetin social. Në dokumentet e cekura në dezinformatat nuk përmendet SIDA si pasojë e imunizimit kundër Kovid-19.



Foto: MasterTux Pixabay



**VAIDS** nuk është gjendje e vërtetë mjekësore, por dezinformatat për VAIDS përhapen në rrjetet sociale. Disa njerëz **pretendojnë në mënyrë të pabazë** se VAIDS është një dobësim i funksionit të imunitetit për shkak të vaksinave kundër Kovid-19, ashtu si njerëzit me HIV ose SIDA të patrajtuar kanë sistem seriozisht të komprometuar të imunitetit.

Disa verifikues botërorë të fakteve tashmë kanë shkruar se VAIDS, përkatësisht sindromi i imunodeficiencës i fituar me vaksinën kundër Kovid, nuk është një **sindrom i vërtetë**.

Sindromi i imunodeficiencës ose “SIDA” është gjendje kronike e cila e pengon aftësinë e trupit që të luftojë kundër infektiveve dhe sëmundjeve. Ajo është shkaktuar nga virusi i imunodeficiencës humane (HIV). Por, pretendimet se ka raste të SIDA-s të shkaktuara nga vaksinimi ose “VAIDS” siç pretendojnë përdoruesit online **janë të pabaza**.

**Nuk ekziston fenomeni i quajtur “sindromi i imunodeficiencës i nxitur nga vaksina”. Ky nuk është sindromi i vërtetë, deklaroi për Rojters, Dona Farber,** shefe e Seksionit për Shkenca Kirurgjike dhe profesoreshë e mikrobiologjisë dhe imunologjisë në Universitetin Kolumbia.

Ajo sqaron pse vaksinat nuk shkaktojnë imunodeficiencë.

**Ato nuk i harxhojnë qelizat imune, përkundrazi, ato i stimulojnë qelizat imune të aktivizohen, ndahen dhe prodhojnë molekula si antitrupa dhe faktorë të tretshëm që të njohin patogjenë dhe ta lirojnë trupin nga ai, shton Farber.**

Duke pasur parasysh atë që miliarda njerëz në mbarë botën tashmë janë vaksinuar kundër Kovid-19, **Dr. Grant Mekfaden,** drejtor i Qendrës Biodizajn për Imunoterapi, Vaksina dhe Virusoterapi të Universitetit Shtetëror në Arizonë konsideron se po të ekzistonte diçka si VAIDS, deri tani do të zbulohet.

**Nuk ekziston pandan i SIDA-s i shkaktuar nga vaksinat, thotë Mefaden për Associated Press.**

Edhe **kërkimi** nëpër literaturën biomjekësore legjitime nuk gjeti përmendje të sindromit të imunodeficiencës së fituar me vaksinën.

**Nuk ekziston gjendje e quajtur VAIDS, thotë Dr. Metju Lorens, specialist për sëmundje ngjitëse pediatrike dhe hulumtues në Universitetin në Merilend, në postën elektronike në USA Today.**

Argumenti i cili citohet në postimin në Facebook, gjoja i bazuar në të dhënat e qeverisë kanadeze, del nga **portali anti-vaksinave “The Exposé”,** i cili mbështetet në interpretimin e të dhënave që është tejet i pasaktë.

Në shkrimin e tij, **portali i keqpërdor të dhënat** mbi të cilat e mbështet pretendimin e tij qendror. Ai e bën këtë duke kombinuar të dhënat mbi “efektivitetin e vaksinave”, i cili në thelb bie me kalimin e kohës, me diçka që publikimin e quan “performancat e sistemit të imunitetit”, që sugjeron se e prezanton sistemin e përgjithshëm të imunitetit të trupit, megjithëse kjo nuk është prezantuar në të dhënat kanadeze në asnjë moment.

Mbrojtjen që e ofron vaksina bie me kalimin e kohës, por kjo të lidhet me zvogëlimin e sistemit të përgjithshëm imunitar të një personi, është keqpërdorim i të dhënave. Siç raportoi Agjencia e Shëndetit Publik e Kanadasë (RNAS) në postën elektronike në portalin Lead Stories për verifikimin e fakteve, shkrimi në “The Exposé”, *“keqinterpreton qartë se si funksionojnë vaksinat dhe sistemi i imunitetit”:*

Është me rëndësi të sqarohet se një person nuk sëmuret nga SIDA për shkak të dobësimit të sistemit të tij të imunitetit, por për shkak të infektimit me **virusin HIV,** i cili paraqitet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun, përmes spermës ose lëngjeve vagjinale të personit të infektuar. Infektimi HIV shkakton që individi ta humbë gradualisht imunitetin qelizor, të cilin e bën të ndjeshëm ndaj sëmundjeve të tjera.

Sipas të gjitha fakteve të cekura arrijmë në përfundim se *nuk është i saktë* pretendimi se Qeveria e Kanadasë ka pranuar se 74 për qind nga të vaksinuarit me dozë të tretë tani kanë “VAIDS” përkatësisht SIDA.

## Nanoteknologjia, rrjeti 5G dhe oksid grafeni nuk kanë kurrfarë lidhje me vaksinat

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 22.08.2023

Postimi nxjerr në pah një sërë teorish konspirative dhe fakte të pavërtetuara lidhur me vaksinat dhe përbërjen e tyre. Vaksinat nuk përmbajnë oksid grafeni, as nanoteknologji e cila modifikon gjenetikisht njeriun që ai të drejtohet me ndihmën e teknologjisë 5G

**N**ë rrjetet sociale nuk pushojnë së përhapuri teoritë e mirënjohura konspirative kundër vaksinave të cilat veçanërisht ishin aktuale në kohën e pandemisë kovid, kur plasoheshin të pavërteta të shumta për vaksinat kundër koronavirusit. Në këtë [postim](#) në [Facebook](#) janë nxjerrë shumë të pavërteta për përbërjen e vaksinave kovid dhe efektin e tyre:

Mendoj se shumica prej jush nuk e kanë idenë se çfarë po ndodh dhe shumica prej jush mendojnë se është qesharake!!!

Nuk është aspak qesharake, jua ndryshuan fushën bio-elektro-magnetike të trupit!!!

Po shndërroheni në një transiver dhe përhapeni rreth “proteinave” lipide sintetike (që përmbajnë nano grafen)

TANI JENI NJË QENIE E MODIFIKUAR GJENETIKISHT!!! Mendoj se nuk mund të konsideroheni më si qenie njerëzore, përkatësisht një kamxhik njerëzor.

Nuk keni më një fushë elektromagnetike natyrore rreth jush, nuk e prodhoni më atë!

Tani ju jeni thjesht një TRANSMETUES për sistemin (rrjetin) që e kanë vendosur rreth...

Rrjeti 5G është një armë dhe teknologji ushtarake të cilën ata e kanë vendosur për t’u lidhur me ju...

Tani jeni ata ju që e përhapni infeksionin!

Andaj ju të pavaksinuar qëndroni larg!!!

Nëse nuk besoni, por keni një matës të fushës elektromagnetike, mos ngurroni ta afroni më pranë vendit ku e keni marrë “VAKSINËN” 📌!!!

Ju nuk e keni më fushën tuaj elektromagnetike natyrore përreth jush, tani gjithçka është sintetike (artificiale)..., thuhet ndër të tjera në postimin që e recensojmë.



Foto: [Gerd Altmann Pixabay](#)

Teoria e konspiracionit se pandemia me Kovid-19 është planifikuar që të vaksinohen njerëzit me vaksina të modifikuara gjenetiksht, të cilat kanë për qëllim t'i çipojnë dhe më pas t'i kontrollojnë përmes rrjetit 5G, nuk është [asgjë e re](#) dhe [Vërtetmatësi ka shkruar](#) shumë tekste mbi këtë temë.

Pretendimet se vaksinat kundër Kovid, të cilat janë bërë me teknologjinë mRNA, përmbajnë OMGJ dhe nanoteknologji janë të rreme. Në vaksinat kundër Kovid-19, [nuk ka](#) nanoteknologji trans'humaniste mRNA.

Teknologjia mRNA daton në vitet 1990, por gjatë pandemisë për herë të parë u përdor në vaksinat e përdorura gjerësisht. Në vaksinat Pfizer dhe Moderna, mRNA-ja gjendet në një "kapsula lipode", ose më saktë, në një mbështjellës yndyror, që përshkruhet si një nanogrimcë. Parashtesa "nano" do të thotë vetëm se është i vogël, e jo se është nanoteknologji.

mRNA, acidi ribonukleik, është një molekulë e ngjashme me ADN-në që mbart informacionin gjenetik të koduar në qelizë. Vaksinat Pfizer dhe Moderna përdorin mRNA për të bartur informacion gjenetik rreth koronavirusit në qelizën e trupit, për të mësuar sistemin imunitar të identifikojë dhe luftojë infeksionin Kovid-19.

**Megjithëse termi nano përdoret që të imponohet se nanoteknologjia përdoret për ta modifikuar mRNA-në tuaj, kjo është plotësisht e rreme. mRNA me vaksinat e "Fajzer" dhe "Moderna" nuk ka kurrfarë efekti mbi ADN-në ose mRNA-në e njeriut dhe nuk bëhet pjesë përbërëse dhe e përhershme e qelizës, [thotë Sindi Prins](#), profesoreshë e epidemiologjisë në Universitetin në Floridë.**

Edhe Qendra për Kontroll dhe Parandalim të Sëmundjeve e ShBA-së, [vërteton zyrtarisht](#) se vaksina kundër kovid-19 nuk hyn në bashkëveprim me ADN-në tonë në çfarëdo mënyre.

**mRNA-ja asnjëherë nuk hyn në bërthamën e qelizës ku ruhet materiali gjenetik. Qeliza e tret dhe lirohet nga mRNA-ja menjëherë pas përfundimit të përdorimit të instruksioneve.**

EDHE UNICEF-i pretendon se vaksinat kundër kovid-19 nuk mund ta ndryshojnë ADN-në e njeriut.

**Vaksinat e quajtura mRNA nuk e ndryshojnë, as nuk bashkëveprojnë me ADN-në tuaj. Vaksinat mRNA u japin instruksione qelizave tuaja si të krijojnë proteinë e cila aktivizon reagim imunitar dhe pastaj menjëherë tretet. Me këtë ndërtohet imunitet kundër virusit i cili shkakton kovid-19. Në atë mënyrë, mRNA (përkatesisht instruksionet) nga vaksina aspak nuk hyjnë në bërthamën e qelizës, ku gjendet ADN-ja jonë, [shkruan në faqen e internetit të UNICEF-it](#).**

Pretendimet për elemente mikroskopike që përbëhen në trupin e të vaksinuarve, ekspertët e imunologjisë [i quajnë](#) një fantazi dhe absurditet i pastër.

Profesori i Universitetit Kuinllend, **Kit Çapell** [thotë](#) se pretendimi për nanoteknologjinë në vaksinat është qesharake.

**Vaksinat mRNA përmbajnë nanogrimca por ato përbëhen nga lipidet dhe molekulat e kolesterolit. Këto janë të ngjashme me pikat mikroskopike të yndyrave që e çojnë vaksinën në qelizat. Këto definitivisht nuk janë komponentë elektronike dhe kjo nuk ka kuptim në asnjë nivel, [deklaroi ai](#).**

Rrjeti 5G që përmendet në postimin nuk ka asnjë lidhje me vaksinat. Teoria e konspiracionit që rrjeti 5G dhe disa mikroçipa joekzistuese në vaksina janë një përpjekje e kombinuar për të kontrolluar popullatën – ku lëviz, çfarë bën, çfarë blen, madje edhe idetë se me çipat joekzistuese do të kontrollojnë procesin e të menduarit të individit të vaksinuar, është thjesht një teori konspirative qesharake, e pambështetur me asnjë fakt, e pabazuar në realitet. Teknologjia 5G në komunikim dhe vaksinimi në kujdesin shëndetësor nuk janë të lidhura.

Që nuk ka asnjë lidhje dhe asnjë ndikim të rrjetit 5G mbi koronavirus u konfirmua tashmë në fillim të vitit 2020. Pothuajse të gjitha institucionet relevante dolën me raporte se nuk ka dëshmi se ky rrjet ka ndikim në sistemin imunitar dhe se është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve.

Në shkurt 2020, [Organizata Botërore e Shëndetësisë](#) (OBSH) njoftoi se nuk është zbuluar asnjë ndikim i këtij rrjeti mbi shëndetin publik.

**Edhe pas shumë hulumtimeve të bëra, deri tani nuk është vërejtur asnjë ndikim i dëmshëm mbi shëndetin që është shkaktuar nga ekspozimi ndaj teknologjisë pa tel, thuhet në sqarimin e OBSH-së.**

Sa i përket pretendimit se në vaksinat kovid ka oksid grafeni, gjithashtu, është theksuar në postimin të cilin e analizojmë, dhe kjo nuk është e saktë.

„[Vërtetmatësi](#)“ dhe në këtë temë është shkruar më shumë herë.

**Oksid grafeni është material i cili krijohet nga oksidimi i grafenit. Grafeni është shtresë e vetme e grafitit (substancë e butë e cila gjendet në majën e lapsit për të shkruar). Oksidi i grafenit gjen përdorim potencial në elektronikë, optikë, kimi, ruajtje të energjisë dhe biologji, është sqaruar në [shkrimin](#) e publikuar në zhurnalin “Frontiers of Fiziks” në janar 2019.**

“Asoshiejtet pres” [njoftoi](#) se edhe krahas kësaj që ka pasur hulumtime për atë nëse është shfrytëzuar oksid grafeni në disa vaksina (në sasi të cilat për njeriun nuk do të ishin toksike), materiali nuk është në listën e përbërësve të vaksinës së fajzerit ose cilado vaksinë tjetër.

**Nuk është në listën e përbërësve dhe nuk ka kurrfarë gjasa të jetë i pranishëm, deklaroi Alen Majerson, profesor i inxhinierisë kimike në Institutin e Nanoteknologjisë Masaçusets.**

Edhe në [faqen zyrtare të internetit për vaksinim në vend](#), ku janë shënuar përbërësit e të gjitha vaksinave që administrohen në Maqedoninë e Veriut, shihet se në përbërjen e tyre nuk ka oksid grafeni.

Nga e gjithë kjo mund të arrijmë në përfundim se postimi nxjerr në pah një sërë teorish konspirative dhe fakte lidhur me vaksinat dhe përbërjen e tyre. Vaksinat nuk përmbajnë oksid grafeni, as nanoteknologji e cila e modifikon gjenetikaht njeriun që ai të drejtohet me ndihmën e teknologjisë 5G. Sipas kësaj, postimin e vlerësojmë si të pavërtetë.

## 5. Eksploatimi i teorive të konspiracionit

Çfarë është teoria e komplotit? Apo teoria e konspiracionit? Me fjalë të thjeshta, është një pretendim ku thuhet se dy ose më shumë njerëz (madje edhe organizata, institucione, shtete), fshehurazi, larg syve të gjithë botës, kanë krijuar komplot kundër një pale të tretë për të realizuar disa nga qëllimet e tyre, në pjesën më të madhe të lidhura me paranë dhe pushtetin. Dhe e gjithë kjo në dëm të dikujt tjetër, më së shpeshti në dëm të të varfërve apo njerëzve të thjeshtë, ose, në variantin më të keq, në dëm të të gjithë njerëzimit. Kuptohet, disa teori konspirative janë të vërteta. Jo të gjitha janë rezultat i dezinformatave. Disa teori konspirative, nga ana tjetër, kanë edhe qëllime pozitive. Por këto nuk janë ato që qarkullojnë në rrjetet sociale, duke përhapur frikë, pasiguri, ndjenjë pafuqie etj. HAARP-i, një rrjet me frekuencë të lartë për të cilin pretendohet se është përgjegjës për ngrohjen globale, Komisioni Evropian, i cili akuzohet se dëshiron të shkatërrojë bujqësinë dhe të na bëjë të gjithë të hamë insekte, prodhuesit e vaksinave, të cilët shpikin vakcina për të na vvarë ose për t'i vendosur gjërat në atë mënyrë që në planetin të mbesin vetëm një miliard njerëz (“miliardi i artë”), “kemtrejlls” - helme që lëshohen nga aeroplanët për t'i helmuar njerëzit e pafajshëm në tokë, të mos flasim për teoritë konspirative që gjoja pas tyre qëndrojnë individëve të pasur si Bill Gejts, i cili akuzohet për gjithçka - nga bërja e vaksinave për të ndryshuar përbërjen gjenetike të njerëzimit, te dëshira për të eklipsuar diellin, etj. Imagjinata luan një rol të madh kur bëhet fjalë për teoritë konspirative, kështu që duhet po aq imagjinatë për t'i luftuar ato.

## Si e ushqejnë teoritë konspirative epideminë globale të dezinformatave

Shkruan: **Simona Atanasova**, 25.10.2023

Megjithëse disa teori konspirative duken të parrezikshme, shumë prej tyre kanë pasoja në botën reale. Teoritë konspirative si Kju Anon, 5G, HAARP, kemtrejlls dhe të ngjashme nxisin frikë, kanë potencial për ta cenuar besimin e publikut në shkencën, në institucionet dhe mund ta cenojnë politikën publike. Është thelbësore të jemi të kujdesshëm dhe të vlerësojmë në mënyrë kritike informacionet që i hasim, duke kërkuar burime të besueshme dhe duke u mbështetur në konsensusin e ekspertëve. Duke kuptuar bazat e këtyre teorive konspirative dhe faktet që i zbulojnë, mund të nxisim një shoqëri që e vlerëson të menduarin kritik të bazuar në prova



Foto: Photo by [Markus Winkler](#) on [Unsplash](#)

**D**ezinformatat, të nxitura nga teoritë konspirative përbëjnë një kërcënim të dukshëm për shoqërinë, demokracinë dhe shëndetin publik. Epoka digjitale siguroi terren pjellor që narrativët plot me gënjeshtër, dezinformata dhe teori konspirative të përhapen si zjarr pyjor.

Teoritë konspirative janë një terren pjellor nga i cili nxirren dhe formohen shumë dezinformata. Këto teori shpesh rrotullohen rreth besimit se një grup individësh ose organizatash manipulojnë fshehurazi me ngjarjet globale për përfitimin e tyre.

Megjithëse disa teori konspirative duken të parrezikshme, shumë prej tyre kanë pasoja në botën reale. Ato mund të çojnë në mosbesim ndaj institucioneve, kriza në shëndetin publik, madje edhe në dhunë. Këto teori shpesh i mjugullojnë kufijtë ndërmjet fakteve dhe fiksionit.

Në këtë analizë, shtjellojmë shembuj të dezinformatave dhe lidhshmërisë së tyre me teoritë më të shpeshta konspirative, përfshirë Kju Anon, 5G, HAARP-in, Bill Gejts-in “famëkeq” dhe etj.

## Kju Anon: Konspiracioni për shtetin e thellë

Kju Anon është një nga teoritë konspirative më alarmante për të tërhequr vëmendjen në vitet e fundit. Teoria bazohet në atë se një shoqëri e fshehtë e elitave që e adhurojnë Djallin dhe trafikojnë fëmijë e kontrollojnë botën. Ithtarët e Kju Anon besojnë se ish-presidenti **Donald Trump** luftoi kundër këtyre forcave të errëta, të cilat shpesh quhen “shteti i thellë”.

Pjesëtarët e [Kju Anon](#) e përhapin edhe teorinë e [adrenokromit](#) dhe pretendojnë se Presidenti Trump zhvillon një luftë të fshehtë kundër pedofilëve të elitës që e adhurojnë Djallin, e që janë pjesë e qeverisë, biznesit dhe mediave. Kjo teori konspirative pretendon se politikanët e “shtetit të thellë” dhe elita e Holivudit janë të përfshirë në një rrjet të madh rrëmbimi të fëmijëve që e mbledh përbërjen kimike adrenokromin nga fëmijët e abuzuar seksualisht që u nënshtrohen ritualeve satanike. Asnjë studim shkencor, hulumtim klinik apo agjenci zyrtare shëndetësore nuk e lidh [adrenokromin](#) me përtëritje. [Nuk ka prova](#) që kjo substancë përdoret për përtëritje dhe as që ka efekt halucinogjen. Megjithëse nuk është vërtetuar asnjëherë me prova se ekziston ndonjë praktikë të nxjerrjes së adrenokromit nga fëmijët, megjithatë narrativi nuk ndalet së qarkulluari në rrjetet sociale.

## Kemtrejlls

Një nga teoritë më të qëndrueshme dhe më të përhapura të konspiracionit sillet rreth [kemtrejlls](#), gjurmëve kimike që i lënë aeroplanët, për të cilat shpesh pretendohet se janë agentë kimikë ose biologjikë të spërkatura qëllimisht nga aeroplanët. Përkrahësit sugjerojnë se këto shtigje janë pjesë e programeve sekrete të qeverisë për të kontrolluar motin, për të helmuar popullsinë apo edhe për të manipuluar sjelljen njerëzore. Edhe vala e nxehtë gjatë periudhave ishte e lidhur me të ashtuquajturën “spërkatje nga aeroplanët”.

E vërteta është se gjurmët e bardha të cilët i lënë aeroplanët pas tyre [krijohen](#) kur avujt e ujit dhe grimcat e vogla të karburantit të djegur të aeroplanëve ngrihen në kristale akulli. Gjatë lagështisë së ulët të ajrit, kristalet shpërbëhen. Gjatë lagështisë më të lartë ato mbijetojnë dhe përfundimisht krijojnë një gjurmë të dukshme në sipërfaqe të mëdha të qiellit. Jo të gjithë aeroplanët lënë gjurmë të bardha – vlerësohet se kjo ndodh vetëm te rreth 18 për qind e fluturimeve. Ajri duhet të jetë mjaft i ftohtë që uji të ngrijë, prandaj ato zakonisht ndodhin vetëm mbi lartësi të caktuara - zakonisht në lartësi mbi 6 km.

Për të vërtetuar se kjo teori konspirative është e rreme dhe mashtron njerëzit, Forbes publikoi një [studim](#) në të cilin 76 kimistë dhe shkencëtarë nga Universiteti i Irvine, Kaliforni, konfirmuan se ata kurrë nuk kishin gjetur prova të programeve të spërkatjes kimike në shkallë të gjerë nga aeroplanët për të dëmtuar shëndetin e qytetarëve dhe për të ndikuar në atmosferën.

## Mohimi i ndryshimeve klimatike

[Mohimi i ndryshimeve klimatike](#) është një teori konspirative e vazhdueshme që hedh dyshim mbi konsensusin e komunitetit shkencor në lidhje me ndryshimet klimatike dhe pasojat e tij të tmerrshme.

Përhapja e dezinformatave dhe teoritë konspirative rreth ndryshimeve klimatike i pengon përpjekjet globale për zgjidhje të një prej çështjeve më urgjente të kohës sonë. Përhapen pretendime të pabaza se [ndryshimet klimatike janë mashtrim](#) ose pjesë e një plani të madh për të kontrolluar botën.

Në realitet, një pjesë e madhe e [kërkimeve shkencore](#) e mbështesin idenë se aktivitetet njerëzore, kryesisht djegia e karburanteve fosile, kontribuojnë dukshëm për ngrohjen globale. Krahas kësaj, shumica e organizatave kryesore shkencore në mbarë botën publikuan deklarata publike me të cilat e mbështesin këtë qëndrim. [Rreth 97 përqind e shkencëtarëve](#) klimatikë në mbarë botën pajtohen se ndryshimet klimatike janë reale dhe të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor. Në botën shkencore ky është konsensus.

## 5G

Teoria e konspiracionit 5G pretendon se futja e teknologjisë pa tel të gjeneratës së pestë është e dëmshme për shëndetin e njeriut dhe është mjet potencial për mbikëqyrje të qeverive. Shpërndahen publikime në të cilat thuhet se 5G është një [armë e shkatërrimit në masë](#), por komuniteti shkencor është i bindur se teknologjia 5G do të përdoret për të përmirësuar komunikimet në komunikimet ushtarake, por jo si një armë e shkatërrimit në masë. Ekspertët thonë se është e pakuptimtë përhapja e thashethemeve të frikshme se 5G përdoret si armë nga ushtria.

Po ashtu në Facebook shpërndahen postime që thonë se antenat 5G [maskohen si kaktus](#), duke konfirmuar se ato janë të dëmshme. Por e vërteta është se kamuflimi i këtyre antenave bëhet kryesisht për pamje estetike dhe për radiofrekuencë më të mirë, për të mos pësuar dëmtime nga kushtet atmosferike që mund të shkaktojnë ndërprerje në transmetimin e valëve të radios.

Në rrjetet sociale u shfaq gjithashtu një postim duke thënë se presidenti rus **Vladimir Putin** ka ndaluar [kullat 5G](#) dhe se Rusia do t'i shkatërrojë ato. Por si mbështetje nuk është ofruar asnjë provë e besueshme. Përkundrazi, sipas informacioneve të publikuara në faqet e internetit të [Qeverisë së Rusisë](#) dhe Ministrisë së Zhvillimit Digjital, Komunikimit dhe Masmediave të Rusisë, në vend ekzistojnë programe aktive për rritjen e përfshirjes së rrjetit 5G.

Shpërndahej edhe një e pavërtetë se [5G mund të aktivizojë patogjenët](#) që gjenden në vaksinat kundër Kovid dhe të shkaktojë sëmundje në trupat e të vaksinuarve. Në shkurt 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) gjithashtu [njoftoi se](#) nuk ishte zbuluar asnjë ndikim të këtij rrjeti në shëndetin publik. Rrjeti celular [5G](#) nuk ka kurrfarë ndikimi as ndaj viruseve, as ndaj baktereve dhe nuk mund të përhapë sëmundje.

Teknologjia 5G funksionon në kuadër të udhëzimeve të përcaktuara të sigurisë dhe studime të shumta nuk kanë gjetur prova bindëse që e lidhin atë me efekte negative shëndetësore. Pretendimet për kullat 5G që dyshohet se shkaktojnë Kovid-19 ose përdoren për kontrollin e mendjes janë hedhur poshtë gjerësisht.



## HAARP dhe kontrolli i kohës

Programi me frekuencë të lartë për hulumtim të dritës ([HAARP](#)) është projekt i përbashkët i partnerëve të ndryshëm: industria, Ministria e Mbrojtjes e Amerikës dhe universitete të shumta në mbarë SHBA-në. Shkencëtarët krijuan laboratorin në Gakoni, Alaskë dhe instaluan 180 antena me frekuencë të lartë të cilat së bashku mund të emitojnë 3.600 kilovatë radiovalë në frekuenca prej 2.8 deri në 10 megahercë (rang i frekuencës së lartë), që u mundëson instrumenteve të ndjeshme t'i matin proceset fizike që zhvillohen në atë brez.

Po, për teoricionët e konspiracionit ky është projekt i fshehtë qeveritar qëllimi i të cilit është kontrolli i kohës, shkaktimi i katastrofave natyrore dhe manipulimi me mendjet.

Disa teoricienë të konspiracionit akuzuan se [HAARP-i është fajtor për ndryshimet klimatike](#), si dhe për paraqitjen e tërmeteve dhe uraganeve. U pretendua se [moti i lig](#) në fillim të gushtit në vend, si dhe [moti i lig i fuqishëm](#) që e goditi Slloveninë në korrik, janë rezultat i HAARP-it. Këto pretendime nuk janë të mbështetura me prova shkencore dhe janë hedhur poshtë gjerësisht. Siç potencuam, ndryshimet klimatike janë reale. Nuk është i saktë pretendimi se ato janë rezultat i HAARP-it dhe se antenat mund të ndikojnë mbi ndryshimet klimatike, se shkaktojnë tërmete ose ndryshime në disponimin e njerëzimit.

## Bill Gejts dhe Kllaus Shvab janë objekt i teorive konspirative

Dy personalitete të dalluara që kanë qenë objekt i teorive të shumta të pabaza të konspiracionit janë **Bill Gejts dhe Kllaus Shvab**.

**Bill Gejts**, bashkëthemelues i Majkrosoftit dhe filantrop i dalluar, u bë objekt i teorive konspirative që pohojnë se ai shfrytëzon vaksina për futjen e mikroçipeve te njerëzimit dhe për ta kontrolluar popullsinë.

Një tjetër teori konspirative sillet rreth idesë se Gejts-i dëshiron ta [shpopullojë](#) botën përmes programeve për vaksinim. Në realitet, përpjekjet e Gejts-it në shëndetin publik janë orientuar në shpëtimin e jetëve dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonet e varfra.

Shpërndaheshin lajme të pavërteta se [Gejts-i përmes mushkonjave](#) do të injektojë te popullsia helme dhe viruse, siç e ka bërë atë me vaksinat mRNA gjatë pandemisë COVID. Megjithatë Fondacioni Gejts siguron financim dhe mbështetje për luftë kundër malaries, ajo nuk ka financuar kurrfarë aktivitete që përfshijnë mbrojtje nga mushkonjat në SHBA ose në cilindo vend tjetër në botë. Fondacioni e ka mbështetur kompaninë bioteknologjike "[Oksitek](#)", e cila lëshon mushkonja të modifikuara në Floridë si pjesë e iniciativës për kontroll të sëmundjes, por zëdhënësi i kompanisë ka deklaruar se puna e saj në SHBA nuk është financuar nga Fondacioni Gejts.

U manipulua gjithashtu se Gejts-i thur komplot për gjenocid, se ai [dëshiron një pandemi globale dhe një shtet burg](#). Këto pretendime erdhën nga rubrika e tij në Nju Jork Tajms, por ai në fjalimin e tij në fakt flet për idenë e formimit të ekipeve të ekspertëve në çdo shtet që do të dinë si t'i përgjigjen shpejt sfidës nëse ndodh një pandemi e re.

**Kllaus Shvab**, themeluesi dhe kryetari ekzekutiv i Forumit Ekonomik Botëror (FEB), është edhe një person tjetër objekt i teorive konspirative. FEB është i njohur për takimet e tij vjetore në Davos, Zvicër, ku liderët globalë mblidhen për të diskutuar për çështje urgjente globale. Sipas teorive konspirative, Shvab dhe FEB janë pjesë e një planifikimi të fshehtë global për të krijuar një Rënd të Ri Botëror.

U pretendua gjithashtu se Shvab ka [urdhëruar qeveritë në botë](#) që t'i arrestojnë të gjithë ato që kanë lexuar “lajme të rreme” dhe t'i ndalojnë mediat e pavarura. Megjithëse në [faqen e internetit të Forumit Ekonomik Botëror](#) janë shpërndarë disa rekomandime për ballafaqimin me dezinformatat, Shvab nuk ka kurrfarë autorizimesh, as fuqi juridike ose politike t'u “urdhërojë” qeverive në mbarë botën se çfarë të bëjnë. Kjo është një dezinformatë klasike.

Më pas, duke cituar një libër të supozuar të tij, ai u prezantua si një [përbindësh që ka një plan për të likuiduar 4 miliardë njerëz](#), gjë që është gjithashtu e pasaktë, pasi ai nuk është autor atij libri me atë titull.

Në rrjetet sociale u shfaq një pretendim se [Forumi Ekonomik Botëror](#) kërkon të ndalojë ngjizjen natyrale, përkatësisht se të gjitha foshnjat duhet të rriten në laborator. Por e vërteta është se Forumi Ekonomik Botëror nuk ka autoritet për të ndaluar ngjizjen natyrale dhe qëllimi i tillë nebuloz as që gjendet në agjendën e tyre.

Teoritë konspirative si Kju Anon, 5G, HAARP, kemtrejlls dhe të ngjashme kanë potencial ta cenojnë besimin e publikut në shkencë, tek institucionet, mund t'i cenojnë politikat publike, të nxisin frikë te publiku dhe në disa raste çojnë në dëme reale.

Është thelbësore të jemi të kujdesshëm dhe të vlerësojmë në mënyrë kritike informacionet që i hasim, duke kërkuar burime të besueshme dhe duke u mbështetur në konsensusin e ekspertëve. Duke kuptuar bazat e këtyre teorive konspirative dhe faktet që i zbulojnë, mund të nxisim një shoqëri e cila e vlerëson të menduarin kritik të bazuar në prova.

## Nuk ekziston asnjë agjendë e BE-së për ta shkatërruar prodhimin tradicional të ushqimit

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 24.09.2023

Në postimin në Facebook nuk është shpërndarë teksti i plotë dhe nuk mund të shihet se bëhet fjalë për eutanazinë e derrave në Kroaci për shkak të sëmundjes jashtëzakonisht ngjitëse - murtajës afrikane, dhe jo për ekzistimin e ndonjë plani global për të shkatërruar prodhimin e ushqimit tradicional dhe për të kaluar në ushqimin sintetik. Nuk ka asnjë konspiracion global për të shkatërruar bujqësinë, përkatësisht qëllimi i Komisionit Evropian është që në 10 vitet e ardhshme 25 për qind e bujqësisë të përdoret për prodhim organik. Deri në vitin 2030, BE-ja duhet doemos të vendosë instrumente rregullatore që do të reduktojnë emetimet e gazeve serrë nga bujqësia, do të rrisin rezistencën e prodhimit bujqësor, do ta përmirësojnë biodiversitetin në zonat rurale dhe do të kontribuojnë në sigurimin e ushqimit të shëndetshëm për popullsinë botërore në rritje.

**T**ë shpeshtë janë dezinformatat që përhapen në rrjetet sociale se është në procedurë një plan global në BE për të shkatërruar prodhimin tradicional të ushqimit dhe për të kaluar në ushqim sintetik. Në lidhje me këtë tezë që shpërndahet në publik, paraqesim [një postim](#) në rrjetin social [Facebook](#) ku thuhet:

Kroacia është në BE, më duket 10 vite

Kështu që keni një shembull!

Në BE, në procedurë është plani global për të shkatërruar prodhimin tradicional të ushqimit dhe për të kaluar në ushqimin sintetik.

Ndërkohë, në koloni aspirojnë për në BE, shih foton në të djathtë.



Foto: pixabay.com

Si mbështetje për këtë shpërndahet edhe një foto, përkatësisht një titull nga [një tekst](#) që flet për eutanazinë e derrave në Sllavoni.

Por meqenëse i gjithë teksti nuk është shpërndarë, nuk mund të shihet se bëhet fjalë për eutanazinë e derrave në Kroaci për shkak të një sëmundjeje - murtajës afrikane, dhe jo për shkak të ekzistimit të ndonjë plani global për të shkatërruar prodhimin e ushqimit tradicional dhe kalimin në ushqim sintetik.

Në [tekstin](#) e mediave kroate thuhet se pasi Instituti Veterinar Kroat konfirmoi praninë e murtajës afrikane te derrat në zonën e dy qarqeve, për dy muaj ka ndodhur një katastrofë në fermat, përkatësisht me falimentim janë duke u përballur 444 ferma familjare bujqësore të cilët së paku një vit nuk guxojnë të blejnë dhe të ruajnë derra, dhe rimëkëmbja e fermave të derrave mund të zgjasë deri në pesë vjet. Sipas të dhënave të Ministrisë Kroate të Bujqësisë, murtaja afrikane është konfirmuar në tre objekte në qarkun Brodsko-Posavë dhe në 441 objekte në qarkun Vukovar-Srem. Thuhet se deri më tani janë vrarë 8796 derra. Të gjithë derrat e vrarë kanë qenë në objekte në të cilat me analizë laboratorike është konstatuar prezencë e murtajës afrikane të derrave. Sëmundja u konfirmua edhe te katër derrat e egër. Fakti që sëmundja arriti të kufizohej vetëm në dy qarqe në Kroaci, konsiderohet një reagim i mirë i shërbimeve kompetente.

Megjithatë, njerëzit po përballen me probleme të mëdha financiare, pasi mbarështuesve të derrave në këto dy qarqe prej gati dy muajsh u është ndaluar të shesin derrat, mishin e derrit dhe prodhimet e derrit, vetëm nëse i shesin ato në thertore. Por kjo nuk ndodh në praktikë, sepse thertoret i marrin derrat nga fermat që punojnë brenda korporatave të tyre.

**Ky tani po bëhet një problem i madh. Derrat të cilët para dy muajsh peshonin 140 kg tani janë mbi 200 kg dhe nuk i duhen askujt për momentin, sepse industria e mishit nuk do të marrë asgjë më të rëndë se 140 kg, [thotë](#) Antun Goluboviq, mbarështues i derrave nga Gjuriç (Sllavoni) dhe kryetar i Bordit të Mbarështimit të Derrave të Odës Kroate të Bujqësisë (HPK).**

Tani ai praktikisht ka mbetur pa punë, sepse 65 për qind e të ardhurave të tij kanë qenë nga derrat.

**Tani më mbetet të paguaj taksa dhe kontribute, por njerëz si unë janë të lirë të deklarojnë falimentimin. Problemi më i madh është se kam mbetur pa material për shtim, pa gjenetikën në të cilën kam punuar 20 vite dhe që tani ka humbur. Tani në këtë moment, nëse infektimi ndalon dhe dikush të më sjellë derra, për të filluar nga e para, do të më duheshin të paktën tre deri në katër vite për të qenë aty ku isha deri më 3 gusht (para infektimit), plus një vit tjetër ndalim, kështu që pese vite. Unë jam 47 vjeç dhe ndoshta do të vendos të bëj një hap të tillë, por të moshuarit jo. [thotë](#) Goluboviq.**

Përkundër asaj që dëshiron të paraqesë postimi manipulues në Facebook, e vërteta është se në Kroaci, shtet anëtar i Bashkimit Evropian, Ministria e Bujqësisë [njoftoi](#) se ka murtajës afrikane të derrave, dhe [Oda e Veterinerëve të Kroacisë](#) apeloj të respektohet parandalimi dhe të gjitha masat e qeverisë për të parandaluar përhapjen e sëmundjes. Duhet theksuar gjithashtu se [qeveria kroate ka Program për dëmshpërblim dhe ndihmë](#) të amvisërive të cilët për shkak të kësaj sëmundjeje kanë qenë të detyruar t'i humbin kafshët e tyre shtëpiake - derrat - për shkak të kësaj sëmundjeje.

[Murtaja afrikane](#) është një sëmundje virale shumë ngjitëse te derrat shtëpiake dhe të egër të të gjitha kategorive të moshave. Virusi lëshohet përmes gjakut, indeve, sekrecioneve dhe jashtëqitjeve të kafshëve të sëmura ose të ngordhura. Sëmundja transmetohet dhe përhapet nga: kontakti i drejtpërdrejtë ndërmjet një kafshe të shëndoshë dhe të sëmurë, nga kafshët e ngordhura; transmetohet në mënyrë indirekte përmes ushqimeve të kontaminuara dhe mbetjeve ushqimore, pajisjeve, automjeteve dhe veshjeve; transmetimi biologjik nga vektorët - rriqrat e buta të llojit *Ornithodoros*. Kjo sëmundje nuk është e rrezikshme për shëndetin e njeriut, por është shumë vdekjeprurëse tek këto kafshë dhe nuk mund të trajtohet.

Kontrolli i sëmundjeve të derrat kryhet në tre nivele: parandalimi, zbulimi i hershëm dhe reagimi i shpejtë. Parandalimi tek kafshët mund të jetë direkt ose indirekt. Parandalimi i drejtpërdrejtë përfshin zbatimin e [masave të biosigurisë](#) nga mbarështuesit e kafshëve në ferma për të parandaluar shfaqjen e sëmundjeve dhe për të ruajtur gjendjen shëndetësore të kafshëve në nivel të kënaqshëm.

Masat e biosigurisë së fermës ndahen në masa të jashtme të biosigurisë, të cilat u referohen aktiviteteve dhe masave për parandalimin e hyrjes së agjentëve infektivë ose shkaktarëve të sëmundjes në vendin e mbarështimit (bio-exclusion) dhe masave të brendshme të biosigurisë, të cilat përfshijnë masa dhe aktivitete për parandalimin e përhapjes së agjentit infektues ose sëmundjes në vendin e mbarështimit ku është shfaqur si dhe përhapjes në vende tjera të mbarështimit (bio-containment). Në të gjitha vendet e mbarështimit të derrave duhet të zbatohen parimet bazë të biosigurisë, përkatësisht: ndarja ose izolimi, pastrimi dhe dezinfektimi. Në ato ferma ku është konstatuar prania e murtajës afrikane, derrat e tyre eutanizohen pa shfrytëzim ekonomik të kafshëve.

Sa i përket pjesës së postimit ku thuhet se në BE është në procedurë një plan global për të shkatërruar prodhimin tradicional të ushqimit, ka shumë argumente që tregojnë se kjo është e pavërtetë dhe se nuk bëhet fjalë për kurrfarë agjendë apo konspiracion botëror.

Për shembull, qëllimi i Komisionit Evropian është që në 10 vitet e ardhshme, 25 për qind e bujqësisë të [shfrytëzohet](#) për prodhim organik.

Komisionari evropian për bujqësi, **Janush Vojçehovski**, [thotë](#) se bujqësia organike do të bëhet prioritet për Komisionin Evropian.

**Bujqësia organike do të jetë një aleat kryesor në tranzicionin që e realizojmë drejt një sistemi ushqimor më të qëndrueshëm dhe mbrojtjes më të mirë të sektorit organik. Komisioni do të vazhdojë ta mbështesë sektorin organik në qëllimin që deri në vitin 2030 - 25 për qind e tokës të shfrytëzohet për prodhimtari organike përmes politikave të duhura dhe kornizës ligjore, [theksoi](#) Vojçehovski.**

Ky lloj bujqësie, përkatësisht prodhimi organik, përdor substanca natyrore dhe ka një efekt më pak të dëmshëm ndaj mjedisit jetësor. Bujqit që punojnë prodhim organik shfrytëzojnë më shumë burime të rinovueshme dhe kanë kujdes që biodiversiteti ekologjik të mbrohet, për shembull, përmes shfrytëzimit të përgjegjshëm të ujit. Bujqësia organike kërkon edhe mbrojtje më të rreptë të kafshëve dhe nevojave të tyre.

Deri në vitin 2030, BE-ja [duhet](#) të ketë instrumente rregullatore që do t'i reduktojnë emetimet e gazeve serrë nga bujqësia, do të rrisin qëndrueshmërinë e prodhimit bujqësor, do të përmirësojnë biodiversitetin në zonat rurale dhe do të kontribuojnë [në](#) sigurimin e ushqimit të shëndetshëm për një popullsi botërore në rritje.

BE-ja gjithashtu [ka për qëllim çrrënjosjen](#) e varfërisë, sigurimin e punës së denjë dhe rritjen ekonomike, prodhimin dhe konsumin e përgjegjshëm.

Fotoja e dytë e shpërndarë në këtë postim në Facebook tregon një mesazh politik me të cilin promovohen fondet evropiane për bujqësinë të cilat [në vend janë një tregim i suksesshëm](#).

Për të gjitha faktet e mësipërme, vlerësojmë se në postimin që e paraqesim mungon konteksti. Në BE nuk është në procedurë një plan global për shkatërrimin e prodhimit tradicional të ushqimit, planet janë që ushqimi në të ardhmen të mos jetë sintetik, por organik.

## HAARP-i as është, as që mund të jetë fajtor për ndryshimet klimatike

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 11.07.2023

Rreth **97 përqind të shkencëtarëve klimatikë** në mbarë botën pajtohen se ndryshimet klimatike janë reale dhe të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor. Në botën shkencore ky është konsensus. **HAARP-i**, është një program kërkimor aktiv me frekuencë të lartë të dritës polare, por teoricienët e konspiracionit thonë se HAARP-i është dizajnuar për të prodhuar tërmete dhe katastrofa tjera natyrore, si dhe ndryshim të kushteve natyrore. Megjithatë, shkencëtarët dhe meteorologët thonë se HAARP-i nuk mund ta ndryshojë kohën, e jo të shkaktojë tërmete

**S**e ndryshimet klimatike nuk ekzistojnë, por se për atë është fajtor HAARP-i “famëkeq është e shpeshtë dezinformata e cila përhapet në rrjetet sociale. Një prej shembujve të tillë është edhe **postimi** në rrjetin social **Facebook** në të cilin pretendohet pikërisht kjo – se nuk ka ndryshime natyrore, por vetëm artificiale të shkaktuara nga HAARP-i. Kjo nuk është e saktë. Ndryshimet klimatike janë dukuri e dëshmuar shkencore, ndërsa HAARP-i “famëkeq është një prej teorive më të përhapura të konspiracionit në disa vitet e kaluara, të cilat shpesh mund të gjenden në rrjetet sociale.

**NDRYSHIMET KLIMATIKE???**

**NUK KA NDRYSHIME KLIMATIKE POR NDRYSHIME ARTIFICIALE !!!**

**HARPI DUHET TË SHKATËRROHET!!!**, shkruan në postimin.

Postimi në Facebook, i cili është objekt i këtij recensionit, i manipulon përdoruesit e rrjeteve sociale se nuk ekzistojnë ndryshime klimatike, përkatësisht se nuk ka ndryshime natyrore, por se ato janë të krijuara në mënyrë artificiale. Sipas postimit, HAARP-i është fajtor për ndryshimet që i ndiejmë.



Foto: Pixabay

## Ndryshimet klimatike janë realitet

Rreth [97 përqind të shkencëtarëve klimatikë](#) në mbarë botën pajtohen se ndryshimet klimatike janë reale dhe të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor. Në botën shkencore ky është konsensus.

[Provat shkencore](#) tregojnë se aktivitetet njerëzore (fillimisht djegia e karburanteve fosile nga njeriu) e kanë nxehur sipërfaqen e Tokës dhe basenet e saj të oqeanit, që vazhdon të ndikojë mbi klimën e Tokës. Së këndejmi, sipas studimeve të shumfishta të publikuara në revistat shkencore relevante, trendët e ngrohjes së klimës në shekullin e kaluar janë jashtëzakonisht të mundshëm për shkak të aktiviteteve njerëzore. Krahas kësaj, shumica e organizatave shkencore kryesore në mbarë botën publikuan deklaratat me të cilat e mbështetnin këtë pozitë.

[Ngrohja globale](#) shkakton rritje të temperaturës mesatare të sipërfaqes së Tokës. Kjo jo vetëm që i rrit valët e mundshme të ngrohjes dhe thatësinë, por, gjithashtu, shkakton ndryshime në sistemet tona klimatike natyrore. Këto ndryshime i bëjnë ngjarjet ekstreme të motit më të mundshme dhe më serioze. Për shembull, uraganet dhe stuhitë bëhen më intensivë, lëvizin më ngadalë dhe u duhet një kohë më të gjatë që të qetësohen.

Ky trend është pjesë e [ndryshimeve klimatike](#), të cilat shumë njerëz e konsiderojnë sinonim të ngrohjes globale. Shkencëtarët preferojnë ta përdorin termin “ndryshime klimatike”, kur i përshkruajnë ndryshimet klimatike të cilët tani ndikojnë mbi sistemet kohore dhe klimatike të planetit tonë. Ndryshimet klimatike përfshijnë jo vetëm ngrohjen e temperaturave mesatare, por edhe ngjarjet ekstreme të motit, zhvendosjen e popullatës dhe habitateve të botës së egër, rritjen e nivelit të deteve dhe një sërë ndikimesh tjera.

HAARP-i, nga ana tjetër, as që është, as që mund të jetë fajtor për ndryshimet klimatike.

[HAARP](#) është program kërkimor aktiv me frekuencë të lartë të dritës polare i cili është projekt i përbashkët i partnerëve të ndryshëm: industria, Ministria e Mbrojtjes e Amerikës dhe universitetet e shumta në mbarë SHBA-në. Shkencëtarët krijuan laboratorin në Gakoni, Alaskë, dhe instaluan 180 antena me frekuencë të lartë, të cilat së bashku mund të emitojnë 3.600 kilovatë radiovalë të frekuencave nga 2.8 deri në 10 megahercë (rang me frekuencë të lartë), që u mundëson infrastrukturave veçanërisht të ndieshme t’i matin proceset fizike që zhvillohen në atë brez.

Puna e objektit kërkimor u transferua nga Forcat ajrore të ShBA-së në Universitetin në Alaskë, Ferbenks, më 11 gusht 2015, duke i lejuar HAARP-it të vazhdojë me kërkimet e fenomenologjisë së jonosferës përmes marrëveshjes për bashkëpunim për kërkim dhe zhvillim për shfrytëzimin e tokës.

Për shkak të teknologjive të reja të instaluara, ShBA-ja këto antena i përdor edhe në komunikimet dhe në pjesët veçanërisht të thella të deteve ose tokës. Por, **nuk është i saktë pretendimi** se këto antena mund të ndikojnë mbi ndryshimet e klimës, se shkaktojnë tërmete ose ndryshime në disponimin e njerëzit.

Në [ueb faqen zyrtare](#) të projektit thuhet se “i studion cilësitë dhe sjelljen e jonosferës”:

Jonosfera shtrihet në rreth 50 deri në 400 milje mbi sipërfaqen e Tokës, pikërisht në buzë të kozmosit. Së bashku me atmosferën e epërme neutrale, jonosfera e formon kufirin ndërmjet atmosferës së poshtme të Tokës – ku jetojmë dhe frymojmë – dhe vakumit në kozmosin.

Teoricienët e konspiracionit thonë se HAARP-i është dizajnuar të prodhojë tërmete dhe katastrofa tjera natyrore, si dhe ndryshim të kushteve të motit. Megjithatë, shkencëtarët dhe meteorologët thonë se HAARP-i nuk mund ta ndryshojë motin, e jo të shkaktojë tërmete.

Radiotransmetimet nga HAARP-i shkaktojnë vetëm efekte të vogla në jonosferën të cilat zgjasin një kohë të shkurtër, disa sekonda. Nuk ka prova se HAARP-i mund të shkaktojë katastrofa natyrore ose të ndikojë mbi lëvizjet dhe mendimet e njeriut.

Megjithëse teoria e konspiracionit se “ndryshimet klimatike nuk ekzistojnë” është bazuar në dezinformata dhe ekzistojnë dëshmi që e hedhin poshtë këtë pretendim, megjithatë, në të besojnë pothuajse gjysma e qytetarëve. Hulumtimi i “Institutit për Demokraci” nga nëntori 2021 tregoi se 46 për qind e qytetarëve besojnë se klima kontrollohet me satelitë dhe radarë (HAARP), ndërsa 29 për qind mendojnë se ndryshimet klimatike janë trillim.

Nga të gjitha faktet e cekura arrijmë në përfundim se *dezinformata* është pretendimi se ndryshimet klimatike nuk ekzistojnë, se janë artificiale dhe se për atë është fajtor HAARP-i.



## Vijat e bardha të ndërprera pas aeroplanit nuk janë dëshmi e gjurmëve kimike

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit, 12.12.2023

Gjurmët e bardha pas avionëve, të cilat teoricienët e konspiracionit i quajnë “kemtrails”, krijohen kur avujt e ujit dhe grimcat e vogla të karburantit të djegur të avionëve nga aeroplanët ngrijnë në kristale akulli. Ndërprerja e shtigjeve të bardha pas avionit është pasojë e një ndryshimi të kushteve të nevojshme për krijimin e kondensimit dhe jo një provë që avioni po lëshon me qëllim “kemtrails” dhe se pikërisht në atë moment piloti ka fikur sistemi. Teoria e konspiracionit se gjurmë të tilla janë, në fakt, të qëllimshme dhe të planifikuara me helme dhe metale të rënda, është hedhur poshtë vazhdimisht, por megjithatë përsëritet në rrjetet sociale.

Një [postim](#) në [Facebook](#) shpërndau një video si pjesë e një teorie konspirative që pretendon se gjurmët e bardha të lëna nga aeroplanët, të njohura si “chemtrails”, janë helmuese dhe të rrezikshme. Videoja e shpërndarë tregon gjurmët e bardha pas aeroplanit që ndalojnë në një moment, një moment që autori e përdor për të mbështetur teorinë e tij se avioni po lëshonte kimikate toksike me qëllim.

Pretendimi se gjurmët e bardha pas ndalimit të avionit janë dëshmi e “spërkatje të planifikuara” është dezinformim, duke mbështetur një teori konspirative që është përsëritur për më shumë se 20 vjet. Nuk bëhet fjalë për vendosjen e sistemit “chemtrails”, por për një ndryshim të kushteve në ajër, qoftë për shkak të uljes së shpejtësisë, ndryshimit të lartësisë së avionit, kalimit të avionit nga troposfera në stratosferë ose anasjelltas.



Foto: [Joachim Süß](#) on [Unsplash](#)

Autori i postimit u bën thirrje atyre që pretendojnë se gjurmët e avionëve janë gjurmë kondensimi, të paraqesin argumente shkencore për këtë fenomen:

### HU jo HU si kështu ekspertë???

Ata që pohojnë se gjurmët e aviones, plus Vërtetmatësi, Faktçekerat... janë gjurmë të motoreve (nga kondensimi) i avioneve, do u kerkoj të paraqesin argumente shkencore për këtë aeroplan, a është prishur, i ka dështuar kondensatorin, apo i ka mbaruar HU.. .si thoni Vërtetmatësi ???

Teoria e ekzistencës së “gjurmëve kimike” dhe “spërkatjes të rrafshët” me metale toksike dhe të rënda përsëritet vazhdimisht, megjithëse është hedhur poshtë shumë herë nga shkenca. [Gjurmët e bardha](#) që aeroplanët lënë pas krijohen kur avujt e ujit dhe grimcat e vogla të karburantit të djegur të avionëve në aeroplan ngrihen në kristale akulli. Me lagështi të ulët të ajrit, kristalet thjesht shpërbëhen. Në lagështi më të lartë ato vazhdojnë dhe përfundimisht krijojnë një gjurmë të dukshme në zona të mëdha të qiellit.

Formimi i tyre kërkon tre elementë: avujt e ujit, ajri i ftohtë dhe grimcat mbi të cilat avulli i ujit mund të kondensohet. Avulli i ujit prodhohet nga avioni pasi hidrogjeni në karburantin e tij reagon me oksigjenin në ajër. Jo të gjithë avionët lënë gjurmë të bardha - vlerësohet se kjo ndodh vetëm në rreth 18 për qind të fluturimeve. Ajri duhet të jetë mjaft i ftohtë që uji të ngrijë, kjo është arsyeja pse ato zakonisht ndodhin vetëm mbi lartësi të caktuara - zakonisht mbi 6 km.

Pikërisht ndryshimi i kushteve rreth avionit është shkak i zhdukjes së papritur, pra ndalimi i krijimit të gjurmëve të bardha pas avionit të theksuara në video. Nëse avioni ndryshon lartësinë, kalon nga një shtresë e atmosferës në tjetrën ose zvogëlon shpejtësinë, duke zvogëluar ose ndaluar shkarkimin e mbetjeve të karburantit të djegur të avionit, atëherë nuk ka kushte për formimin e shtigjeve të bardha.

Siç ka shkruar shumë herë më parë “[Vërtetmatësi](#)”, këto gjurmë që të gjithë i shohim në qiell nuk janë rezultat i ndonjë agjende të fshehur për të ndotur popullsinë me helme. Në fund të fundit, gjurmë të tilla avionësh ka në hapësirën ajrore të të gjitha vendeve, jo vetëm në vendin tonë!

“[Chemtrails](#)” është në fakt një teori konspirative që është më shumë se dy dekada e vjetër. Kjo teori e rreme dhe e bazuar në dezinformata përfaqëson besimin se këto shenja të zakonshme të prodhuara nga aeroplanët në ajër janë “gjurmë kimike”, të përbëra nga agjentë kimikë ose biologjikë. Mbështetësit e kësaj teorie janë të bindur se qeveri të ndryshme po përpiqen të ndikojnë negativisht në klimën apo shëndetin e njerëzve duke spërkatur kimikate toksike në mënyrë që të shkaktojnë ulje të numrit të banorëve të planetit.

Ata që besojnë në këtë teori konspirative besojnë se nëse gjurma e avionëve është e dukshme për një kohë të gjatë, duhet të përmbajë disa lloj substancash të rrezikshme. Sipas besimeve të tilla, gjurma e zakonshme e avionëve duhet të shpërndahet shpejt, dhe për këtë arsye, retë që nuk zhduken duhet të jenë plot me substanca shtesë, të pazbuluara, domethënë një lloj helmi.

Për të vërtetuar se kjo teori konspirative është e rreme dhe mashtron njerëzit, Forbes publikoi një [studim](#) në të cilin 76 kimistë dhe shkencëtarë nga Universiteti i Irvine, Kaliforni, thanë se nuk kishin hasur kurrë në ndonjë provë të programeve të spërkatjes kimike në shkallë të gjerë nga avionët me qëllim për të dëmtuar shëndetin e qytetarëve dhe për të ndikuar në atmosferë.

Sipas këtij hulumtimi, arsyeja pse shenjat e avionëve mbeten të dukshme është sepse ato fluturojnë në lartësi më të larta se më parë, duke rezultuar në shtigje kondensimi që zgjasin më gjatë. Fakti që gjurmët e avionëve kryqëzohen është e vetmja dëshmi se ka një frekuencë të shtuar të trafikut ajror, pra se ka shumë më tepër avionë që marrin pjesë në trafikun ajror, që është arsyeja kryesore që disa prej tyre duhet të fluturojnë në lartësitë më të larta.

Nga të dhënat e paraqitura se si krijohen gjurmët e bardha të avionëve dhe çfarë kushtesh nevojiten për krijimin e tyre, del qartë se videoja e shpërndarë në Facebook është dezinformate që synon krijimin e frikës, panikut dhe pasigurisë.

## 6. Ndikimet dhe propagandat e huaja të dëmshme

Interneti në përgjithësi, dhe rrjetet sociale në veçanti, janë bërë leva kryesore e përhapjes së propagandës autoritare dhe ndikimeve të tjera të dëmshme të huaja jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mbarë botën. Lehtësia me të cilën mund të arrihet një publik i konsiderueshëm jashtë vendit, pa pasur nevojë për udhëtime të shtrenjta dhe shpenzime të tjera, është zgjedhja e parë e të gjithë atyre që duan t'i mbjellin apo zgjerojnë narrativët e tyre propagandistike në fqinjësi, por edhe në mbarë botën nëse bëhet fjalë për shtete të mëdha me interesa globale.

Fatkeqësisht, përveç pasojave të shumta pozitive që i solli rrjeti global i komunikimeve përmes lehtësimit dramatik të komunikimeve nga sfera e biznesit, shkencës, arsimit etj., ai u dha armë në dorë të gjithë atyre që duan të përhapin ose thellojnë ndarjet tashmë ekzistuese në vende të tjera, politikën e të cilave nuk janë në përputhje me interesat e tyre ose, më shpesh, në përputhje me elitat jodemokratike dhe autoritare në vendin i cili përhap propagandë të tillë. Njëkohësisht, ato janë mjet i fuqishëm për të shkaktuar frikë tek popullata e huaj, si dhe për të nxitur ndjenja siç janë: tërbimi, mungesa e shpresës dhe mungesa e perspektivës, përkatësisht demoralizimi. Madje mund të nxisin edhe sjellje agresive dhe destruktive, duke përhapur gjuhë të urrejtjes, thirrje për dhunë, dezinformim, manipulim, shpifje, fyerje, përkatësisht atentate karakteresh ndaj armiqve të tyre etj.

## Rrjetet sociale dhe mediat - një levë për përhapjen e propagandës autoritare

Shkruan: **Goran Lefkov**, 04.05.2023

Propaganda ruse përdor forma të ndryshme të mediave sociale dhe kanaleve për të përhapur propagandën e saj. Ajo po bën një luftë në Ukrainë, por po bën gjithashtu një luftë hibride me shumë vende të tjera. Maqedonia e Veriut dhe Ballkani janë objektivi i kësaj propagande

**R**rjetet sociale janë arma më e fortë e propagandës ruse. Gënjeshtër, manipulime, shtrembërime të së vërtetës. Kjo është receta me të cilën regjimi i Putinit po “bombardon” botën demokratike. Me fillimin e luftës në Ukrainë, Bashkimi Evropian ndaloi kanalet ruse nga të cilat përhapej propaganda ruse, si “Russia Today”, “Sputnik” dhe televizione dhe media të tjera. Pastaj propaganda ruse filloi të shtohet përmes mjeteve të komunikimit në rrjetet sociale.

Objektivi kryesor i propagandës ruse sot është rrjeti social Facebook, sepse ndryshe nga Facebook-u tradicional, nuk ka një kontroll rigoroz të asaj propagande. Gjithçka mund të publikohet, thotë **Goran Georgiev**, studiues në Qendrën për Hulumtime Demokracie, nga Sofja.

**Një arsye tjetër pse njerëzit shkojnë në Facebook është se propaganda ruse është shumë më efektive atje, ndryshe nga mediat tradicionale ku ka përmbajtje të tjera dhe propagandistët rusë nuk janë të sigurt nëse mesazhi do të arrijë tek përdoruesit për të cilët është menduar, thotë Georgiev.**



Foto: [Artur Janas](#) from [Pixabay](#)

Në Qendër janë duke punuar në hulumtimin e aktiviteteve të ambasadave ruse në Ballkan, duke përfshirë edhe misionin rus në Shkup. Vërtetmatësi tashmë [ka raportuar](#) për aktivitetet në rrjetet sociale të kësaj ambasade.

Rusia dhe aleatët e saj po bëjnë gjithçka për të lejuar që këndvështrimi i tyre të mbizotërojë në mediat sociale.

Për shkak të aktiviteteve të tyre, Metës – pronarit të rrjetit social Facebook, iu desh të zgjidhte kontratën për moderimin e komenteve në Facebook me kompaninë kanadeze Telas, me klone në disa vende ballkanike.

Kishte një hulumtim të [BBC-së](#) për moderimin në gjuhën persiane që po zhvillohej në Essen të Gjermanisë, ku në këtë kompani kishte njerëz të rrezikuar dhe të trajnuar nga shërbimet sekrete iraniane.

